

Eqrem Çabej

Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes

BIBLIOTEKA

8
912



8
C/12

Eqrem Çabej

SHQIPTARËT
MIDIS
PERËNDIMIT DHE LINDJES

BIBLIOTEKA E
RASHKUTIT Q. P. B. ASTËR
"V 23545

MÇM

Ky libër botohet me ndihmën e Fondacionit «Soros»

Përgatiti për shtyp:
Brikena Çabej

© 1994 MÇM
Rruga «Qemal Stafa» 395/12
Tiranë
tel. + 355/42/34340

PËR GJENEZËN E LITERATURËS SHQIPE

THEMELET KULTURORE-HISTORIKE: POPULLI DHE POEZIA E TIJ

Gjeografia dhe karakteri i vendit

Prodhimi letrar i një populli nuk mund të kuptohet pa njohjen e historisë së tij, po historia shpeshherë është rezultati i të dhënave gjeografike, ndikimi i formimit tokësor dhe i natyrës së vendit mbi jetën dhe veprimet e banorëve.

Fytyrën gjeografike të Shqipërisë së sotme, me përjashtim të detit, e karakterizojnë në tërësinë e saj anët malësore që e ndajnë nga shtetet fqinje¹: në veri ngrihen vargjet e mëdha të Alpevet veriore Shqiptare, përbri tyre Malësia e Gjakovës. Këtu rreshtohen anët malësore të lindjes: Bështriqi shkon në lindje përbri luginës së Krumës. Në jug të Drinit të Bardhë e në lindje të Drinit të Zi ngrihen Koritniku i Lumës dhe Gjalica, dhe në lindje krahina malore e Gorës. Nga jugu lidhet me to Kreshta e Korabit, me Majën e Korabit, maja më e lartë e Shqipërisë. Drini i Zi që del në drejtim verior prej Liqenit të Ohrit përçan këtu luginën e ngushtuar ndërmjet kreshtave të larta e të ngushta të Jablanicës në perëndim dhe Malit të Stegovos në lindje, i cili ndodhet në tokë jugosllave. Anët malësore të lindjes vazhdojnë te trangu i lartë i Malit të Thatë, i cili ngrihet midis Liqeneve të Ohrit e të Prespës dhe shënon kufirin e fushës së Korçës në verilindje. Anën juglindore të kësaj fushe e formon mali thikë i Moravës. Ngjitur me fushën e Korçës shtrihet Gropa e Kolonjës, e cila rrethohet në lindje prej Gramozit. Pas këtij kapet me drejtim juglindor vargmali Postënan-Mëlësinë. Në jug të luginës së sipërme të Vjosës vijon vargu malësor i Dhëmbel-Nemërçkës, e përbri tij lidhet krahina e lartë e Pogonit dhe në jug të kësaj ngrihet mali Bureto. Vargu i Malit të Gjerë-Shtugarës vazhdon përtej kufirit gjer brenda kufirit të Greqisë. Edhe Fusha e Delvinës në fund të Jugut

Shqiptar rrethohet pjesërisht prej vargmalesh.

Ky vend i kufizuar kështu dhe prej detit është i përshkuar së brendshmi prej vargjesh, kurrizesh mali, luginash e gropash të ndryshme, e formon fusha të gjera si Myzeqenë. Por Shqipëria paraqet në përgjithësinë e saj një njësi gjeografike. «Shqipëria përbëhet prej një shumice këso vendesh. Këto kanë ndryshime e kontraste të mëdha ndërmjet tyre. Me gjithë këtë ajo lidhet në një njësi të madhe, në një vend i cili na shfaqet si një gjë krejt e njëhershme e individuale. Pjesët e tij janë vërtet në grindje të përhershme midis tyre, po bash prej kësaj edhe të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Vendi dallohet si një njësi e veçantë fort shprehimisht prej vendeve fqinje.»

Emri i popullit

Në këtë truall të kufizuar kështu dhe në viset kufizore të Jugosllavisë e të Greqisë banon që nga kohë të lashta populli shqiptar. Këtij i shtohen dhe kolonitë në Itali (me Dalmaci), në Greqi të Vjetër me ishuj, në Sirmi, Bullgari, Rumani, në Bashkimin Sovjetik, në Turqi, Egjipt dhe në Shtetet e Bashkuara.

Emri me të cilin të huajt quajnë popullin tonë (*Albaner, albanais, albanese* etj.) ka qenë i përdorur dikur përgjithësisht si emër populli edhe në tokën shqiptare, prej vendasve vetë. Por tani ndër ne është përmbledhur në një përdorim lokal dhe është zëvendësuar nga emri *shqiptar*.

Rruga historike që kanë përshkuar të dy emrat duket të ketë qenë e njëjlojtë, po ajo rrugë që kanë ndjekur zakonisht emrat e popujve. Që të dyja në fillim emra fisi², u ngritën me kohë një pas një në rangun e emrit kombëtar. Emri i vjetër (*arbën, arbër*) u mbulua pastaj prej emrit *shqiptar*. Mirëpo kudo brenda tokës ku flitet shqipja, qoftë nëpër kolonitë tona, qoftë ndër shkrimtarë më të vjetër, qoftë në përdorim lokal të ruajtur a të ngushtuar të fisit, qoftë në emra vendas, ne shohim kudo

se si emri i moçëm i popullit shkëlqen si një fosil nën mbulesën e emrit të ri.

Shkrimi i emrit të vjetër ndër të huajt lëkundet midis trajtave *alb-* e *arb-*; shqiptarët vetë kanë përdorur trajtën *arb-*. Gjeografi aleksandrin Ptolemeu i shekullit II pas Krishtit³ shënon te harta e tij e botës midis Orestis e Almorpërvet, në lindje të Lezhës (Lissus), fisin e *'Αλβανοί* me qytetin *'Αλβανόπολις*. Fisi banonte në Shqipëri të Mesme. Vijon një heshtje e gjatë shumë shekujsh. Nga viti 1072 i përmend shqiptarët bizantini Mihael *Attaliates*. Anna Komnena XIII 5 kujton në Shqipëri në kohën e luftërave bizantino-normane rreth 1079 vendin *'Αλβανον*, Georg Akropolita gjithë vendin përquark *τὸ 'Αλβανόν*⁴. Në kohë të Mesme *Arbanum* është Kruja, *episcopus Arbanensis* ipeshkvi i Krujës. — Duket se përdorimi më i vjetër i emrit ka qenë te bizantinët trajta *arb-*, gjithashtu dhe ndër latinët. Këta popullin e quajnë pikësëpari *arbanenses* (1166) dhe vendin *Arbanum* (1204, 1250) dhe vetëm prej kohës së Anjou-ve (1271) e tëhu më shumë *albanenses* e *Albania*. Nga trajtat e fundit doli ital. *albanese*, kurse prej greq. *'Αρβανίτης*, *'Αρναβίτης* lindi turq. *arnaut*. Formën *arb-* e shohim edhe në serb. e vjetër *Rabana* (1198) dhe *rabanski*, në 1330 *Arbanasi*.⁵

Emri i vjetër ruhet edhe te shqiptarët vetë në trajtën *arb-*; kështu ndër shqiptarët e Italisë, të cilët, të ikur në shekullin XV nga vende më shumë toske, e quajnë veten *arbëresh*. Ky emër përdoret edhe te shqiptarët e Greqisë, që janë edhe këta toskë. Që të dyja këto degë nuk e njohin emrin *shqiptar*, e kjo dëfton se ky nuk kish filluar të sundonte në Shqipërinë e mbarimit të Mesjetës. Por që emri i moçëm ka qenë i gjallë edhe në Veri të Shqipërisë, e këtu gjer në shekullin XVII, na e dëshmon emri *Arbëresh*, me të cilin shqiptarët gegë veriorë të dalë rreth vitit 1700 e quajnë edhe sot vendin e tyre Borgo Erizzo në Dalmacië.⁶

Me këto data nga diaspora shqiptare përkojnë në pikëpamje të kohës dëshmitë e shkrimtarëve të moçëm shqiptarë: Pjetër Budi 1621 *ndegiubu te Arbenesce*⁷, Frangu i Bardhë (Franciscus Blanchus) 1635 *Arbenesceve*⁸. Pastaj te Pjetër Bogdani 1685 na del përbri emrit të vjetër: *dheu i Arbenit, t'Arbenescete*, «li Albanesi», *Arbenoretë* id.⁹, *sciume fjale t'Arbenescia* emri i ri: *Gramatike Latìn e Scqip*¹⁰. Por gjer në fillim të shekullit XVIII emri i vjetër ka qenë ende i gjallë: kështu koncili shqiptar i mbajtur nën kryesinë e Papës Klementi XI quhet në aktet përkatëse të vitit 1706 *Cuvëndi i Arbenit*.

Edhe sot gjejmë në Shqipëri një *Arbër*, *Arbëri* sporadike si emër vendi e *arbëresh*, *arbër* si emër fisi. Pas Johann Georg von Hahn¹¹ në kohën e tij banorët e Labërisë thoshin se që prej kohësh të moçme quhen vetëm *arbër* e vendi i tyre *Arbëri*. Ky përfshin pas këtij dijetari këto katër pjesë: 1. krahinën e Vlorës; 2. Himarën në jug të së parës me Bregdetin me shkrepë të rrëpjeta e të zhveshura; 3. rrethin e Delvinës në jug të vendit; 4. Kurveleshin, hinterlandin lab, i cili ngrihet në perëndim të derdhjes së Drinosit e në jug të Tepelenës dhe tek i cili të tri pjesët e tjera duan që të jetë i kufizuar emri Labëri.

Kjo ndarje është edhe sot e gjallë, po duket të ketë pësuar ngushtime nga shekulli i kaluar e tëhu. Sipas informatash të besueshme që kam marrë, me emrin *Arbër* përfshihen prej disave katundet Borsh, Fterrë, Çorraj, Kallarát e Kuç, të cilat në pjesë të madhe i takojnë zakonisht Kurveleshit të Poshtëm. Mirëpo emri *Arbër* dhe vendi që përfshihet me të duket se nuk janë të caktuar mirë në ndërgjegjen e banorëve. Kështu banorët e maleve të Kurveleshit të Sipërm emrin *Arbër* e konsiderojnë si emrin e veçantë të krahinës së tyre. Kur njëherë një grua nga kjo pjesë e Kurveleshit i përfoli diçka një gruaje nga Kardhiqi që vajtonte të birin — prej atij vendi që ka marrë famë të hidhur nga luftrat me Ali Pashën — , kjo e fundit iu përgjigj:

*Arbëreshë, kukureshë,
U djalin kusar s'e keshë,
Po e keshë djal' e deli djalë,
Bej të hipurë mi kalë!*

Ky emër është, si duket, aq i lashtë në këtë krahinë, sa ka pësuar me kohë lëkundje e ndryshime në lokalizimin e tij. Ne shohim zgjerime, ngushtime, zhvendosje të këtij emri dhe të viseve të caktuara me të. Pas Martin Urban¹² quhet *Arbri* ai copë vend malesh të ulëta në lindje të Vlorës e përtej Shushicës që duhet ta marrim që andej ku vargjet e Gribës ngrihen nga toka kodrinore. Me këtë përkrijnë shënimet që kam marrë nga kjo krahinë: Arbëria pas këtyre përfshin krahinën e Mesaplikut e atë të Kudhësit. E para në katundet Tërbáč, Gjormë, Brataj, Vranisht, Cmokthinë (me lagjet Ramicë, Bashaj, Matogjín, Mesaplik), Velçë, Lepenicë, Gumenicë; në të dytën hyjnë Kallarát, Kuç, Bolenë. Edhe Dukát, Tragjás, Radhimë bëjnë pjesë në Arbëri. —

Beratasi quan banorin e Myzeqesë *arbëresh*. Emri këtu është mbajtur, besoj, që të mund të dallojë mirë shqiptarin e thjeshtë prej aromunit, që edhe ky banon në këto vise. Kjo vërtetohet dhe nga fakti që aromunët e Beratit quajnë *arbëresh* banorin shqiptar të këtij qyteti.

Gjurmë të emrit të vjetër gjejmë edhe në toponomastikën shqiptare si mbetje të fundit të përdorimit të tij të dikurshëm. Kështu një katund midis Tirane e Petrelë, në atë krahinë pra ku ka ekzistuar dikur *Arbanum*, quhet *Arbôna*: Kjo, sipas shqiptimit lokal të *â* si *ô*, është *Arbâna*. *Arbnësh* quhet një katund i Krajës¹³, i asaj pjese kufizore të Veriperëndimit shqiptar nga e cila rrjedhin arbëneshët e përmendur të Dalmacisë. Sikurse banori toskë i Beratit e i Myzeqesë quhet *arbëresh* përkundrejt aromunit, kështu besoj, ky emër geg (*arbnësh* «shqiptarë») ka mbetur i ngjitur te katundi shqiptar për ta shquar si të tillë prej fqinjëve sllavë.

Si qëndrojnë të dy grupet e trajtavet *alb-* e *arb-* njëri ndaj tjetrit¹⁴? Holger Pedersen me mprehtësinë e tij të zakonshme është shprehur që në vitin 1894¹⁵ «që emri i vetë shqiptarëve duhet të jetë me *r* (jo *l*). Grekët e ndryshuan emrin pas një asocioni të errët me emra gjeografike të tjera». Historiani Sufflay¹⁶ është i të njëjtit mendim. Faktet duket se e vërtetojnë. Sepse në qoftë se Ptolemeu ka 'Αλβανοί, Straboni 4, 202 τὸ "Αλβιονσ, edhe *arb-* dëshmohej gjithashtu prej Ilirie: 'Αρβών një qytet i Ilirisë Polyb: II, 11 tek Steph. Byz., banori 'Αρβώνιος, 'Αρβωνίτης¹⁷. Kështu pra shkrimtarët i kanë vërtet që të dy trajtat, po si duket vetëm shkrimtarët: sepse te bizantinët 'Αλβανός, 'Αλβανία janë forma savante dhe arkaizuese; popullor ka qenë vetëm 'Αρβωνίτης¹⁸. Aktet e vjetra latine të kohës së mesme kanë, siç pamë, *arbanenses*, më vonë *albanenses*. Popujt fqinj të shqiptarëve duket se kanë përdorur përhera trajtën *arb-*; kështu serbët dikur *Raban*, pastaj *Arbanasi*, aromunët *Arbines*, *Arbanas*¹⁹. Grekët 'Αρβωνίτης. Një katund dikur shqiptar afër Tirnovos bullgarët e quajnë *Arbanasi*²⁰. Por meqë *arb-* u pat tingëlluar popujve të Perëndimit si i huaj, e lidhën me anë të etimologjisë popullore me emra gjeografike fort të shpeshta e të njohura në *Alb-* (*Alba*, *Albani*, *Albion* etj.) dhe vendin e quajten kështu *Albania* e popullin *albanenses*.

Kështu ka të gjarë që *arban-* të këtë qenë emri i parë i shqiptarëve. Mirëpo në këtë çështje të vështirë nuk mund të thuhet fjala e fundit, sidomos kur kemi përballë trajtën kaq të hershme 'Αλβανοί tek

Ptolemeu. Përveç kësaj trajta *alb-* nuk është krejt e huaj ndër emrat e fiseve shqiptare. Emrin *Albos* të njërit nga të trembëdhjetë fiset shqiptare që na përmenden në një listë të Anjou-ve në 1304 Sufflay²¹ e ka identifikuar me 'Αλβανοί, duke gjetur në këtë pëlqimin e Skok-ut. Ky dijetar i fundit është i mendimit që sufiksi *-an* në *Alban* duhet marrë si akuzativi i shquar i shqipes, *alb-* si një rikrijim i nominativit, i cili na shfaqet me metatezë sllave në emrin e sotëm të fisit lab²². Po të jetë i drejtë ky mendim i shprehur prej Gustav Meyer-it e i mbrojtur prej Skok-ut, atëhere do të kishim në Shqipërinë e sotme përbri gjurmëve të shumta të trajtës *arb-* edhe këtë mbeturinë të vetme të trajtës *alb-*. Mirëpo *lab* mund të jetë në Shqipëri emër i vjetër e parasllav, emri i labëvet është krahasuar prej Baron Nopcsa-s me emrin e fisit ilir të Labeatëvet afër Liqenit të Shkodrës.

Duke dalë prej *arb-* si prej formës së drejtë të emrit, po vërejmë menjëherë se *Arbën*, *Arbër* ka shënuar pikësëpari dikur si dhe sot, siç duket, vendin «Shqipëria». Pastaj ky emër u shtri në rasi të veçanta e sekundare të përdorimit të tij edhe mbi banorin («shqiptar»). Kjo shpërngulje kuptimi është e zakonshme në gjuhën shqipe. Kështu është, bie fjala, një veçori e dialektit lab që me emra mashkullore katundesh të shënohet edhe banori, qoftë pa i ndryshuar fare ato, qoftë me shtim të artikullit prepozitiv *i*: 1. *Lazarát* «katundi»; 2. *Lazarát* ose *i Lazarát* «banori i tij»; gjithashtu *Golém*, *Gusmár* etj. Këtë dukuri unë e nxjerr nga natyra në fillim fisore e katundit shqiptar, kështu që *Lazarát* ka pasur kuptimin: 1. Njerëzit e Lazarit, të Lazos; 2. Njëri nga njerëzit e Lazos. Dhe me të vërtetë gojëdhënat e themelimit të shumë katundeve shqiptare dinë të na thonë edhe sot emrin e themeluesit, hyjnë pra në grupin e vendeve që e kanë marrë emrin prej një personi.²³ — Në qoftë pra se *Arbën*, *Arbër* është emri i vendit, në pikëpamje gramatikore mund të jetë plurali kolektiv i vjetër i një *arb-*, *arbë*, plural i zakonshëm në emra asnjansë lënde, në emra personash, popujsh e gjirish: *djathë*, pl. geg. *djathna*, tosk. *djathëra*, *mbret*, pl. *mbretën*, *mbretër*, *prift*, pl. *priftën*, *priftër*²⁴, ose *arbën* është një emër apelativ i moçëm *arban* e *arben*, i cili me reduksionin e *-a-së* ose *-e-së* së patheksuar në *-ë* u bë rregullisht *arbën*, toskërisht me rotacizëm *arbër*. I mendimit të parë është Φουρίκης: «Emri 'Αρβανίτης te grekët e paska bazën në "Αρβανα, shqip *arbëna*, pl. i *arbë*; kjo *arbë* rrjedh sëfundit, me ndërmjetësinë e iliristes, nga keltishtja *alb*, *alp* «lartësi e rrëpjetë» (khs. kymrisht *alp*

«shkrep, thikë»). Këtë fjalë e gjejmë në këto emra gjeografike: 1. *Alba*, mal në Liburni, prej nga dhe emri i lumit Ἀρβάτης te Skylaks dhe *Arba* (ishull); 2. *Arbon* (qytet në Iliri); 3. *Arbëna* (male në Shqipëri); 4. Ἄλπωνος (mal në Maqedoni ose në Thesali); 5. Ἄλπα (mal më Lokris, banorët Ἀλπηνοί); 6. Ἄρβα (mal dhe qytet në Ahaia); 7. Ἄλπιον (vend në Spartë); 8. Ἄρβιον (mal në Kretë)²⁵. Kësaj liste le t'i shtojmë dhe emrin e lumit Κατ-αρβ-άτης khs. Ἀρβ-ατίας, kështjellë në Iliri²⁶. — Një mendim të afërt shpreh dhe Marin Sirdani, i cili²⁷ emrin *Arbni* e nxjerr prej shqipes *arbë* «rrafshinë», fjalë që ekziston me të vërtetë, «shka perkon më së miri me krahinë qi qysh kúr njëfet prej popullit shqyptar me êmnin *Arben* e *Arbni*, e cila pershijte e pershîn, në kuptimin e vërtetë, fushen ase rrafshinen ndermjjet detit e maleve që prej lumit të Matit e deri n'Erzên». — Të dy këta dijetarë e shohin pra bazën e emrit në *arbë*, i pari duke e postuluar këtë si «vend i lartë» i dyti duke e konstatuar si «rrafshinë». Mendimi i Sirdanit ka këtë të mirë, që mbështetet në një fjalë që ekziston vërtet. Me gjithë këtë, çështja nuk është zgjidhur një herë e mirë, sepse, siç pamë, banorët e maleve të Kurveleshit të Sipërm e quajnë vendin e tyre *Arbër*. Mundet pra që kuptimi themelor të ketë qenë «lartësi» dhe që Φουρίκης të ketë të drejtë. Edhe Jorga²⁸ mendon që *Albanoí* te Ptolemeu ndofta ka kuptimin «popull alpesh». «Le mot d'Albanie a la même origine qu'alpage» thotë J. Ancel²⁹. Pas A. Trombetti-t³⁰ në emrat preindogjermane (ku pas tij hyjnë hetitishtja, gjuhët vendase të Azisë së Vogël, etruskishtja, gjuha e Lemnos, eteokretishtja, eteokyprishtja etj.) bëjnë pjesë: Ἀρβασάνιος në Isauri, Ἀρβη-σ(σ)ος korinth., Ἀρβα, Iliri, Arbae Praeneste, Ἀρβα-κη Iberi.

Por edhe *Arban*, *Arben* mundet sëfundi të merret si emër apelativ, meqë *arben* «fushë» e dëshmon M. Logoreci për Kthellë e Kurbî³¹. Pas këtij *arben* përdoret atje në të thëna fikse si *mal e arben* «mal e fushë». Por në themel edhe Ἄλβωνον, kështu edhe *Arbën*, *Arbër*- është një fjalë e formuar me sufiks, pas Krahe-s 42 një trajtë ilire me -ano-, -ana- si *Loranum*, *Idanum*, *Uscana*. Ky sufiks shërben edhe për formim emrash etnike si Δερβανοί: *Derba*, *Andarvani*: *Anderba*, Λαδεστανοί: *Λάδεστα*, emrat e fisevet Ἄλβανοί dhe *Selepitani*.

Emrat e moçme shqiptare të popullit janë: g. *arbën*, t. *arbër*, g. *arbënésh*, t. *arbërésh*, g. *arbënuer*, -ori, t. *arbëror*. Meqenëse, siç thamë, *Arbën* e *Arbër* përdoren në mënyrë të përzier si emër vendi ashtu dhe

populli, kështu u lind, besoj, atje ku *Arbën*, *Arbër* hyri në përdorim më shumë si emër populli, një emër dallues për vendin: *Arbënia*; e më anë tjetër atje ku *Arbën*, *Arbër* e ruajti kuptimin topik të hershëm «Shqipëri», u krijua emri i ri i popullit: *arbënesb*, *arbëresb* ose *arbënuer*, *arbëror*. Kjo është një rasë e evitimit të homonimisë. Te *arbënesb*, *arbëresb* u krijua sëpari fem. *arbënesbë*, *arbëresbë*, meqë *-eshë* formon emra personash femërore³², trajta mashkullore u krijua sekundarisht pas femërores. Duke u nisur prej *arbënesb*, *arbëresb* nuk mund ta përcaktojmë saktësisht rrënjën e emrit, e cila mund të jetë ose *arbën-esh*, *arbër-esh* ose *arb-ën-esh*, *arb-ër-esh*, sepse sufiksin *-esh* e shohim të bashkuar edhe me *-ën*, *-ër* : g. *priftnésb* : *prift-n-esh*, t. *prift-ër-eshë* prej *prift*³³. — *Arbëresb* luan një rol edhe në botanikë: *fik arbëresb* i thonë në Gjirokastrë një farë fiku të zi e të vogël.

Trajtës *Arbën*, *Arbër* duke iu shtuar sufiksi *-uer*, *-uar*, e cakt. *-ori*, kemi g. *arbnuer*, *arbnori*, t. *arbëror*. *Arbenoretë* e gjetëm te Bogdani përbri trajtave *Arbanesci* dhe *Scqip*; *arbëror* në një këngë dasme nga Gjirokastra:

Nusja jonë arbërore,
arbërore;
E bardha si qumështore,
arbërore;
E kuqe si koqe molle,
arbërore etj. —

Emri i vjetër i popullit përdoret sot prej poetëve me funksion arkaiques: Gjergj Fishta: *Djelmt t'onë e Arbnis uzdaja*³⁴; Prennushi: *Luftuen luftat e zëmres arbnore*³⁵.

Përsa i takon emrit *shqiptar*, E. Oberhummer³⁶ shënon se Gustav Meyer në kundërshtim me spjegimin e parë që i pat dhënë emrit si «banor shkrepash ose malesh», e nxjerrka prej lat. *excipere* «kuptoj», mendim i pranuar edhe prej Jirecek-ut. Këtë mendim e mbështet edhe G. Weigand-i, i cili dëshmon *shqip* «shqip, qartë, kuptueshëm», *shqipoi* «kuptoi». ³⁷ K. Treimer³⁸ kishte spjeguar pak më parë geg. *shqyp*, tosk. *shqip* prej indogjerm. **sm-ku-po* «popull» që lidhet me tosk. *qipí*; prej kësaj fjale rrjedhka folja *shqiponj*. Mendimi i fundit i Treimer-it është sigurisht i drejtë, por rrjedhja që ai i jep emrit *shqiptar* nuk ma mbush

mendjen. Oberhammer pranon sëfundi mendimin e M. Lambertz-it; ky dijetar, thotë, ia kish spjeguar emrin mjaft mirë prej *shqiponjës*, si emër i një totemi nga koha e Skënderbeut. Ky emër pas Lambertz-it nuk është aq fort emër popullor sesa më tepër shprehja e kombësisë. Përndryshe gjithkush e ka marrë emrin prej fisit të vet. Ky mendim gjen mbështetje te një vrojtim i Edith Durham-it. Pas kësaj «një pjesë e madhe e popullsisë së Perëndimit të Gadishullit Ballkanik e identifikon vetveten me shpezë. Shumë këngë popullore vërtetojnë vjetërsinë e këtij besimi. Shqiptarët quhen kështu pas shqiponjës. Besohet ndër ta se është fatkeqësi të vritet një shqiponjë. Lidhjen me shqiponjë e gjejmë qysh te Plutarku, *Jeta e Pirros*, i cili pas fitores që korri mbi maqedonasit u kremtua me emrin Shqiponjë. Në flamurin e Skënderbeut dhe te stema e Shtetit të ri Shqiptar ndodhet një shqipe. Malazetët e identifikojnë veten me skifterin.»³⁹ Këtyre të dhënave të Durham-it dua t'u shtoj se në Shqipëri e përgjithësisht në Ballkan dhëndri krahasohet me skifterin, nusja me thëllëzën. «Sikurse në poezinë popullore sllave edhe në poezinë popullore shqiptare të Veriut heroji vihet në paralel me skifterin dhe gjeraqinën.»⁴⁰ Vjetërsia e madhe e këtyre identifikimeve na vërtetohet jo vetëm prej rrëfimit të Plutarkut për Pirron, por edhe nga fakti që një seri mbretëreshë maqedonas janë quajtur Perdikas (thëllëzë). Në trakët e vjetër kishte emra personi "Ορολος, një mbret i Bakëve quhej Oroles, fjalë që lidhet me greq. ὄρλις «shpezë», got. *ara* «shqipe», sllav. *orólzid*⁴¹. Duket pra që atributet dhe emrat e marra nga bota e shpezëve kanë qenë prej kohësh të zakonshme në Ballkan. Por të tilla lidhje të ngushta të emrave fisore me shpend i gjejmë edhe ndër italikët e vjetër si p.sh. Picentes prej *picus* «qokthi, qukapiku».

Një mendim të ri mbi emrin *shqiptar* ka shprehur në vjetët e fundit A. Ch. Chatzis⁴². Pas këtij *shqip*, *shqiptar* rrjedhin nga greq. e re σκιπ-πέτρο(v) «pushkë» (fjalë e dëshmuar sëpari në shek. XVI-XVII), kjo e fundit prej ital. *schioppetto*. Kundër këtij mendimi është përmendur se emri *shqiptar* na dalka si emër familjeje qysh 1368-1402 në Drisht (Drivastum): në arkivat e Rushit (Raguzës) ne gjejmë të përmendur një drivastin të quajtur Schibudar, Schepuder, Schapudar, Scapuder (Šufflay).

Duke përmbledhur ç'kemi thënë na rezulton se emri i ri (*shqiptar*) na shfaqet si emër familjeje në një kohë kur emri i vjetër i popullit është edhe në lulëzim e sipër. Të dy emrat do të kenë luftuar shekuj me radhë

me shoqi-shoqin për përhapjen e vet në popull, gjersa nga fundi i shekullit XVII emri i ri doli fitues. Shkas i kanë dhënë ndofta shtegtimet e shumta të fiseve shqiptare të kohës së mesme, formime fisesh të reja dhe dyndja e osmanëve. /

*Fuqi centrifugale në historinë dhe karakterin
e popullit shqiptar*

Kufizimi që pamë se i bëhet truallit shqiptar, e sidomos veriut e lindjes, me vargje malesh të larta, ka pasur si rrjedhojë në historinë shqiptare një farë shkëputjeje e mënjanësie përkundrejt fqinjëve. Por më të forta se këto elemente nguruese e izoluese kanë qenë në historinë dhe në karakter të shqiptarëve fuqitë që kanë vepruar nga brenda jashtë. Thatësia dhe varfëria proverbiale⁴³ e shumë viseve të Shqipërisë nuk ka mundur të ushqejë banorët. Por këto fise iliro-shqiptare, miq shtegtimesh e armësh, e kanë pasur gjithmonë të gjallë para sysh se përtej maleve kufizore e përtej detit shtriheshin fusha pjellore e rrafshina të gjera, Dardania, Maqedonia, Thesalia, Apulia. Që andej i grishnin vërritë, banesa të pasura i ftonin për plaçkitje me armë në dorë, vise pjellore i tërhiqnin për një vendosje të përhershme. Krahu që ishte mësuar të përdorte mjeshtërisht armët filloi tani të drejtojë me fuqi përmendën, bariu luftar u bë bujk me armë. Këto fuqi shtegtimi na shfaqen si faktor vendimtar që në epokat prehistorike e gjatë gjithë historisë shqiptare gjer në kohët më të reja. Kështu shohim se si që në kohët më të lashta fise ilire shtrihen më njëri-njëri anë andej detit në Itali, më anën tjetër në Hellas, në Dardani, Maqedoni e Traki gjer në Bosfor: duke kontribuar atje në mburrjen e nacionit italik, këtu në formimin e nacionit helenik e trak, më vonë të nacioneve serbe, greke të re e turke. Jo vetëm mesapë e japigë, tribalë, dardanas, peonë e të tjerë janë ilirë: edhe maqedonas e doras janë lidhur ngushtë me elementin ilir. Veçoria e vazove apulike në rrethin e vazove italike, karakteri vetjak i qeramikës

thesale brenda qeramikës greke, duhet, besoj, të spjegohen me elementin ilir të tyre. — Në kohën e Perandorisë Romake përhapja e ilirëve u bë përhapje militare e administrative. Me dyndjen e sllavëve fillon pastaj një periudë e re, prehistorikisht e errët, për Gadishullin e Ballkanit. Por në shekullin XIV fillon «Manifestacioni shqiptar» i Fallmerayer-it, shpërthimi i shqiptarëve në Thesali, në Greqi të vjetër, në ishuj dhe në Moré. Morea është për shqiptarët ajo që është për gjermanët Italia. — Sundimi i osmanëve nuk mundi ta ndalë hovin shtegues të popullit, vetëm se i dha drejtime të tjera. Osmanët e sollën në kulm dhe e përfunduan hovin shtegues të shqiptarëve dhe kontribuan kështu në shpelimin e shpërndarjen e tyre, por jo krejt. Nga simpatia që patën për elementin grek dhe nga frika se mos forcoheshin shqiptarët në Greqi, ia hoqën dyndjes shqiptare drejtimin nga Greqia. Kështu këta u nisën në njërin anë për në Itali, më tjetrën anë kundër elementit sllav në Maqedoni e në Serbi të Vjetër. Sëparit u drejtuan për në Itali. Se sa afër qëndron edhe sot Apulia në ndërgjegjen e bregdetasve shqiptarë na e dëshmon një këngë popullore nga Vunoi i Himarës, ku djali plaçkitës këndon:

*Do të vete në Otrén
Të të sjellë një ok'ergjén.*

Në shekujt e pastajmë e pas islamizimit të vendit ndodhi vendosja e dytë e shqiptarëve në Maqedoni e në Serbi, pas vendosjes së parë të fiseve ilire-shqiptare. — Këto rryma shtegtare shqiptare të Mesjetës u derdhën në Ballkan e andej detit pothuajse mbi të njëjtat vise që dikur i patën në dorë stërgjyshët ilirë: thuajse një instinkt i trashëguar e i fjetur prej shekujsh i drejtoi të përhapen shqiptarët po mbi të njëjtat vende. Ehtë për t'u vënë re se si e njëjta pozitë gjeografike e vendit-mëmë, i njëjti karakter i racës dhe vazhdimi i gjithë atyre konditave ekonomike ka dhënë në shtegtimet shqiptare të njëjtat përfundime.

Me kaq na shtjellohet para syve rryma e përhershme shtegtare e shqiptarëve, e cila pasqyrohet edhe në poezinë tonë popullore. Sikurse në kohën antike ashtu dhe më vonë ky popull malësor i fortë jep gjakun e tij për mbujtjen e kombeve të reja ballkanike, jo vetëm me anën e përzierjes etnike, por edhe në pikëpamje politike, si kasta Elufitare e Ballkanit, me armë në dorë.

53545

Prej këtyre fuqive centrifugale spjegohet fakti që shqiptarët kanë punuar e luftuar përhera më tepër për të huajt sesa për vendin e vet. Këto fuqi kanë qenë shkatërruese edhe për tërësinë nacionale: sepse kështu ka humbur për kombin shumë pasuri populli e gjuhe, në anën e veriut Kuçi, Vasojeviqët e të tjerë, në anën e jugut Suli dhe shumë koloni në Greqi e në Itali, në Serbi e në Maqedoni.

Rryma centripetale të huaja

Në kontrast me këto lëvizje centrifugale të popullit shqiptar janë derdhur mbi Shqipëri si kundërfuqi rryma centripetale të popujve të huaj. Shqipëria, nga fati i saj gjeografik si qoshja më perëndimore e Gadishullit Ballkanik të orientalizuar dhe si lidhësi më i afërm i tij me botën oksidentale të Gadishullit të Apenineve, si çelësi i Adriatikut dhe si pikë takimi e botës romane me botën greke e sllave,⁴⁴ ka qenë, nevojisht, gjithmonë vend kalimi si pak vende të tjera dhe pikë lakmimi pushtuesish të huaj. Këta kanë hyrë ose nga deti, ose nga luginat e lumenjve që përçajnë malet kufizore, ose nëpër dyer të mëdha si Fusha e Korçës.

Shqipëria midis Perëndimit dhe Lindjes

Më me rëndësi sesa dyndjet veri-jugore, që kanë qenë më shumë dyndje fisesh, janë dyndjet perëndimore-lindore, sepse, të organizuara

prej shtetesh, kanë ndjekur qëllime të fuqisë politike dhe kanë zgjatur më shumë. Shqipëria është truall në të cilin grindja e gjatë ndërmjet botës romane-perëndimore dhe ballkanike-bizantine është shprehur në mënyrën më të spikatur. Pushtuesit perëndimorë kanë për qëllim sundimin mbi Gadishull me pikë të fundit Konstantinopolin: Roma, Venetiku, Normanët dhe Anjou-të. Lindorët: bizantinë, gotë, bullgarë, serbë e osmanë duan të arrijnë daljen politike në Adriatik, e nganjëherë, si gotët, bizantinët dhe osmanët nën Muhamedin II, duan ta përdorin Shqipërinë si dërrasë kërcimi për në Itali. — Ky qëndrim i ndërmjemë midis Perëndimit e Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë. Këtë nuk ka mundur ta fshijë as sundimi turk. Kjo shprehet në krejt mënyrën e jetesës, në historinë dhe në historinë kish-tare, në zakone dhe në poezi popullore dhe artistike të popullit shqiptar. Duhet shënuar me këtë rast se Shqipëria ka qenë e orientuar më tepër nga Perëndimi sesa fqinjët e saj. Midis gjithë vendeve ballkanike, — edhe Rumania, me gjithë idiomën roman të saj, e papërrjashtuar — Dalmacia e Shqipëria, pastaj Ishujt Jonike janë vendet që kanë qenë të çelura direkt e më tepër ndaj influencës kulturore të Perëndimit. Lëkundja e Shqipërisë ndërmjet Ballkanit e Perëndimit na shfaqet, pothuaj ashtu si në Dalmaci, edhe në pikëpamje politike dhe jo më në fund gjuhësore, në mënyrë që elementet latine kanë pësuar në të dyja këto gjuhë një trajtim të ngjashëm.

Përçarja e vendit në shumë krahina malësore e të ulëta, të ndara shumë herë thellësisht njëra prej tjetrës, ka lindur në Shqipëri fiset dhe i ka mbajtur gjer më sot. Fisi, forma e zgjeruar e familjes së madhe, është shprehja më e thjeshtë e individualizmit kolektiv, i cili i përshtatet ndjenjës që ka shqiptari për jetë. Shqipëria gjendet tani brenda në një proces shoqëror të padukshëm, në kalimin prej jetës vetjake të fisit në jetën e përbashkët nacionale.

Fiset

Edhe ilirët e moçëm ndaheshin në plot fise më shumë a më pak të rëndësishme, të cilat rronin shpeshherë në grindje të ashpër midis tyre. Πόλις është ideja bazë e jetës politike te grekët, te ilirët është *gens*, te të dy shprehja e partikularizmit. Rrallë pat mundur ndonjë dorë e fortë të bashkonte shumë fise ndër ilirë, dhe, në qoftë se po, vetëm për një kohë të shkurtër.

Fisi është një grumbull etnik kompakt, një grup njerëzish të cilët, të ngjitur fort ndërmjet tyre, e dinë veten të rrjedhur prej një burimi të përbashkët: njomza të fundit të një druri vigan që rritet gjithmonë, rrënja e të cilit lidhet me emrin e një të pari të fisit që është bërë gojëdhënë. Gjëja primare te misat e një fisi është ndjenja që janë një njësi. Të tjera elemente që karakterizojnë një fis janë: mënyra e banimit, kostumi e flokët, dukja e jashtme, mënyra e jetesës, doke e zakone, institucione sociale e juridike, dialekt e gojëdhëna, edhe mënyra e ushqimit,⁴⁵ shkurt pra kultura materiale dhe jeta shpirtërore! Po këto elemente shumica nuk përkohjnë me njëri-tjetrin: ndonjë sosh, si zakoni ose kostumi, mundet, duke dalë prej një pike, të përhapet përmbi *disa* fise, ose *një* fis mundet përkundrazi të ndahet në shumë degë të posaçme përsa u përket disave nga këto elemente, si dialekt, mënyrë jetese etj.

Shqiptarët ndahen në pikëpamje gjuhësore në **gegë** e **toskë**. Ky degëzim i gjuhës pas linguistikës nuk është i vjetër⁴⁶: Toskërishtja jugore e mbarimit të Mesjetës, siç na shfaqet në idiomën e kolonive tona në Greqi e në Itali, afrohet me gegërishten veriore të shekullit XVI e XVII. Sido që të duam ta spjegojmë këtë, duket se njësia e gjuhës, shqipja e vjetër e përbashkët, ka rrojtur gjer në Mesjetën e lartë, në trajtat kryesore më gjatë se rumanishtja e përbashkët. — Gegë e toskë ndahen nga anë e tyre në fise e nëndialekte. Kalimet e jashtme e të brendshme ndodhin këtu si kudo gjetkë gradualisht. Ndryshimet e mëdha që kanë dy krahina në mënyrë banimi ose kostume etj., zbuten me trajta të mesme, të cilat përmbajnë diçka prej të dy poleve anësore.

Historia e fiseve shqiptare, d.m.th. historia e pashkruar e Shqipërisë, ndodhet ende në errësirë. Sufflay⁴⁷ konsideron si formim të parë etnik fiset ilire të Labeatëve, Pirustëve, Sardeatëve, Batiatëve, Partinëve etj. Shtrat i dytë janë pas tij të trembëdhjetë fiset që përmenden më 1304:

Albos, Spatos, Catarucos, Bischesini, Aranitos, Lecenis, Turbaceos, Marchaseos, Scuras, Zeneuias, Bucceseos, Logoreseos, Mateseos. Në shtratin e tretë hyjnë fise si Hoti në Veri, në Jug 1481 Grisei, Churlisey, Plesei e Corvesei.

Gjer ku vazhdojnë të rrojnë në fise të sotme e në trajtë të ndryshuar gjurmë të këtyre fiseve të lashta është vështirë të thuhet⁴⁸ kryqëzime e shpërngulje kanë qenë gjë e zakonshme në këtë lëmë. Fiset e sotme janë më të shumtat, siç ka treguar Baron Nopcsa për Shqipërinë Veriore⁴⁹, produkt përfundimor emigrimesh e imigrimesh të paqeta, shpërnguljesh e lëkundjesh të forcuara si pasojë të dyndjes së turqvet në Ballkan. Sepse vrulli shtegtues i përjetshëm i shqiptarëve shpërtheu jo vetëm së jashtmi, por edhe përbrenda. Se sa larg mund të shtegtojë një fis na e dëshmojnë Kelmendasit. Këta dimrin e kalojnë me bagëtitë e veta në Bregun e Matit. Po kanë lëshuar degë më një anë gjer në Sirmi, ku themeluan dy katunde, e më anë tjetër, në qoftë se nuk gënjen emri Κλημέντι⁵⁰ kanë shtegtuar nga jugu gjer në Atikë. Është detyra e dialektologjisë që në lidhje me studimin e gojëdhënave lokale të sqarojë gjer diku gjenezën e errët të fiseve shqiptare. Atëhere do të derdhet dritë njëkohësisht edhe mbi ato fise të cilat me kohë e kanë bjerrë kombësinë shqiptare. Kështu pas traditës fisore të Krasniqëve këta vetë, Nikajt e Vasojeviqët janë fise vëllezër, të cilët me kohë u shkëputën: Nikajt mbetën katolikë, Krasniqët u bënë muhamedanë, Vasojeviqët u bënë njëkohësisht ortodoksë e sllavë.

Karakteri konservativ i zonave malësore të anëve

Trajtat e moçme në mënyrën e jetesës dhe në kulturën materiale e shpirtërore, siç i përfytyrojmë në mënyrë retrospektive për indogjermanët e vjetër, nuk janë ruajtur, them, aq besnikërisht te asnjë nga popujt e sotëm indogjermanë sa ndër shqiptarë. Ky konstatim ka vlerë edhe përkundrejt Ballkanit, i cili është edhe ky mjaft konservativ. Sepse

helenët që u civilizuan shpejt i lanë heret doket e lashta, popujt e tjerë u dukën në Ballkan në një shkallë më të zhvilluar të kulturës ose u formuan këtu më vonë. Vetëm te shqiptarët mund të flasim për një traditë sedentare dhe të paprerë që nga koha e vjetër.

Dy faktorë, karakteri i vendit dhe tenaciteti i banorëve, kanë kontribuar në ruajtjen e vjetërsive. Faktori i dytë ka vlerë për krejt Shqipërinë dhe është pra konstant, kurse i pari ndryshon bashkë me krahina. Kështu pra dallimet graduale të fiseve të ndryshme në pikën e karakterit konservativ varen kryesisht nga natyra e vendit. Atje ku, si në Shqipërinë e Veriut, male të pakalueshme pothuajse e mbyllin dhe e veçojnë banorin nga bota që e rrethon, institucionet e vjetra kanë mundur të ruhen gati të pavdara. Ndryshe në Shqipëri të Mesme e Jugore, vende më shumë të qytetëzuara, të cilat, duke qenë gjeografikisht shumë më të çelura, kanë pësuar gjithmonë më shumë influencën e huaj. Fiset këtu janë zhdukur. Se kur ka ndodhur zhdukja, kjo është një çështje aq e vështirë sa dhe e rëndësishme për historinë e Shqipërisë: Në fushë sigurisht mjaft heret, shumë më vonë nëpër krahina malësore.

Por fisi edhe në krahina të tilla nuk është zhdukur krejt, sidomos në zona malësore të anëve si Labëria. Me këtë emër quhet ajo pjesë toke jugperëndimore, kufiri jugor i së cilës fillon te katundi Lazarát në jug të Gjirokastrës. Kufiri lindor shkon prej Lazarati për së gjati Malit të Gjerë dhe pjesës jugore të Malit të Picarit gjer në Tepelenë. Këtu vazhdon në perëndim të Vjosës,⁵¹ kurse në të djathtë të lumit shtrihet vendi tosk në kuptimin e vërtetë të ngushtë të fjalës. Kufiri zë në veri katundin Mesaplik afër Vlorës dhe vazhdon gjatë një vije ideale që shkon prej Mesapliku në Kudhësin e afërm; kufirin perëndimor e përbën deti. Himara prej disave konsiderohet si krahinë labe, prej të tjerësh si «labëronjëse». Përjashtë kufijve të Labërisë katunde si Labova afër Tepelenës, Labov'e Kriqit pranë Libohovës na dëshmojnë qartas me emrin e tyre origjinën labe.⁵²

Në Labëri vërehen gjurmë të qarta të jetës së dikurshme fisore. Në pikëpamje shoqërore labët janë bartësit e armëve në Jug; besa e guximi kanë prej kohe atributet konstante të Labërisë. Në pikëpamje të gjeografisë së banimit katundi lab është më shumë katund fisi,⁵³ toponimia e vërteton këtë: emra katundesh si Çorraj, Sinanëj, Memaliaj, Brailát, Tatzát, Janicát, Llupsát, Zhulát, Progonát, Kallarát, Luzát, Lazarát, Dhoksát, Qestorát, Terihát, emra lagjesh si Manalát, Dunavát në

Gjirokastrë, Vagalar në Delvinë etj. etj. në pikëpamje gjuhësore nuk janë gjë tjetër veçse plurale kolektive (*Progonat* «pasardhësit e Progonit»), d.m.th. në pikëpamje gjeografike banimesh emra fisi.⁵⁴ Edhe në lëmë ekonomike ruhen vjetërsitë si ekonomia autarke e fisit: «Bujku i malit prodhon në truall të tij vetëm ato që i duhen për jetesën e vet e të familjes së vet, zarzavatin, pemën e duhanin përsa i duhet atij vetë; ai i bën më shumë vetë teshat dhe veglat që i nevojiten për punë dhe për mbajtjen e shtëpisë».⁵⁵ — Në pikëpamje juridike ka rëndësi ruajtja sporadike e një kanuni të moçëm tradicional, kurse kanuni i Lek Dukagjinit është ende krejt i gjallë në Shqipëri Veriore. Thuhet se para afërsisht një shekulli u patën bashkuar dy të parë nga të Labërisë, Idris Sulli prej Zhulati dhe Demir Dosti prej Kardhiqi për të reformuar kanunin e vjetër, posaçërisht për të rregulluar rishtas çështjen e rrëmbimit të moçëm dhe të zbimit të gruas. Si duket, institucionet e lashta nuk po përkonin më me gjendjen e kohëve të reja. Sidoqoftë reforma do të ketë pasur lidhje me shkatërrimin e ngadalshëm të jetës së hershme të fisit. Karakterin konservativ të kësaj zone malësore të anës na e dëshmojnë së fundi disa aspekte e figura të besimit popullor. Këto në Shqipërinë e Veriut vazhdojnë të rrojnë si besim, këtu në Jug tashmë vetëm në formë profane: *Buzmi*, ose me aliteracion *buzmi bujar*, i cili në Malësi vendoset natën e Krishtlindjes në vatër dhe bëhet objekt nderimi të madh,⁵⁶ në Himarë rron në kuptimin e thjeshtë *kërcú*. (Vajza e malit dhe ndihmësja në luftë, *zâna* e Shqipërisë Veriore, e cila rron edhe ndër rumunë e aromunë dhe origjina e së cilës prej lat. Diana mbetet e dyshimtë⁵⁷, rron si *zërë*, më parë si duket «Fée», tani «vajzë e bukur» në katundet rreth Vlorës (Tragjás, Dukát, Radhimë) dhe në Himarë: Këtu këndohet kjo këngë :

«Eja posht' o zërë»
 «Vijte, po s'më lënë,⁵⁸
 Më thon : «Ku ke qënë?»
 «Në Demush në lëmë.»
 «Ku ke qën' o ngjallë?»
 «Atje tek një djalë;
 Ai s'qe një djalë,
 Po qe rrënje-dalë.
 Më puthi në ballë,

*Shoqetë më panë.
«Ç'bën ati?» më thanë.
«Puthem me jaranë.»
O jaran, jaran, më ruash,
Në do me mua të luash,
Puthm e ndukëm sa të duash,
Po mos dëfto e mos thuash.»*

Edhe për pjesë malësore të tjera të Toskërisë mund të supozohet se kanë ruajtur fiset më gjatë. Pas Ami Boué⁵⁹ këto quhen këtu *farë*, në Veri *fis*. Kështu Suliotët çamë përbëheshin pas këtij dijetari prej trembëdhjetë fisesh. — Privilegjet që kanë gëzuar gjatë sundimit turk disa krahina si Mirdita e Himara në Shqipëri, Maina në Moré do t'i spjegojmë më mirë me ruajtjen e gjatë të organizimit fisor në to.

Këto përkime (konkordanca) midis Veriut e Jugut mund t'i spjegojmë pjesërisht me shtegtime të fiseve gege në Jug — shumë shtëpi të Himarës mbahen si pasardhës të gegëve të ardhur nga Kruja. — Këtij faktori i duhet shtuar dhe një element konservues i vendit vetë, i pavarur nga shtegtimet: Thelbi i thjeshtë i shqiptarizmit të moçëm, i cili në Shqipërinë e Mesme pjesërisht u zhduk, në malet anësore të Veriut e të Jugut i mbeti besnik vetvetes, sikurse në një mal gëlqeror zona e ndërmjeme është eroduar prej një lumi, kurse shkrepat e të dy anëve qëndrojnë edhe të pangrëna.]

Njësia e kombit dhe shpirti i kombit

E rëndësishme në pikëpamje të historisë së kulturës na paraqitet pyetja nëse Shqipëria duhet konsideruar si një njësi apo si një mozaik. Kur nga mesi i shekullit të kaluar filluan — nga Shqipëria Jugore! — studimet rreth Shqipërisë prej burrash të pajisur me kulturë mendore të lartë e të gjerë si Ami Boué, Hahn e të tjerë, u duk e natyrshme që

Shqipëria, me gjithë ndryshimet e saj lokale, t'u këqyrte si tërësi e njënjëjtë e të vihej si e tillë përkundrejt viseve të tjera të Ballkanit. Por kjo ndërroi me lindjen e specializimit në shkencë. Specialistët iu kthyen tashti vetëm *një* aspekti të formave të jetës shqiptare ose *një* krahine të vendit, pa këqyruar tërësinë. Një pjesë kështu e kufizuar ndritohesh prej tyre në të gjitha pamjet e saj dhe i çelej shkencës. Mirëpo ç'u fitua këtu në thellësi u humb në gjerësi. Dijetarët po mësohen tani, ndryshe nga brezi i mëparshëm, të kenë sy më shumë për pikat diferencuese sesa për pikat lidhëse. U mungon vështrimi i përgjithshëm, i cili ndryshimet lokale të mund t'i shikonte si lloje të *një* specieje dhe t'i përmblihte nën emëruesin e përbashkët shqiptar, të lidhte në një tërësi fijet e përndara. Kurrkund nuk bëhet më pyetja nëse ekziston një njësi shqiptare, sepse nuk ekziston interesi për këtë njësi.

Por njësia është. Është njësi etnike e kulturhistorike, e rrjedhur nga njësia gjeografike. Do vetëm që të zbulohet. Për ta kuptuar duhej rrahur vendi nga njëra anë në tjetrën. Atëhere shlyhen ndryshimet e theksuara, trajta lokale të jetës kalojnë mengadalë njëra në tjetrën dhe bashkohen domosdo në një tërësi të njëllotë. Kjo merr fund atje ku ne të kalojmë kufijtë e lëmës së gjuhës shqipe: na del atëhere përpara një botë tjetër, e ndryshme nga bota shqiptare.

Pamë më sipër se trualli shqiptar na paraqitet gjeografikisht si njësi. Më rëndësi ka se si banojnë e jetojnë njerëzit në këtë truall. Shkenca e banesës shqiptare ndodhet vërtet në fillimet. Megjithatë ne mundim pas sa dimë gjer sot⁶⁰ e me gjithë influencat e huaja të nxjerrim trajta të përbashkëta: Mendimi themelor që vihet për kriter në goditjen e banesave është mundësia e mbrojtjes. Përkundrejt këtij mendimi komoditeti i ndejtjes dhe pikëpamja ekonomike mbeten në rend të dytë. Këtij shpirti i përshtatet shtëpia e fortifikuar, kulla, të cilën e ndeshim më shpesh a më rrallë në gjithë Shqipërinë, dhe në Ballkan kudo atje ku ka ose ka pasur shqiptarë. Është pastaj karakteristike për natyrën individualiste të shqiptarit që ky, ashtu si stërgjyshët ilirë dhe të tjerë popuj indogjermanë të moçëm si p.sh. gjermanët⁶¹, banon një shtëpi të vetme mjaft të izoluar. Kjo me rritjen e familjes së madhe zmadhohet me oborre (Gehöfte), bëhet lagje fisi dhe sëfundi një katund i tërë fisor. Katundi fisor është katundi i vërtetë shqiptar dhe sot e gjithë ditën katundi i zakonshëm i maleve. Me anën e gjuhës shqipe mund t'i ndjekim mirë këto etapa zhvillimi të banesës shqiptare⁶². — Njësia

shqiptare shtrihet edhe në pajimin e brendshëm të shtëpisë nëpër krahina të ndryshme të vendit.

Në lëmë të kostumeve Shqipëria nga ndarja e saj në krahina të veçuara na paraqet një pamje plot ndryshime e ngjyra. Çdo krahinë ka kostumet e saj. Këtyre u shtohen dhe ndryshime në pikëpamje historike, duke qenë që kostumet po të një krahine zhduken e zëvendësohen prej kostumesh të reja e këto të fundit prej më të rejash. Edhe faktorët socialë, konfesionalë, pekuniarë, faktorë të modës e të tjera elemente ndryshuese lozin rol në këtë lëmë. Po me gjithë këtë shumicë ngatërruese mund të themi se e bardha është ngjyra kombëtare e veshjes shqiptare. Veçanërisht kësula e bardhë është ajo që, me gjithë ndryshimet e formës të rrjedhura nga fisi (Kosovë, Dibër, Shqipëri e Mesme, Myzeqe, Labëri etj.) e dallon shqiptarin nëpër gjithë Ballkan. Ngjyra rrjedh nga leshtë e bardhë të dhenve, me të cilat popullsia baritore i end vetë teshat e saj.

Objektet e kulturës materiale të Shqipërisë Veriore, veglat e orenditë të cilat i pat spjeguar në pikëpamje kulturore e historike Baron Nopcsa, na shfaqen në shumicë të njëjta edhe nëpër zona malësore të Jugut. Kjo tregon që toka shqiptare përveç etnikisht na paraqet një njësi të konsiderueshme edhe përsa i përket kulturës materiale. Është vështirë të mohojmë a priori këto lidhje kulturore.

Dukja e jashtme e shqiptarëve është e caktuar nga raca dinarike, e cila përfshin edhe pjesë serbokroate e greke⁶³. Natyrisht tipari somatik na shfaqet në Shqipëri si kudo gjetkë i ndryshuar prej hyrjes së gjakut të huaj. Vetëm se shqiptari qoftë nga shtati i madh ose i vogël, qoftë me kompleksion të bardhë ose të thellë, nga sjellja e tij, nga shprehja e fytyrës, nga vështrimi i syrit dallohet përgjithësisht qartas nga popujt që e rrethojnë.

Por më rëndësi se këto trajta dukjesh të jashtme kanë trajtat e brendshme, që, duke rrjedhur prej të paravet, lidhen me jetën shpirtërore e janë të përbashkëta për të gjitha pjesët e popullit. Janë njohur prej të huajve gjithmonë si cilësitë tipike shqiptare dhe e kanë bërë këtë popull të dalë si komb para botës. Ami Boué⁶⁴ thotë midis të tjerash: «Në qoftë se shqiptari ka cilësi fizike të zviceranëve e të tirolasvet, në qoftë se ai është si edhe ata një ecës i palodhur më këmbë, i cili, me pushkë supit, ngjit e zbret posi dhia majat e maleve, janë bashkuar tek ai edhe gjallëria e shkathhtësia jugore me hollësi e prezencë të jashtë-

zakonshme të mendjes. Janë populli i përgjigjeve të shpejta e therëse par excellence. Krenaria e natyrshme e shqiptarit shprehet në më të voglat fjalë të tij, në gjestet, në ecjen e lehtë edhe mund të themi teatrale. Kuraja i është e lindur. Po të qytetëroheshin, do të bëheshin jo zvice-ranët e Lindjes, po frëngj të hollë, d.m.th. një nga ata popuj të cilët mbi çdo gjë tjetër çmojnë pushtimin. Jeta me rreziqe është aq fort elementi i tyre sa fatkeqësitë në luftë nuk peshojnë aspak për ta.»

J. Ph. Fallmerayer Shqipërinë e quan vendin e vullnetit të fortë dhe të mendjes së shkurtër. Ky nuk është i vetmi kontrast që përmban karakteri i popullit shqiptar. Po meqë kontrasti përmban në vetvete thelbin e dramaticitetit, shohim se një rremb dramatik e përshkon karakterin shqiptar, i mësuar më shumë të veprojë me rrëmbim sesa të rrijë e të mendojë. Karakter dramatik ka dhe historia shqiptare me fytyrat e saj kryesore. Kjo cilësi na shfaqet dhe në poezinë popullore të shqiptarëve.

Nga dijetarët e rinj Herbert Louis thotë: «Një nga përshtypjet më të forta që të lë një pjekje e gjatë me popullsinë shqiptare është sigurisht kjo, që te çdo shqiptar shohim një njeri që vepron me kokë të tij. Secili, i zgjuar qoftë a i trashë, disponon përmbi një fuqi vendimi të konsiderueshme dhe është mësuar të rrezikojë në veprimet e tij kamjen edhe gjakun. Kështu në një situatë të vështirë çdo pjesëmarrës, pavarësisht nga fuqia gjykuese e madhe ose e vogël, tregon një madhësi habitëse, sepse gjithkush është në gjendje të marrë një iniciativë të fortë. Shkurt, nuk ka një masë indiferente.»

Përbri shpirtit të energjisë dhe karakterit rezolut qëndron mungesa e prirjes për mistikë dhe për mendimin spekulativ. Sepse shpirti i popullit shqiptar është krejt realist dhe i kësaj bote. Në përshtatje me këtë drejtim shpirtëror veprimtaria historike e shqiptarit u ka zhvilluar kryesisht në lëmë administrative dhe militare. Cilësitë e tij organizatore janë vërtetuar më shumë në vende të huaja, historia osmane mund ta dëshmojë këtë më së miri, sikurse e dëshmon historia perandorake e Romës për stërgjyshët ilirë të shqiptarëve. Zotësia ushtarake i është e lindur kësaj race, ajo i ka ngjitur shqiptarit vulën e ushtarit të përjetshëm: «Est enim [hec] Albania regio satis lata et magna, habens homines bellicosos ualde, sunt enim optimi sagitarii et lancearii» thotë Anonymi descriptio Europae Orientalis në vitin 1308. Natyra e ushtarit është një trajtë e përbashkët karakteri, një atribut konstant i këtij kombi. Është kryesisht

figura e luftarit, me të cilën kombet e tjera e paraqesin më mirë shqiptarin.

Thelbi shpirtëror i shqiptarit është rezervimi. Kjo veti e popujve të Veriut duhet të na çuditë disi te një popull i Jugut. Kjo cilësi sidoqoftë e dallon këtë popull mjaft thellë prej popujve të tjerë të Europës Jugore. Spjegimin do ta kërkojmë për këtë si në veti të trashëguara si dhe në natyrën e mbyllur e të ashpër të vendit. Kjo e detyron banorin që jo vetëm kundrejt të huajit, por edhe me të afërmin të sillet në fillim i matur e i rezervuar, edhe i mbyllur. Kështu na spjegohet rezervimi i thellë i shpirtit të popullit shqiptar, rezervim i cili na del në dukje edhe në poezinë tonë popullore. Kjo është sjellja e njeriut që është i zoti i vetvetes, i cili, për të ruajtur të drejtat e veta, është i matur në fjalë e në punë. Por ky rezervim nuk përjashton karakterin e hapur, edhe këtë cilësi e gjejmë me të vërtetë te shqiptari. Përbri saj na shfaqet tek ai edhe dhëlpëria e lindur e banorit të maleve. — Është një shenjë e individualistit, siç ka qenë gjithmonë shqiptari, që rezervimi i tij në raste të veçanta të jetës të kthehet në një qëndrim të egër e kokëfortë. Kjo veçori që rron në gjithë shqiptarët është pasoja e racës, e na kallëzohet edhe për ilirët e moçëm. Edhe kolonitë shqiptare, sado të shkëputura prej shekujsh nga toka-mëmë dhe tani në mes të së huajve, nuk kanë mundur ta fshehin sjelljen kokëfortë të karakterit shqiptar.

W. Briquet e përcakton karakterin e popullit shqiptar si kryelartë të pafre, të ndershëm, mik të së vërtetës.⁶⁵

Në lëmë sociale themelin e qendrën e jetës shqiptare e përbën familja e madhe. Shqiptari është për gjithë jetën e tij i lidhur përhera me të. Kjo lidhje patriarkale ekziston jo vetëm për katundarin, por edhe për banorët e qytetit. Ç'është për malësinin fisi dhe familja e madhe është për qytetarin familja. Është qëllimi i jetës së gjithkujt të përpiqet për nderin dhe mbrohtësinë e njerëzve të vet.⁶⁶ Me këtë lidhet malli i tokës që e shquan këtë popull si gjithë popujt malësorë. Dëshira për shtetgim dhe malli i tokës bashkohen te karakteri shqiptar në mënyrë të çuditshme.⁶⁷ Lidhja shpirtërore me tokën u është e përbashkët gjithë shqiptarëve. Kështu ne shohim te i ikuri në dhe të huaj se si, i shtyrë nga malli, dëshiron gjithmonë të kthehet ndonjëherë në atdhe.

Tenaciteti në jetë dhe ngjitja pas zakoneve është një veti tjetër e përbashkët e karakterit shqiptar. «Forca e rezistencës së gjuhës shqipe dëshmon tenacitetin e kombit.»⁶⁸ Edhe në qoftë se doket e zakonet e

sotshme të Shqipërisë nuk paraqesin një fytyrë të njënjëjtë, ruajtja e ngulur e tyre është një fenomen i përbashkët për to. Përgjithësisht analogjive që shkojnë midis zakoneve të krahinave të ndryshme të Shqipërisë nuk u është dhënë vëmendja e duhur. Në qoftë se qërojmë një nga shtresat e influencave të huaja në zakone, do të ndeshim mesëfundi në thelbin indoeuropian. Të nxjerrësh në dritë këtë shtrat themelor do të thotë të zbulosh rishtas atë që ka qenë dikur e përbashkët në zakonet shqiptare. Shumë zakone të lindjes, dasmës e vdekjes, kalendari i së kremteve të vitit, supersticionet dhe figurat mitologjike, paprekësia e gruas dhe e të voglës, qëndrimi i posaçëm ndaj mikut e armikut janë disa nga gjurmët dhe aspektet e këtyre zakoneve të përbashkëta shqiptare. Sidomos është qëndrimi ndaj mikut e armikut ajo që i jep jetës së përditshme njësinë edhe në proverbin shqiptar. Ky qëndrim na shprehet më një anë në pritjen e mikut, më një tjetër në hakmarrjen. Ky zakon i fundit është kufizuar tani në disa krahina të vetmuara, i pari është i gjallë në gjithë vendin. Është me rëndësi në folklorin e Ballkanit që zakonet hospitaliere të grekëve të Veriut dhe të aromunëve na dëshmojnë influencën e kanunit të mikpritjes shqiptare.

Historianët anojnë nga mendimi se përçarja e tokës shqiptare në pjesë të izoluarra dhe dyndjet centrifugale të popullit nuk e kanë lënë Shqipërinë kurrë të shfaqet si njësi në kuptimin historik të fjalës. Mirëpo H. Louis gjen një anë të njënjëjtë në historinë shqiptare në këtë pikë, që popujt e huaj janë përpjekur pareshtur ta shtrojnë këtë vend, por edhe me aq qëndrim shqiptarët janë rebeluar kundër këtij shtrimi. Por edhe të tjera momente historike tipike mund të përmenden: Një rrymë episodike dhe dramatike e përshkon historinë shqiptare. Pastaj është fuqia e personalitetit ajo që pas mendimit tim luan tek shqiptarët si dhe tek stërgjyshët e tyre, ilirët, një rol më të rëndësishëm sesa gjetiu. Një fytyrë e tillë e fortë i bashkonte shqiptarët dhe ngjallte për pak kohë ndjenjën e bashkëjetesës kombëtare. Historia e Shqipërisë është histori e personalitetit. Në pragun e kohës së re ia mbërrin Gjergj Kastrioti të bashkojë fiset e shpërndara shqiptare dhe t'i fusë aktivisht në histori. Shekuj më vonë Shqipëria u vë veshin veprave të Ali Pashë Tepelenës. Ky shtron nën fuqinë e tij një pjesë të madhe të vendit; fiset më të shumta shqiptare shërbejnë nën armët e tij. Vdekja dramatike e tij në Janinë bashkon në ndjenjën e zisë gjithë Shqipërinë. Kënga popullore shqiptare e vajton edhe sot që prej Çamërie gjer në

Shkodër.⁶⁹

Përsa i përket ndarjes konfesionale të Shqipërisë në shumë besime, kjo këtu nuk ka qenë aq ndarëse e thellë si gjetkë. Vërtet se Shqipëria është vendi ku grindjet fetare midis kishave të Perëndimit e të Lindjes janë zhvilluar më së ashpërmi. Është gjithashtu e vërtetë se influencat fetare të huaja kanë eroduar pak nga pak tokat e skajeve shqiptare. Me gjithë këto, njësia e kombit në themel nuk u shkatërrua. Ekzistenca e shumë zakoneve të përbashkëta parakrishtere e krishtere të gjitha shtresat e popullit dhe në gjithë krahinat ka ndihmuar, pa ditur, për ruajtjen e kësaj njësie. Ndërgjegjia e fisit dhe ndjenja nacionale kanë qenë gjithmonë më të forta. Ky fakt i njohur nga shkenca⁷⁰ duhet marrë parasysh kur studiohet historia shqiptare. Ky edhe u ka vërtetuar gjatë saj shpeshherë, në mënyrë që në çaste vendimtare interesat e vaçanta konfesionale u lanë mënjanë para interesash të përbashkëta kombëtare.

Edhe poezia popullore dhe shkrimtaria jonë e dëshmojnë, siç do të shohim, njësinë dhe shpirtin e nacionit. Vazhdimin e gjuhës shqipe të përbashkët gjer në kohë të mesme e pamë më sipër.

Është e vërtetë se krahinat kufizore shqiptare kanë lidhje të thella me fqinjët e tyre ballkanikë, lidhje këto që rrjedhin më shumë prej natyrës dikur shqiptare të këtyre tokave që sot janë bërë të huaja: mirëpo vallë a mos nuk lidhen më ngushtë pjesët shqiptare ndërmjet tyre, gjurmimi i kësaj çështjeje është një nga detyrat kryesore të studimeve shqiptare.

Poezia popullore

Një studimi historik të literaturës shqipe do të ishte e udhës t'i printe një përshkrim i poezisë popullore; se në Ballkan të dy farët janë të ndërlikuara brendësisht ndërmjet tyre, kufijtë e tyre këtu treten më shumë me njëri-tjetrin se kudo gjetkë. Por meqenëse një hyrje më e imtë në poezi popullore do t'i shpërthente caqet e një artikulli, kjo këtu

le të trajtohet aq sa është e nevojshme për të kuptuar edhe nga kjo anë gjenezën e literaturës. Më duket të jetë para së gjithash me rëndësi të vërejmë se poezia popullore shqiptare, sikurse dhe historia përgjithësisht si dhe folklori i shqiptarëve janë trajtuar gjer tani më shumë nga jashtë, duke iu afruar këtyre qoftë prej botës klasike, qoftë nga pikëpamja ballkanistike, sidoqoftë gjithmonë prej pikëpamjesh të veta. Por tani është puna t'i trajtojmë një herë *së brendshmi* këto çështje, por sidomos historinë shqiptare, duke e studiuar nga gjendja e sotme në të shkuarën, duke nxjerrë nga fakte të reja të njohura përfundime për perioda të moçme të errëta.

Përsa i përket veçanërisht poezisë popullore është metodikisht me rëndësi të dihet se kjo paraqet vetëm një pjesë organike, sadoqë njerëzisht më të lartë, të jetës së popullit e të shfaqjeve të saj të përditshme. Nuk mund të kuptohet poezia popullore e jona po mos të njohim jetën shqiptare të vjetër dhe po mos ta kuptojmë poezinë si produkt e si funksion të kësaj jete. Ta shkëputësh nga kjo lidhje e natyrshme dhe ta sjellësh në letër, kjo do të thotë të shqyesh arbitrarisht një bashkim organik. Një mënyrë veprimi e tillë do të ishte sëpaku e njëanshme. Teksti i thatë qëndron ndaj poezisë që derdhet spontane në çastin e përshtatshëm si tabloja e zbehtë ndaj pejsazhit të gjallë. Po të lexojmë p.sh. urime e këngë që përdoren nëpër gosti, nuk mund të fitojmë një ide të vërtetë për situatën e gjallë në të cilin shtrohet një gosti: atmosfera serioze dhe gazmore që mbretëron në odë, miqtë të mblëdhur dhe rreth tyre ata të shtëpisë, të mbajturit strikt të ceremonialit dhe të rregullit që përshkruhet në të pirë, zgjedhja e «dollibashit», të shndërruarit dhe të kryqëzuarit e formulave të urimit, zgjedhja e përshtatshme dhe të kënduarit e këngëve të gostisë. Gjithë këto, po t'i vërejmë në përgjithësi, janë në vetvete një copë jete, fjalët e këngët s'janë veçse një pjesë shpirtërore e këtyre. Kështu pra poezia popullore duhej studiuar tërësisht dhe sintetikisht brenda kuadrit të folklorit të përgjithshëm.

Meqë jeta e popujve të Ballkanit përparon mengadalë, gjithëkjo ngjet edhe me shoqen e saj të pandarë që është poezia popullore. Kjo rron jetën e saj organike, shkon pas frymës së kohës dhe ndërron bashkë me të. Se kjo poezi nuk është këtu e lidhur me një traditë të shkruar, mundet prandaj të përshkojë më lehtë udhën e ndryshimevet. Nga kjo rrjedh karakteri dinamik i poezisë popullore shqiptare si dhe i poezisë së popujve më të shumtë ballkanikë. Kohët e moçme dhe

heronjtë e moçëm vdesin në kujtesën e popullit, dalin heronj të rinj: këngë të moçme zhduken, të reja krijohen; shpeshherë këto përzihen e shkrihen njëra me tjetrën. Gojëdhënë, përrallë; teksti, ritmi, melodia e këngëve janë në një metamorfozë të padukshme, po të përhershme; brezi i ri këndon gjithmonë ndryshe nga i vjetri. Nuk mund të them nëse krijohen dhe përralla të reja. — Kështu pra poezia popullore në më të shumtat vende të Ballkanit është një organizëm i gjallë. Nuk është një send i kulturës dhe i diturisë, është traditë e gjallë e popullit.

Por aq e njëanshme sa ky shikim izolues i poezisë që përmendëm tani do të ishte të studiuarit e prodhimit poetik të një populli ballkanik pa përfshirë poezinë e popujve të tjerë. Karl Krumbacher shkruan⁷¹ se «gjithë popujt e Gadishullit Ballkanik me ishujt që ka anash në lindje e në perëndim dhe me një pjesë të madhe të Azisë së Vogël përmblidhen në një njësi kulturore të madhe, fundamentin historik të së cilës e formon Perandoria e dikurshme Bizantine dhe cementin feja ortodokse.» Duke u nisur nga ky mendim Karl Dieterich ka trajtuar *Poezinë popullore të viseve ballkanike në elementet e saj të përbashkëta*.⁷² — Besoj se te secila nga këto poezi popullore duhet të kemi parasysh dy aspekte: anën nacionale dhe anën ballkanike. E para na vë në gjendje të vërejmë, nëpërmjet të poezisë, shpirtin e këtyre kombeve, e dyta na bën të njohim ndërlidhjet kulturore. E para është një metodë sinkronike, e dyta diakronike. Por dhe mënyra e vështrimit ballkanistik duhet, besoj, nga anë e saj të marrë parasysh dy pikëpamje metodike në problemet e përgjithshme të poezisë popullore: të sqarojë në fillim, si shkallë e parë, lidhjet e veçanta midis poezisë së dy popujve, së dyti vështrimin e përgjithshëm, i cili të përfshijë gjithë popujt e Ballkanit.

Si fillime elementare të gjuhës për një krijim poetik mund të shikojmë ato thirrma e ata tinguj me të cilët ndjellim, nxitim ose zbojmë shtazët. Lindin nga familjariteti i njeriut me botën e shtazëve dhe janë kështu shumica emra përkëdhelëse ose imitim onomatopeik i tingujve shtazore. Shprehet në to, me gjithë shkurtësinë e prerë të tyre, fantazia trajtuese e popullit, fuqia plastike e tij në të krijuar të fjalëve. Kjo duket më fort në përshëndetje, bekime, në formula mallkimi e ngushëllimi, në të thëna të pirjes, në të yshtura e në shumë të tjera. Thuhen në raste të posaçme të jetës a të vitit dhe janë rrenjosur thellë në doke e zakone. Kjo lëmë folklorikisht interesante çel një fushë të gjerë për krahasime etnografike.

Për botën e fëmijëve tanë poezia popullore: fjalë të moçme e rima, gjëza e përralla formon pothuaj të vetmin visar për veprimin e fantazisë dhe për një lëvizje të mendjes. Nga kjo do të rrjedhë shumica e tyre dërmuese në forma e variacione të popujt ballkanikë, ku këta ua kalojnë, si duket, popujve të tjerë të Europës. Hyjnë këtu vargje djepi, vargje gishtërinjsh, këngë të vogla për shi, borë, erë, diell e hënë, vargje shtazësh, rima numërimi dhe rima-varg. Rëndësia e tyre qëndron te ritmi, të cilin fëmijët dinë ta mbajnë mirë. Sidomos enigma (gjëza), meqë fshih sendin e krahasuar, e nxit fantazinë e fëmijës dhe zotësinë e tij në të gjetur. Veç kësaj nuk duhet harruar dhe vlera estetike e shumë enigmave, e cila qëndron në bukurinë e në plastikën e krahasimeve dhe na dëshmon fuqinë e fantazisë dhe pajisjen poetike të këtyre popujve.

Te proverbi pasqyrohet mjaft qartë kultura sociale e një vendi. Kemi në Gadishullin Ballkanik shumë proverbe të huaja, sidomos të hyra nga Lindja, e përbri tyre edhe fjalë të moçme të dala nga trualli i vet. Proverbe të veta do të jenë ato të cilat dëshmojnë qartas origjinën e tyre nga sfera e jetës së këtyre popujve. Kështu pasuria që kanë aromunët e shqiptarët në fjalë të moçme të dala prej sferës së barinjve besoj se lidhet me jetën baritore të këtyre dy popujve dhe spjegohet prej kësaj. Përmendja e shpesh të mikut dhe armikut është, siç pamë, një veçori e proverbit shqiptar. Luftarin, priftin e murgun, qiraxhinë do t'i ndeshim në proverbet e vendeve ballkanike më shpesh se gjetkë. Një vërejtje të posaçme meritojnë proverbet e të thënat juridike të popujve ballkanikë si gjurmë të fundit kanunesh popullore të dikurshme. — Përsa i takon posaçërisht proverbit shqiptar, na bie në sy një njësi e shënueshme në proverbet e krahinave të ndryshme të Shqipërisë.

Në përralla rrojnë sende përgjithësisht njerëzore përbri shpirtit specifik kombëtar, ndikime të huaja përkrah visarit të vendit, motive të pakohëshme pranë motivesh historikisht të lidhura. Mbi këto te përralla na ruhet i gjallë një dokument i kulturës sociale si dhe gjurmë dokesh e zakonesh të lashta. Po të krahasojmë përrallat gege veriore të Malësisë me ato të Toskërisë Jugore, do të na shfaqet te të parat më shumë jeta naive epike me ruajtjen e botës primitive të demonëve dhe me mbajtjen e mitologjisë popullore. Në përrallën e Jugut përkundrazi na paraqitet më shpesh jeta e lëvizur e qyteteve të vogla, bota borgjeze me simpatitë e meritë e saj, zejtaria e censhme, barinj, punëtorë, shtegtarë dhe njerëz të zanatit. Me gjithë këto ndryshime të një shtrese

sekundare përralla shqiptare ka një fytyrë të vetën, e cila mund të themi se e dallon nga përrallat e tjera ballkanike. Kjo na shprehet si në formën e përrallave, si në figurat, motivet dhe në përmbajtjen e tyre.

Përrallat e popujve të Ballkanit janë bashkuar ndërmjet tyre në një farë njësie me anë figurash, motiveve, lënde, stili e gjuhe të përbashkët. Kemi pastaj edhe lidhjen e posaçme në përrallat e dy popujve fqinj midis tyre. Mendimit të fundit i shërbejnë *Përrallat greke shqiptare*⁷³ të Hahn-it, mendimit të dytë *Përrallat e Ballkanit*⁷⁴ të botuara prej August Leskien dhe *Përrallat greke të reja*⁷⁵ të botuara prej Paul Kretschmer. Friedrich von der Leyen-it i duket sot⁷⁶ «se përrallat serbe, bullgare, shqiptare e greke të botuara prej Leskien e Kretschmer mbarojnë e bashkohen më të prera e të këputura sesa përralla të tjera. Të vjen të besosh se ndikimet aq të shumta që venë e vijnë në këto vise i paskan gati shtypur e ndrydhur këto përralla dhe se thërmijat e shpërndara u kanë bashkuar rishitas në mënyrë arbitrare.»

Motive e figura fort të vjetra rrojnë në përrallat e Ballkanit. Do të ishte një punë e këndshme të ndiqnim gjurmët e figurave përrallore të *Odisesë* në Ballkan. Polifemi bën hije akoma në përrallat shqiptare⁷⁷ e serbe, po rron edhe gjetiu në përrallat europiane⁷⁸. Më duket pastaj se kthimi i Odiseut dhe rinjohja e tij ka disa paralele specifike me bren-dinë e këngës shqiptare e greke rreth dhëndrit që kthehet (Kostandini i vogëlith)⁷⁹. Edhe figura e së bukurës së dheut më duket të ketë lidhje me *Odisenë* e Homerit. Përsa i përket përhapjes së saj, ajo rron ndër shqiptarë, grekë, aromunë, kurdë, sirë dhe në përrallën italiane (*La bella del mondo*). Paul Kretschmer⁸⁰ ka shprehur nga arsye gjuhësore mendimin se e bukura e dheut rrjedh prej Orienti, meqë në arabishte përdoret pozitivimi me gjenitiv në vend të superlativit. — E bukura e dheut është në përrallë një grua përbindsh e bukur, e cila banon në një pallat më shpesh nën tokë, e ruajtur prej qenit me tri kokë, Cerberus, prej luanësh, shqipesh dhe shtazësh të tjera të egra, në përrallën greke të re edhe prej arapit. Rreziqe të rënda i presin trimat e princërit që nisen për ta bërë të vetën. Këtij qëllimi nuk i arrijnë gjithmonë, dhe, në qoftë se po, jo për ngahera, sepse ajo u ikën shpeshherë njerëzve. Nga përralla e Pedersen-it *Harap Uzengji*⁸¹, ku e bukura e dheut herë shfaqet në lëkurën e zezë të arapit, herë e zhvesh këtë, Maximilian Lambertz nxjerr natyrën e dyfishtë të saj, «siç e ka toka-mëmë edhe në mitet e popujve të tjerë. Ajo është perëndesha e nënbotës së errët dhe

njëkohësisht e çeljes gazmore të tokës në paraverë, një Persefone-Demetër shqiptare.⁸²» Pas këtij dietari na jepen tri anë të qenies përrallore të së bukurës së dheut: së pari është shuma e bukurisë, më e bukura e botës, së dyti i jepet rëndësi shpeshherë pjesës së dytë të emrit të saj, gjenitivit *e dheut*, pra është e bukura *e dheut*, një perëndeshë e tokës përkundrejt të bukurës së qiellit dhe të bukurës së detit, dhe së treti karakteri i saj është përnjësuar me tipin e përgjithshëm të *fée*-së së fuqishme, të vashës ose princeshës së bukur.

Popullariteti i madh i së bukurës së dheut në përrallat e Ballkanit më duket se do të thotë që ajo gjatë shtegtimit të saj nga Orienti në Gadishullin Ballkanik gjeti këtu përfytyrime të moçme që i shëmbëllenin, me të cilat mundi të shkrihet. Me këtë dua të them magjistaren Kirke. Kjo banon te një ishull i vetmuar, Aiaia, në një shtëpi të bukur me shërbëtoret e saj duke endur e duke kënduar. Njerëzit që i vijnë i ndërron, me verë magjie dhe duke i prekur me purtekën e saj, në luqer-buj dhe në luanë, dhe shokët e Odiseut në derra. Këtë e shpëton Hermes me barin *moly* dhe ky bëhet kështu pastaj miku dhe i dashuri i saj.⁸³ Kjo grua magjistare që banon në një ishull të largët më duket të ketë disa tipare afërsie me të bukurën e dheut. Që të dyja figurat janë, si gra jashtëzakonisht të hijshme, qëllim shtegtimi i trimave të huaj. Mbërritja te të dyja është e lidhur me rreziqe. Që të dyja janë të mençme e dinake, meqë edhe e bukura e dheut tregon herë-herë një karakter dredharak. Pastaj në qoftë se Kirke është një figurë demonike, një magjistare që i ndërron njerëzit në shtazë, dhe rrëfimi i saj një përrallë magjie⁸⁴, një gjë e tillë mund të thuhet edhe për të bukurën e dheut: Në përrallën shqiptare *Binoshët* prej Piana dei Greci në Siqeli plaka që rron pranë së bukurës së dheut stërpik trimin, kalin dhe qenin e tij me një lëng dhe i nguros. I vëllai i ngjall rishtas me vesën e zambakut⁸⁵. Shkenca ka theksuar karakterin ktonik (tokësor) të Kirkes, pas Erich Bethe-s⁸⁶ ajo do të jetë një perëndeshë e vdekjes. Në këtë cilësi i afrohet përsëri të bukurës së dheut, lidhjet e së cilës me botën nën dhe i pamë më sipër. Edhe vërtet që balta e të vdekurve luan një rol në përrallën e së bukurës së dheut. Po më rëndësi se këto më duket se ka fakti që Kirke te Homeri është e bija e Heliosit (diellit) dhe që e bija e diellit na del si një nga figurat e përrallës shqiptare e greke të re⁸⁷. Mbi këto e bija e diellit na shfaqet në përrallën greke si kulmi i bukurisë, një veçori me të cilën zakonisht është e veshur e bukura e dheut: «Ajo qe aq e

bukur sa bija e diellit, dhe kishte rroba që shkëlqenin e vezullonin sa të verboheshin sytë.» Në këngët akrite e bija e diellit na del si një vajzë e bukur që prehet në një shtrat trëndafilësh, e rrethuar prej treqind skllavesh. Kostandini i vogël dashurohet në të, por — khs. të bukurën e dheut! — vetëm pas shumë vështirësive mundet ta marrë. Nga këto duket se e bija e diellit dhe e bukura e dheut kanë afërsi të imtë ndërmjet tyre, po të mos jenë fare identike, dy emra të ndryshme për të njëjtin trupëzim të bukurisë absolute. Në qoftë se kjo afërsi midis bijës së diellit dhe së bukurës së dheut ka ku bazohet dhe në qoftë se Heliada Kirke dhe e bija e diellit nuk janë një barazi emrash ashtu kot e për baft, ahëre edhe nga arsye të logjikës formale nuk mund të mohohet një afërsi në thelb e së bukurës së dheut me Kirken e Homerit. —

Nuk mundim këtu të hyjmë imtas në gojëdhëna. Studimi i gojëdhënave ka të tjera probleme nga studimi i përrallave, meqë gojëdhënat janë të fiksuara për nga vendi dhe gjer më një pikë edhe për nga koha. Mundet të pyesim se «teoria e valëve», me të cilën Johannes Schmidt pat spjeguar marrëdhëniet e gjuhëvet indogjermane ndërmjet tyre, a mos nuk mund të përdoret në gjurmimin e gojëdhënave të një vendi kaq të përmbledhur siç është Ballkani. Do të duhet atëhere që lokalizimet e ndryshme të gojëdhënave të merren si qendra rrethesh, prej ku hapen versionet e tyre të ndryshme në formë valësh. Duhej caktuar pastaj rrezja e rrethit të vlerës së këtyre versioneve — pa lënë natyrisht pas dore interferencat dhe kryqëzimet që këputin rregullsinë. Atëhere do të dilnin zona ndërprerjeje të përbashkëta për dy ose më shumë qarqe të një gojëdhëne. Në këto vende të përbashkëta mund të studioheshin pastaj shtresat dhe radha e shtresave të versioneve. Në këtë mënyrë mund të binte ndonjë dritë përmbi moshën relative të këtyre varianteve të gojëdhënave dhe përmbi prioritetin e një sosh përmbi të tjerat.

Ç'u tha më sipër për poezinë popullore përgjithësisht ka vlerë në një masë të posaçme për këngën popullore. Bash kjo nuk mund të studiohet njëanësisht, e ndarë nga jeta e popullit, duke qenë e lidhur pandarësisht me këtë jetë. Kënga popullore e shoqëron njeriun e Ballkanit prej djepi e gjer në varr. Nuk ka një çast të rëndësishëm në jetën e individit, lindje, dasmë, vdekje, të kremte, ngjarje lokale e historike, që të mos fiksohet në këngë e të mos fisnikërohet e lartësohet prej saj. Kënga

popullore ka pra në këto vise një funksion eminentisht social. Ajo këtu përbën, siç e kanë vërejtur njohës të këtyre vendeve,⁸⁸ gëzimin e dëfrimit mendor kryesor dhe pothuaj të vetëm në kohë prehjeje, në të kremte e në ditë të lëvruame (të punës), zëvendësimin e dëfrimeve që janë të zakonshme ndër popuj të tjerë. Dhe kënga popullore nuk është këtu e kufizuar në pjesë të caktuara të popullit: për burra e gra, për të gjitha moshat, dyert, shkallët e mjeshtëritë ka një numër të pamasë këngësh. Këngët popullore të viseve ballkanike duhen trajtuar jo vetëm sintetikisht në lidhjen ballkanike dhe në lidhjen e njëanshme nga një popull te tjetri, por edhe një nga një në vetvete, si shprehje e thjeshtë e frymës së popullit përkatës. Karakteri dhe historia e një populli pasqyrohen më së miri në poezinë popullore. Zbatimi i psikologjisë së popujve në studimet e këngës popullore mund të jetë në çdo rasë i dobishëm. Në këtë kuptim shkurtësia dhe mbarimi i përnjëhershëm i këngës popullore shqiptare, gjerësia epike dhe fryma elegjike e këngës serbe, rreptësia e shpeshhtë e këngës bullgare, retorika dhe një farë mburrje e këngës greke, malli i pacaktuar i këngës rumune, karakteri konkret e realist i ftohtë i këngës aromune nuk do ta çuditin ballkanistin që njeh historinë e këtyre popujve: Se këto shenja janë të ngulura në karakterin e popullit.

Një pjesë kryesore të poezisë së vendeve ballkanike e përbën epika. Edhe Gustav Meyer thotë⁸⁹ që «te popujt ballkanikë përkundrejt popujsh të tjerë kënga popullore epike na shfaqet e kultivuar në mënyrë të veçantë». Kjo gjë edhe është e kuptueshme te një vend që, si Gadishulli Ballkanik, ka qenë përshkuar gjithmonë prej luftrash. Këta popuj janë edhe sot më afër qëndrimit epik të shpirtit sesa p.sh. popujt e Perëndimit. Nderimi i trimave dhe lartësimi i tyre në këngë është në Ballkan edhe tash një dukje e shpeshhtë.

Se cilat janë më të moçmet këngë epike të popujve të Ballkanit dhe se si duheshin datuar, se cilat arrijnë në thelbin e tyre në kohën e vjetër, cilat në fillimin e kohës së mesme, kjo nuk do të jetë e mundur kurrë të caktohet. Spjegimi i kësaj duhet kërkuar mësëfundi në natyrën e vendit dhe të popujve të tij: Përçarja e këtij trualli në pjesë të vogla nuk ka lënë kurrë të lindë jo vetëm një histori e një kulturë në masa të mëdha, po as edhe qarqe këngësh epike që të shtrihen gjerazi gjeografikisht dhe kohësisht si p.sh. ndër gjermanët dhe frëngjtë. Këngët këtu nuk kanë një jetë organikisht të gjatë. Ato kryqëzojnë ose zhdukjin njëra-tjetrën.

Shpartallimi i fuqive historike të Gadishullit Ballkanik na shfaqet qartas edhe në to. — Në këtë visar më të vjetër epik mund të njehim ato këngë e gojëdhëna që pasqyrojnë motive njerëzore të lashta, gjendje e zakone të moçme pagane. — Natyrisht që nga perioda rumune e vjetër e shqiptare e fillimit të Mesjetës nuk ka mbetur asgjë në këngët. Vetëm këngët e hajdutëve që janë ende të gjalla në gjithë Gadishullin Ballkanik mund t'i shtyjme gjer në Mesjetën e hershme, sepse hajdutëria këtu rrjedh nga koha e mesme. Monçilio, i cili pat themeluar një shtet cubash në Ballkan, është dëshmia më e mirë për këtë. Përgjithësisht do të mjaftohemi të themi se poezia popullore shqiptare e kohës së mesme ka pasur, si dhe tani, përpjekje me poezinë popullore serbe e greke, ashtu dhe aromune.

Por të parat këngë epike historikisht të datueshme të popujve ballkanikë, të shqiptarëve, serbëve, bullgarëve e rumunëve i takojnë mbarimit të kohës së mesme: rrjedhin prej shekullit XIV. Vetëm epika popullore greke e mesme është më e vjetër. Është një fakt për t'u vërejtur se epika popullore e viseve të Ballkanit fillon me kohën turke dhe mbaron me të. Ajo lindet dhe zhdrivillohet nga kontrasti me turqit dhe nga kundërshtimi ndaj tyre. Ajo çelet me përpjekjet e para luftarake të këtyre popujve me ta dhe zhduket në përmbajtje me ikjen e tyre nga Gadishulli. Edhe Digenis Akritas që është disi më i moçëm mbruhet nga luftrat kufizore me popujt e Lindjes së Afërt. Shohim kështu pra se osmanët, siç çelin një epokë të re për historinë dhe strukturën sociale të këtyre popujve, kështu japin edhe shtytjen e parë për lindjen e një epike popullore të re. Përpjekjet e para të tyre me popuj ballkanikë u mësojnë këtyre mënyrën e re superiore të luftës bashkë me gjuhën ushtarake; analogisht doli në lëmën e poezisë domosdo një epikë e re heroike. Kjo epikë qëndron te praku i kohës turke. Në të na dalin në dukje si gjendja bizantine-paraturke⁹⁰, ashtu dhe gjendja e parë turke. Shohim te kjo epikë kalimin e forcuar të trajtave bizantine-perëndimore të jetës së kësaj toke në trajta të reja orientale, tretjen e thërmimit e kulturës së Mesjetës së vonë në kondita disi të egërsuara. Kështu na del edhe nga poezia popullore po ajo pamje që na ka mësuar për këtë kohë dija historike.⁹¹

Duke qenë se osmanët u bënë në shumë pika trashëgimtarët e Bizantit dhe e vazhduan organikisht këtë trashëgim në histori, dhe meqë, sidomos me islamizimin e shumë pjesëve të Ballkanit, ata përfa-

qësojnë për këto vende një fenomen historik të ri, kjo pati pasojë edhe në lëmin e poezisë popullore. Ndër muhamedanë vazhduan të jetojnë këngët dhe motivet e kohës bizantine, por duke marrë rrobën e re. Po islamizohen veçanërisht emrat e heronjve: kështu Kostandini i vogëlith i këngëve akrite ndërrohet në Shqipërinë pasturke e bëhet në Toskëri Ymer Ago, në Gegëri Aga Imeri dhe Ali Bajraktari. Përkundrazi te krishterët e Ballkanit vazhdon i palodhur kontrasti ndaj osmanëve, gjersa pëlçet rishtas në luftrat dhe në këngët e lirisë nga fillimi i shekullit të kaluar. Muhamedanët përkundrazi u pajtuan me gjendjen e re turke edhe nga shkaku i shkallës së tyre sociale të favorizuar. Pra ndarja e besimit solli me vete edhe ndryshime në poezi. Këngët e muhamedanëve boshnjakë janë sot p.sh. më të gjata se këngët e të krishterëve.⁹² Por në *një* pikë këngët epike të popujve të Ballkanit bashkohen pa përjash-tim: këndojnë më me dëshirë fitoret përmbi pushtuesit e rinj sesa humbjet që pësuan prej tyre.

Epika popullore e viseve ballkanike nga koha bizantine dhe nga fillimi i kohës turke ndodhet në hijen e bizantinit Digenis Akritas, i cili u përhap edhe ndër rusë e ndër armenë. Një qark epik përfshin këtu, duke dalë prej Bizanti, serbët dhe shqiptarët e Italisë. Këta të fundit, të ikur në shekullin XV, i shpëtuan e i morën këto këngë në Itali para vendosjes së turqvet në Shqipëri. Këto këngë te serbët grumbullohen, siç dihet, përreth figurës së Kraljeviçit Marko, te shqiptarët e Italisë rreth Skënderbeut. Shpata damaskine dhe vera e Malvazisë e këngës akrite greke na dalin përpara në këngën serbe (säblja dëmeškinja, vîna malväsije) dhe italo-shqiptare (cåbje dhamashkine, vera marvazeze). Atmosfera e këngëve shqiptare të Italisë është për një pjesë të madhe akritike. Që kënga e Lenorës, e përhapur në gjithë popujt ballkanikë, ka ngjyrë akritike, e ka treguar Šišmanov-i.⁹³ Maximilian Lambertz ka vërejtur⁹⁴ se Kostandini i vogëlith, dhëndri që kthehet, heroi aq i kënduar i shqiptarëve të Italisë, bën pjesë në qarkun e këngëve akritike. Në analogjitë që ka Digenis Akritas me Marko Kraljeviçin e që përmend Dieterich-u⁹⁵ merr pjesë nganjëherë edhe Skënderbeu i italo-shqiptarëve: Siç ndërhyjnë saracenët në të dy qarqet e para, kështu turqit në këngën italo-shqiptare: në eposin e Digenis-it një princ Sirie rrëmben të bijën e strategut perandorak Andronikos, të ëmën e heroit; në këngën e Markos një pirat arab kërkon për grua të bijën e Kostandinit të Madh, të cilën pastaj e çliron Markoja. Në këngën italo-

shqiptare turqit rrëmbejnë të motrën e Skënderbeut, por e lënë të lirë sapo marrin vesh se kush është. Le të përmendim këtu dhe disa trajta të tjera të përbashkëta: Kënga akritike e Vllahut të vogël (Βλαχόπουλο), i cili është shtruar në tryezë me Kostandinin dhe Aleksin, ngrihet pastaj befás e lufton me saracenët dhe i mund këta, na del e njëjtë gjer në detaje të kënga italo-shqiptare e Skënderbeut dhe Milo Shinit. Përmbajtjen e këngëve akritike, në të cilën djaloshi turk rrëmben greken Irene, të bijën e Bardas Skliros, dhe sheh mënëfund se është motra e vet, e gjejmë, si vëren Pio Bondioli⁹⁶, të këngët serbe dhe italo-shqiptare. Edhe vetë heroi Digenis ka influencuar jo vetëm figurën e Princit Marko, por siç besoj, edhe Skënderbeun e shqiptarëvet të Italisë. Vdekja e Skënderbeut lidhet në këngët italo-shqiptare me ndodhira kozmike sikurse dhe vdekja e Akritit: vetëtin e bubullin, toka dridhet dhe pëlçet me vdekjen e një fatosi të tillë. Në pikëpamje gjuhësore mund të përmendim si trajtë të njëjtë emrin *Amurat* «Muradi II», emër i formuar me protezë të *a*-së si në historiografinë bizantine e në këngët akritike ashtu dhe në këngën italo-shqiptare. Këto dhe të tjera paralele rrjedhin jo vetëm nga shtresa kulturore bizantine e shqiptarëvet të kohës së mesme dhe nga qëndrimi i përkohshëm dhe mjaft i gjatë i tyre në Greqi, por edhe nga fakti që disa këngë akritike kanë lindur në afërsi gjeografike me shqiptarët: kështu p.sh. në këngën akritike të Konstandinit të vogël dhe të bijës së diellit përmendet emri i vendit Ajdonát (Paramithí) të Çamërisë.

Një tjetër qark epik përfshin tokën serbokroate dhe Shqipërinë Veriore, me degëzime nga Bullgaria. Është ky cikli i këngëve rreth çiftit vëllazëror Muji e Halili, agallarë të Jutbinës. Te këto këngë pasqyrohet ndikimi i islamizimit të Ballkanit. Heronjtë të kënga shqiptare janë përfaqësuesit e trimërisë shqiptare muhamedane në luftë me shqetë ortodoksë⁹⁷. Ka përveç kësaj edhe gjurmë të kohës bizantine si p.sh. njehja e ʔaksimi i shtëpive sipas *timit*, (Tim për tim ka 'i dash të pjekun)⁹⁸ të kënga e Gjergj Elez Alisë, sipas τὸ καπνικὸν të administratës bizantine⁹⁹. T'i këqyrim nga pikëpamja sociale-historike, këto këngë këndojnë një shtresë aristokrate zotërinjsh dhe cubash, dhe me këtë duket të përkojë dhe stili, që s'bie kurrë të bëhet banal, po na shfaq një farë fisnikërie të formës dhe të mendimeve. Mua te Muji e Halili më pëlqen të shoh analogjinë shqiptare të lashtë e ndofta ilire të atij çifti vëllazërish trima që ndeshim te grekët (Dioskurët), keltët, gjermanët

dhe indët (Açvins)¹⁰⁰ si dhe në epopenë heroike armene: Sanazar dhe Aslimelik, të bijtë e mbretit Senekerim¹⁰¹.

Si na paraqiten këto këngë sot, në versionet shqiptare e bullgare me trokëtë e tyre pesëkëmbëshe shohim ndikimin e poezisë popullore serbokroate sëpaku në pikëpamje metrike¹⁰². Mirëpo se si ka qenë proporcioni më parë nuk mund ta diktojmë, ngaqë duket e pamundur të hyjmë dot në gjenezën e këtyre këngëve. Ka shenja edhe për rolin dhënës të poezisë popullore shqiptare brenda këtij qerthulli epik. Heronjtë Gjergj Elez Alija, Destar Osman Aga, Bur Eleze Krajli, Siran Osman Aga, Bud Aline Tali, Ager Isvan Aga, Sokol' Halil Aga, Hake Vrak Shabani e të tjerë barazohen me emrat e tyre tri pjesësh me emra personash shqiptarë të Veriut si Ded Gjo Luli, Prék Bib Doda, Prelë Memë Ujka (ky në Kosovë), me emra labe si Rustem Gjonedaj = R. Gjon Dedaj, Isa Gjonzeneli, Metat Gjonligu, Muslim Gjoleka, Ali Gjovarfi etj. Emra tri pjesësh të personave ka pasur në Shqipëri edhe në kohë të mesme, si paraniku Gjin Bua Shpata në Jug. Tanush Topia në një këngë popullore të sotme nga Kruja quhet Tanush Muzak Topia¹⁰³. Në ciklin e Mujit e të Halilit kjo tendencë është aq e fortë, sa edhe emra dy pjesësh bëhen me përsëritje të njëres pjesë emra tri pjesësh: Aga Hasan Agë, beg-e Mehmet begu, Begu Allaj Beg, Begu Hasan Beg, Pasha Hasan Pashë, Ali Borxh Alija etj.¹⁰⁴ Këto emra tripjesëshe të personave, që i kanë së bashku si Veriu dhe jugu i Shqipërisë, janë gjurmë të lashta të njësisë së dikurshme shqiptare që trajtuam më sipër. Cilado qoftë origjina e tyre brenda truallit shqiptar, këto kanë mbirë pa dyshim te ky truall dhe spjegohen me rëndësinë që i jep shqiptari ruajtjes së fisit të vet edhe në emër. Mund të shohim këtu në këtë qark këngësh epike rrezatimin e emrave malësore shqiptare. — Përveç kësaj Gjergj Elez Alija, heroi popullor aq i kënduar ndër shqiptarë, boshnjakë muhamedanë e bullgarë rron te këta dy popuj sllavë me emrin e parë shqiptar Gjergj, Gerg. Nga këto dhe të tjera shenja shihet qartas ndikimi shqiptar. Edhe ato figura e motive që janë karakteristike për poezinë popullore jugosllave dhe që u mungojnë sllavëve të tjerë, na japin të mendojmë se mos rrjedhin prej nënshtresës ilire, të cilët sllavët jugorë e ndeshën kur pushtuan këto vise. Procesi sllavo-shqiptar i huamarrjes do të ketë qenë këtu i dyfishtë: Sikurse lëndë gojëdhënash në thelb gjermanike hynë në Francë dhe u punuan këtu, për t'u kthyer pastaj rishtas ndër gjermanë, kështu dhe sllavët në simbiozën që bënë me shqiptarët

e moçëm do të kenë marrë lëndën e këngëve të këtyre dhe do t'ua kenë kthyer pastaj rishtas në një trajtë disi të sllavizuar. Një gjurmim objektiv, pa premisa, i lirë nga paragjykime mund të diktojë diçka në këtë lëmë.

Si partnere femërore e heronjve në këtë qark epik sllavo-shqiptar na paraqitet nga ana sllave *vila*, nga ana shqiptare *zâna*. Të dyja figurat si vasha gazmore vallëzuese, që u ndihin trimavet e u lajmërojnë të mira e të këqia, por edhe si zëri i natyrës e i ndërgjegjes njerëzore, janë në thelb të afërta njëra me tjetrën. Këto ndihmëqare të trimave rrojnë në Ballkan vetëm atje ku, si te shqiptarët e te sllavët, ekziston edhe ndjenja epike e jetës. Gjetiu janë zhdukur. Në Rumani rrojnë si nimfa të bukura pyjesh, pa pasur lidhje me heronjtë epikë. Në këngën greke rolin e vilës e të zânës si lajmëtare e këshilltare e si pjesëmarrëse të natyrës e përbush një zog, nganjëherë natyra vetë si re e male. Në të njëjtin situacion poetik mund të shohim se si në këngën serbe na del *vila*, në këngën shqiptare *zâna*, e në greken zogu. Por te cikli akritik mund të zbulojmë, them, si trajtë të ndërmjeme, një farë vile para se të arrijmë te zogu i grekëvet të sotëm: Amazona e Aleksandrit të Madh, me të cilën lufton Digenis Akritas poashtu siç lufton Marko Kraljeviçi me vilën (sh. dhe Dieterich 411).

Ndër emra popullore të këngëve epike të Gadishullit Ballkanik doraj-dorën mund të përmendim vetëm dy izoglosa: njëra shkon nëpër lëmën serbokroate dhe shqiptare veriore, këngët quhen këtu «këngë trimash»: serb. *pjesme junačke*, o *junačima* o junaštvo, për të emëruar ato këngë që këndojnë trima ose personalitete me karakter pak a shumë historik¹⁰⁵, shqip *kangë kreshnikësh*¹⁰⁶. Që ky emërim nuk është i panjohur dhe në Toskëri, si në Korçë e Labëri, këtë na e dëshmon fillimi i një kënge labe:

*Do të thom një këngë vetë,
Këngë trimi le të jetë.*

Një izoglosë e dytë shtrihet më larg, duke përfshirë këngën shqiptare, serbokroate, rumune dhe ruse; këto këngë epike quhen «këngë pleqërishte»: shqip (toskërishte e lindjes) *këngë pleqërishte*, (Veriu) *kângë të moçme*¹⁰⁷, serbokr. *starinske*, rum. *bătrânește*, rus. *stariny*. Nuk mund të vendos nëse kjo analogji e rëndësishme duhet çmuar vetëm si një paralelizëm spontan apo si një lidhje gjenetike, duke i takuar roli

ndërmjetës këngës popullore rumune.

Karakter lirik-dramatik kanë këngët që këndojnë kulmin dhe mbarimin e jetës së njeriut: kënga e dasmës dhe ligjet (vajtimet). Një frymë e njëjtë i përshkon gjithë këngët shqiptare të dasmës. Në to ndërron kori i burrave me korin e grave, kori i anës së nuses me korin e krushqvet. Ana dramatike e tyre rrjedh jo vetëm nga natyra e tyre si këngë korale, po edhe nga skenat e simuluarat të një rrëmbimi dramatik të nuses, siç shihen p.sh. nëpër disa krahina të Atdheut dhe ndër shqiptarë të Greqisë e të Italisë përpara derës së shtëpisë së nuses kur e marrin, mbeturinë e fundit e zakonit të rrëmbimit të dikurshëm të gruas. Këngë korale janë dhe ligjet, kënga elegjike e korit të grave. Ky kor përsërit në distanca ritmike të shënuara refrenin e vargjeve që këndon solo ajo grua që i prin korit. Refreni është koral dhe lirik. Ligjet përbëjnë një nga pjesët më kryesore dhe më të bukura të poezisë popullore të shqiptarëve. Se te këta është i gjallë kulti i të vdekurve e i trimave. Trimat e vdekur përmenden me zemër dhe lartësohen poetikisht jo vetëm në ligjet e grave, por edhe në gostitë e burrave. Momenti psikologjik në një situacion poetik të tillë është prania shpirtërore e të vdekurit; kulti i heronjve pothuajse e bën trimin e vdekur të ngjallet rishtas dhe të marrë pjesë shpirtërisht në këto mbledhje. Është me rëndësi për njësinë shqiptare që nëpër ligjet e krahinave të ndryshme shkon një frymë e njëllotje dhe e përbashkët shqiptare. Kjo shprehet si në kuptimin e botës si dhe në elementet formale dhe në mjetet e stilit.

Që këngët e popujvet ballkanikë duan kuptuar nga jeta sociale e këtyre, na e tregojnë këngët e përmallshme të mërgimit. Këto kanë lindur nga mërgimi i shpeshtë i burrave jashtë vendit.¹⁰⁸ Dëshira e përherëshme e shqiptarit për shtegtim na shprehet edhe nëpër këto këngë. Mirëpo shqiptarët si popull luftarak i vërtetë kanë edhe këngë të bukura ushtarësh. Këndohen në këto dyndjet e këtyre *Landsknecht*-ve në fushat e luftrave më të njohura të Europës Juglindore, jeta e vrazhdë ushtarake, fitoret e shpeshta dhe jo më nëfund malli i këtyre luftarëve që vdesin larg vendit të vet në dhe të huaj.

Po sidomos kënga e dashurisë është ajo që na shpalon shpirtin e fshehtë të këtyre njerëzve dhe institucionet sociale intime të tyre. Karl Dieterich thekson se nga shkaku i mbylljes së gjinisë femërore duhet që në jetën dashurore të këtyre popujve fshehtësia të lozë një rol shumë më të madh se gjetiu. «Nga shkaku i zakoneve shumë të forta e

patriarkale armiku më i rreptë i të dashurve është te këta popuj i vëllai i vajzës.»¹⁰⁹ Kjo spjegohet me faktin se lidhjet e dashurisë së vëllait për motër janë këtu, siç vëren Sismanov¹¹⁰, shumë më të ngushta sesa lidhja e të dashurve ndërmjet tyre. Lartësimi i dashurisë së vëllait dhe i dashurisë së motrës është një motiv i shpeshtë i poezisë së gjithë popujve të Ballkanit dhe karakteristike për ta. Për këtë mund të sillnim shembuj të panumërt. Tema e këngëve dashurore s'është aq lumturia e dashurisë sesa më shumë renoncimi i hidhur. Përralla e vjetër e dy fëmijëve mbretërorë, që nuk arritën dot te njëri-tjetri, është në këto vende shpeshherë realitet i gjallë. Posaçërisht martesë e vajzës së re me një burrë plak, e rrjedhur nga gjendja shoqërore, dhe njëkohësisht edhe renoncimi i saj në dashuri është një temë e shpeshtë e poezisë popullore ballkanike, temë që përsëritet në variacione të panumërta. Nganjëherë këto këngë mbarojnë në mënyrë humoristike e komike: vajza e liron veten sëpaku në këngë, ajo i shpëton plakut duke ikur te i dashuri i saj. Po këto këngë mbarojnë më shumë në mënyrë të hidhët. Me gjithë këtë është një gjë e bukur te poezia popullore që kjo ata që qenë të ndarë në jetë i bashkon në vdekje. Vaji i natyrës për dashuri fatkeqë simbolizohet me të ndërlikuarit e dy bimëve përmbi varret e të dashurve fatkëqinj. Mbi varrin e trimit mbin një bredh, një panjë, selvi ose borigë, përmbi varrin e vashës një bredh, selvi ose trëndafil,¹¹¹ po më shumë një hardhi, me rrushtë e së cilës le të njomë grykën udhëtari.

Përbri këtyre vargjeve elegjike të dashurisë, në male të Veriut e të Jugut kanë këngë që përmbajnë një ton realist e disi të ashpër, mund të themi natyralist. Pasqyrohet në to botëkuptimi naiv e i vrazhdë i malësorit, ngjitja e tij te vlerat fizike të gruas, në përshtatje me jetën e ashpër që bëjnë këto fise.

Banorit të Gadishullit Ballkanik i pëlqen të shprehë plastikisht, me krahasime, vlerat fizike të gruas: «Shtati i gruas krahasohet me një selvi, me një purtekë të artë, me një fill ari, edhe me një kalli, shtati i burrit me bredhin ose me pishën, fytyra e vashës me diellin ose me yllin e mëngjesit, leshrat me fije ari ose me tela kitarre, ballët me hënë, vetullat me një gajtan ose më shpesh me avgella, edhe me jataganë¹¹², sytë me ullinj, kolumbrí ose rrush¹¹³, faqet me mollë, buzët me korale¹¹⁴, qafa e gusha me farfurí (porcelan) ose manna, gjiri me limonë ose alabastër, nganjëherë edhe me një poç vere të mbushur¹¹⁵, mesi me një unazë, duart me qirinj.»¹¹⁶ Dieterich-u këtu gjen remineshenca nga poezia

popullore italiane, po thekson edhe ngjyrën orientale të poezisë greke të re. Mua më duket se këtu duhet shikuar ekskluzivisht influencë orientale, sepse bash theksimi i anës fizike të dashurisë na duket karakteristike për këtë. Edhe në epikën popullore armene këndojnë: «Po në pyetsh për syt' e saj, U përngjajnë filxhaneve kineze.»¹¹⁷

Një ndarje gjeografike-regionale e këngëve popullore shqiptare nuk mund të ndërmerret as nga brendia e tyre shpirtërore, nga kuptimi i botës, as nga ana e tyre formale, as edhe nga mjetet e brendshme të shprehjes si metaforat e figurat. Sepse këto elemente janë përfaqësuar këtu kudo në të njëjtën mënyrë, pra studimi i tyre jep si përfundim shumë më fort njësinë e ngjeshur të tyre sesa ndarjen e këngës popullore shqiptare. Një ndarje mund ta bëjmë më lehtas pas mjeteve të jashtme të shprehjes, nga ana metrike-ritmike dhe muzikore: pas versit dhe melodisë. Vërtet se njësia e dikurshme duket se ndrit së poshtmi edhe këtu nëpër shumicën e sotme të vargjeve e melodive: sepse mund të shohim se ritmi e melodia e këngëve të krahinave të afërme kalojnë gradualisht dhe pa kuptuar njëra në tjetrën dhe mund të bashkoheshin së paku historikisht në një njësi të përbashkët. Mirëpo me gjithë këtë, ndikimet e gjata të huaja duket se kanë qenë aq të paprera në këtë lëmë, sa mund të flasim tani për ndryshime lokale të shënueshme.

Duhet pikësëpari të kemi parasysh se këto këngë normalisht nuk fliten ose recitohen, po këndohen me zë dhe shpeshherë kërcehen me valle. Ritmi i gjallë — si gjatësia e rrokjeve ashtu dhe theksi e numri i tyre — , i cili bëhet i dukshëm te kënga e kënduar, është një ritëm krejt i ndryshëm nga ritmi që do të nxjerrim nga versi i folur. Versi shqiptar, kur këndohet me zë, merr një dukje tjetër duke futur partikla si oh, moré, vaj, haj etj.¹¹⁸ Kështu vargu trokaik tetërrokësh i këngës labe pjesërisht me anë të këtyre partiklave dhe pjesërisht me zgjatjen e dyfishhtë (dy moresh) të rrokjeve bëhet varg gjashtëmbëdhjetë rrokjesh. Nga kjo vërejtje del se kufijtë e caktuar prej metrikës ndërmjet ritmit kuantitativ dhe ritmit numerik humbasin, në lëmën e poezisë popullore, shumë nga vlera e tyre absolute, kur këto këngë t'i mendojmë vërtet si këngë të kënduara: Sepse zgjatja e rrokjeve përmbush këtu po atë funksion sikurse dyfishimi i numrit të rrokjeve, dhe mundet pra ta zëvendësojë këtë të fundit. Këto fakte nuk duan lënë pas dore në studimin e metrikës popullore shqiptare si dhe përgjithësisht të metrikës së popujve ballkanikë. Në lidhje me këto një studim gjenetik i metrikës popullore

re, i mbështetur në këngën e kënduar dhe të kërcyer me valle, pra në elemente të ndarjes së lashtë të fiseve, duhet preferuar nga një ndarje sistematike e skematike e vargjeve popullore.

Është për të vënë re edhe kjo që ritmi i këngës së kënduar, po të shoqërohet me valle, ndryshohet prej kësaj në një farë mënyre. Proporcioni i ndërsjelltë i ritmit të këngës, i melodisë e i valles është në këngën shqiptare aq intim sa dhe i pasqaruar. Përkundrazi në proporcionin e melodisë ndaj tekstit pjesa konstante është melodia: «Në metrikën popullore të viseve ballkanike melodia stereotipe e pandryshuar i ngarkohet tekstit dhe kështu ky mbulohet e priset krejt».¹¹⁹

Përsa u takon ndikimeve të huaja, ndikimi turk-oriental në Gadishullin Ballkanik është përqendruar qysh në fillim kryesisht në qytete dhe së këndejmi u zgjerua pak nga pak duke u shtrirë edhe mbi katunde. Influenca turke ka qenë influencë qytetare. Ajo na shprehet si në jetën e përditshme sociale e shtëpiake ashtu edhe në doke e zakone, në gjuhë dhe në muzikë popullore. Këto aspekte të influencës turke shkojnë dora-dorës me shoqja-shoqen, njëra flet dhe për tjetrën, meloditë orientale janë njëkohësisht një masë për influencën turke përgjithësisht. Mjafton të dëgjojmë në një natë vere këngët që këndohen në ndonjë qytet të Shqipërisë së Mesme për ta ndjerë qartas gjithë magjinë e tyre orientale. Po Shqipëria është edhe vendi ku meloditë orientale-islame janë përzier me meloditë bizantine që gjetën këtu, të cilat prej kishës patën hyrë edhe në popull. Dallimi i tyre bëhet këtu më i vështirë nga fakti që meloditë arabe-islame qenë përzier një herë që në Orient me meloditë bizantine. Sepse, siç ka vërejtur Robert Lachmann¹²⁰, dëfrimi muzikor në qendrat islame të para të shekullit VII e VIII do t'ia ketë detyruar stilin e vet kryesisht influencës bizantine, gjë që del qartas edhe nga instrumentari i tyre. Më e pastër tregohet influenza e melodive bizantine të kohës së mesme në këngën liturgjike dhe në këngën fetare dhe, duke u zgjeruar së këtejmi, edhe në këngën profane të shqiptarëve të Italisë, si në këngën kishtarë të të krishterëve ortodoksë të Shqipërisë Jugore.

Por në malet e Shqipërisë janë ruajtur të gjalla meloditë e lashta të vendit. Meloditë që do të jenë muzikalisht dhe kronologjikisht më të vjetra, rrojnë në këngët e malësorëve të Shqipërisë Veriore. Kjo këngë solo e fortë është shprehja e qëmoçme e malësorit të lirë, gjurma tingëllore e fundit e shtresës primere të kulturës shqiptare. Simboli muzikal i

shtëpisë së vetmuar, i ekzistencës së izoluar dhe i karakterit individualist të njeriut të malit na paraqitet qartas në këto melodi. Dëshira e këngës e kap përnjëherit malësorin. Ai zë veshët dhe vë zakonisht një pëllëmbë të dorës përmbi faqe, ngre fytyrën në ajër dhe këndon këngën e tij. Kjo fillon e ulët dhe e qetë, ngrihet menjëherë në lartësinë më shqerrëse të tonit dhe në forcën më të madhe të zërit, për të rënë pastaj në mbarim të çdo versi gjatas e shtruaras në gjendjen e parë e fillestare të zërit. Po t'i shikojmë për nga gjeneza, këto melodi nuk janë tjetër veçse thirrma e britur dhe e dëgjueshme që larg, të cilën e ndeshim në gjithë popujt malësorë.¹²¹ Por në rasën tonë mund të kemi të bëjmë me thirrjen e kasnecit e cila në kanunin tradicional të këtyre viseve luan një rol të rëndësishëm në pikëpamje sociale-ushtarake. Kjo do të jetë ndofta origjina e këtyre melodive. Këto melodi shqiptare janë përzier në variacione të panumërta me melodi orientale; interesant janë këtu shkallët e ndërmjeme lokale. Në qytetet e Shqipërisë Veriore e të Mesme mbisundojnë përgjithësisht meloditë orientale. Por ka rëndësi të konstatohet shkalla e ballkanizimit të melodive orientale, të matim pra se sa janë larguar meloditë orientale nga karakteri i tyre origjinal nën influencën e melodive të krahinave relative të Ballkanit, se sa pra janë ndryshuar në këto vise. Sepse tingulli themelor i hidhët e monoton i melodive të popujvet ballkanikë është i ndryshëm prej karakterit ekstatik-sensual të melodive orientale, ai tingull lidhet më shumë me karakterin e vendit dhe të banorëve të këtij Gadishulli.

Një tokë e tërë në të cilën meloditë e moçme të vendit janë ruajtur më mirë është Toskëria. Një krahasim i parë i këtyre melodive me ato të Veriut shqiptar na jep një ndryshim themelor: këto të fundit janë këngë solo, të Toskërisë janë këngë polifone, korale. Janë më të reja se meloditë shqiptare veriore, shprehje simbolike jo e banesës së vetmuar, po e kolektivitetit, janë këngë shoqërore. Se sa më e përparuar na paraqitet jeta shoqërore e Jugut ndaj jetës së Veriut, kjo na pasqyrohet në meloditë popullore. Brenda këtyre melodive si shprehje muzikore të ndarjes së dikurshme në fise kemi sot dy rrethe: pjesën toske në kuptimin e vërtetë, gjeografikisht toske të lindjes dhe verilindjes, më anën e djathtë të Vjosës, dhe pjesën labe në të mëngjertën e këtij lumi, sipas ndarjes fisore që pamë më sipër. Që të dy grupet e melodivet kanë këtë të përbashkët, që forma e tyre sjell me vete ndërrimin e këngëtorit të parë me korin. Për këngën e këngëtorit të parë në këngën toske themi se *ia*

bedb, në këngën labe *ia merr*; për këngëtorin e dytë, që fillon pas të parit, në këngën toske themi: *ia pret*, në labërishtet *ia kthen*. Për korin në këngën toske themi se *bën iso*, (gr. ἴσος) në Labëri *ia mbush*. — Në pika të tjera të dy meloditë popullore ndryshojnë mjaft nga njëra-tjetra. Melodinë toske të vërtetë më vjen ta përshkruaj më mirë me dy atributet *elegjike* dhe *ekspansive*: tingull themelor elegjik i këngëvet, qofshin të natyrës lirike ose epike; atmosferë expansive që përhapet prej tyre. Edhe teksti i këngëve po këtë rrugë ndjek: lirezëm i butë, vjersha dashurie thellësisht të ndjera, këngë epike të përshkuara prej brendie lirike. Në atmosferën expansive kontribuon edhe versi, i cili, i gjatë në vetvetë, ndehet në të kënduar edhe më shumë në gjatësi. Masa e rregullt e vartur në këto këngë është trokeu gjashtëkëmbësh

˘ ˘ | ˘ ˘ | ˘ ˘ || ˘ ˘ | ˘ ˘ | ˘ ˘ |

me një cezurë pas së tretës këmbë, si në të kënduar me zë si në të recituar. Këngët e mbledhura prej Auguste Dozon¹²² janë për një pjesë të këtij lloji, p.sh.:

*Ndëpër errëcirë të dëgjova zënë,
Mos më je bilbil a mos më je thëllënxë?*

Kemi në këto këngë ndryshime në melodi e në ritëm. Ndryshime në melodi na jepen nga fakti se në gjithë meloditë shqiptare ekziston një liri e madhe brenda një shkalle tingujsh (*Tonskala*), kështu që ndryshime të vogla në lartësi të tingujve janë muzikalisht irrelevante. Më rëndësi kanë ndryshimet ritmike, që duken ahëre kur këngët kërcëhen me valle. Kemi edhe ndryshime vendore: Përmet, Leskovik, Kolonjë, Korçë, Devoll, Mokër, Opar, Skrapar, Shpat, Myzeqe, Berat, Mallakastër. Por që të gjitha na paraqiten si variacione të një teme themelore, të një tipi melodik. — Është interesant që këngët e çamëvet të fundit jugor të Shqipërisë u përngajnë këngëve të toskëvet që përmendëm këtu më sipër. Edhe masa e versit është po ajo, është ai «metri i këndshëm» për të cilin flet Holger Pedersen, të cilit iu paraqitën si masa çame, p.sh.¹²³:

*Se ç't'arç nga porta
dola nga divani.*

Kësaj konkordance duket t'i kundërshtojë fakti që toskë e çamë sot nuk banojnë më në një afërsi kontakti me njëri-tjetrin. Po ky kundërshtim zhduket historikisht, sepse në një periudë të caktuar të historisë shqiptare fiset labe duket të jenë futur si pykë në midis dhe të kenë ndarë kështu një njësi të hershme më dysh. Shohim kështu se si këngët popullore janë në gjendje të lëshojnë dritë edhe në historinë e fiseve tona.

Edhe te meloditë labe kemi ndryshime regjionale, të cilat këtu si dhe te meloditë e përmendura toske janë më shumë të një natyre ritmike sesa thjesht melodike. Katundet e Vlorës bashkohen me Himarë në këtë, që këndojnë më shumë si me të shtyra, me hove, në mënyrë dallgësh. Dukati me meloditë e tij thellë-kumbuese, Kurveleshi, Delvina, Gjirokastra, Lunxhëria e të tjera janë po aq qendra ngjyrash lokale të këngëve labe. Por këto nuk janë veçse trajta të ndryshme të një njësie melodike. Ndryshime ritmi rrjedhin edhe, siç pamë, nga ndërrimi i brezave, meqë të rinjtë fillojnë tani të këndojnë me një tempo më të shpejtë nga ç'këndonin pleqtë. Pastaj tempoja e një kënge që njëkohësisht këndohet *edhe* kërcëhet, bëhet, siç pamë, prapë më e shpejtë, dyfish më e shpejtë, prandaj edhe koha e përdorur është përgjysmë më e shkurtër nga koha që përdoret me këngën vetëm të kënduar të një vargu. Këto sende disi të ndërlikuara si dhe zgjatimi i përmendur i vargut të kënduar me anë partiklash dhe me anën e zgjatimit të zvargur të rrokjeve formojnë elemente kryesore, mjerisht tepër pak të studiuar, të një poezie popullore. Veçanërisht hetimi i ritmit të valles në viset e Ballkanit më duket të jetë me rëndësi për poezinë popullore.

Përshtypja që del prej këngës labe është mall i ashpër dhe shpirt heroik. Atmosfera që krijohet me të nuk më duket të jetë ekspansive si te kënga toske, po epike. Se epike është fryma e këtij fisi, këngët më të dashura të tyre janë këngë trimash, të cilat mund të lindin me shpejtësi të çuditshme, vallja ndër ta është vallja luftarake, kënga e dashurisë, siç thamë, është këtu vrazhdësisht realiste. Them se thelbin e kësaj kënge e goditim më mirë duke e quajtur këngë barinjsh. Po kundrejt këngës baritore rumune kjo është këngë barinjsh luftarë. Edhe muzikalisht lidhet, besoj, me jetën baritore. Përshtypja akustike që krijon kënga labe mund të krahasohet me tingullin e kumborëve të bagëtive. Sikurse këtu tingulli i rëndë e i thellë i kumborëve të deshve — zgjedhja e të cilave në të kumbuar ka prandaj rëndësi për barinë — dallohet prej

kumbimit të përgjithshëm të zileve të shumta e të zakonshme të dhenve, kështu shquan te kënga labe zëri i lartë i atij që ia merr dhe zëri më i thellë, i dredhur si kumbora, i atij që ia kthen këngës, nga kori i këngëtorëve të tjerë që vete e rrjedh i plotë e monoton e i gjerë. Nuk besoj të gabojmë po të themi se ky popull barinjsh e ka krijuar këngën e vet duke u mbështetur, pa e ditur, në zërin e dashur e të zakonshëm të kumborëve. Këtë duket ta vërtetojë edhe gjuha, meqë për një këngë që u këndua mirë thuhet se «vate si kumborë».

Masa e zakonshme e versit të këngës labe është vargu trokaik katërkëmbësh, tetë rrokjesh. Ky varg që përfshin këngën shqiptare, aromune e bullgare, si dhe këngën greke, dhe që ka qenë shumë i përhapur edhe në literaturën bizantine, është pas Dieterich-ut i origjinës bizantine. E ndeshim edhe në këngën popullore shqiptare të Veriut.

Kufijtë midis melodive labe dhe melodive toske e çame treten gradualisht njëri me tjetrin. Në pikat kufizore mund të vërehet mirë se si përzihen meloditë e ndryshme dhe kalojnë pak nga pak njëra në tjetrën. Gjithë kjo ngjet edhe me masat e versit, me versin toskë gjashtëkëmbësh dhe me versin katërkëmbësh lab, të cilat përdoren rastësisht më këtë anë dhe më atë anë.

Nuk di nëse meloditë veriore shqiptare kanë qenë aq të gjalla sa të kenë ndikuar meloditë e popujve fqinj; nga disa shenja më duket se po. Një gjë të tillë mund ta themi me plot gojën për Shqipërinë e Jugut. Disa fise të aromunëve këndojnë gati ashtu si dhe shqiptarët toskë në kuptimin e ngushtë të fjalës, dhe grekët e Epirit këndojnë me melodi labe disi të ndryshuara. Pjesa dhënëse janë këtu shqiptarët, sepse aromunët e grekët e tjerë, që nuk rrojnë pranë shqiptarëve, nuk i njohin këto melodi. Pra poezia popullore shqiptare është bërë produktive në dy anë. Ky fakt jo i parëndësishëm për muzikën popullore të viseve ballkanike spjegohet jo vetëm nga bashkëjetesa fqinje e të tre popujvet, por edhe nga karakteri i tyre dhe nga gjendja sociale e jetës së tyre: Ndër këta tre popuj ata që janë më fort të ngjitur te zakonet e veta janë pa dyshim shqiptarët. Kështu bujqit grekë dhe barinjët aromunë, nga një nevojë e natyrshme e mbështetjes, kanë dashur t'i barazoheshin shtresës së zotërinjve shqiptarë në të gjitha shprehjet e jetës. S'është më kot që, siç pamë më sipër, ligjet shqiptare të pritjes së mikut kanë ndikuar zakonet e pritjes ndër aromunë dhe ndër grekë të Veriut. Paralel me këtë ecën ndikimi në meloditë popullore, të cilat lozin rolin

e tyre rëndësiplot nëpër gosti dhe në çdo kremtim. Grekët kanë marrë prej shqiptarëve edhe vallet e tyre ἀρβανίτικο (shqiptarçe), τσόμικο (çamçe) e χειμαλιότικο (himariotçe)¹²⁴. Duket pra se vallet shqiptare me origjinalitetin e tyre, ndofta dhe si valle në themel luftarake, iu paskan imponuar grekëve, kurse përkundrazi rumunë e bullgarë vallet e veta i quajtën nën influencën greke *hora*. — Përveç kësaj, krushqit në Greqi Veriore e kanë për zakon që kur venë të marrin nusen këndojnë para shtëpisë duke përzier fjalën shqipe *prina!* (= pritna!). Edhe refrene të tjera shqiptare si *more birbiló, more qaj me lo(t)* etj. kanë hyrë ndër ta.

Një vëmendje të veçantë meritojnë këngët e kolonistëve shqiptarë në Greqi e në Itali. Janë të dyja poezi popullore e fundit të Mesjetës, e kohës pas «Manifestacionit shqiptar». Këto përmbajnë elemente shqiptare të moçme, elemente bizantine-paraturke si dhe elemente paraturke. Mirëpo poezia e shqiptarëve të Greqisë ka mbetur përhera nën ndikimin turk, ka përkrahur fazat e zhvillimit të Ballkanit turk, dhe kështu karakteri i hershëm i saj në pjesën më të madhe të tij është shuar e fshirë. Më e lashtë ka mbetur kënga e shqiptarëve të Italisë, e shkëputur siç mbeti përgjithmonë nga influenza turke. Kjo këndohet, siç u pa, në melodi të vjetra e të trashëguara bizantine. Metrika karakterizohet me verse të shkurtra pa rimë, ritmi i të cilave rrjedh nga një periudë e caktuar e metrikës popullore shqiptare. Këngët e moçme epike-dramatike quhen ndër ta *vale*, një fjalë që ka një kuptim krejt tjetër nga kënga e vallja që jeton ndër ne në Shqipërinë e Veriut e të Jugut. Se kjo këngë valleje e italo-shqiptarëve, që ndërpritet shpesh prej refrenesh e që ka formë dramatike e kallëzuese, karakter epik me shtesa të brendshme lirike, më duket se i afrohet në thelb baladës perëndimore-romane, siç e njohim në fillim prej Provence-s. Nga kjo ne shohim pra se si lidhjet intensive të Shqipërisë mesjetare me Perëndim kanë lënë gjurmë edhe në poezi popullore, të cilat mund të shërbejnë si provë për ato lidhje.

Ç'përkrahjam më lart si njësi shqiptare na shfaqet edhe në poezinë popullore. Ajo na shprehet në gjithë vargjet e fëmijëve, në gjëza, proverbe, përralla e gojëdhëna; sëfundi edhe në këngën popullore: këngë djepi, këngë dasme, ligje, këngë trimash, këngë dashurie, në këngë vallesh dhe në vargje satirike, të cilat këtu i kaluam pa i përmendur. Edhe ritmi e metrika na flasin për këtë njësi: kështu, bie fjala, trokeu katërkëmbësh i këngës labe të Jugut, na del, siç thamë, edhe në Veri.

Lavdërimi i heroizmit dhe i nderit personal, lartësimi i lidhjeve të familjes dhe i lirisë individuale janë trajta të përbashkëta të gjithë këngëve epike të shqiptarëve dhe një pasqyrë e qëndrimit të tyre ndaj jetës. Përsa i përket formës, parasundon, në përshtatje me karakterin e popullit, shkurtësia dramatike e këngëve, të cilat zakonisht janë mbushur më shumë me veprim sesa me përshkrime ose me shprehje ndjenjash. Edhe fillimi aq i preferuar i këngës me një datë më duket të jetë specifikisht shqiptar, sepse rrjedh prej karakterit dramatik të kësaj kënge. Por fillimin e shpeshtë të këngëve me një hyrje të marrë nga natyra, me të cilën ngjarja poetike vihet në lidhje me ndonjë ngjarje të natyrës, këngët shqiptare e kanë të përbashkët me poezinë popullore të popujve të tjerë të Ballkanit; p.sh.:

*Lulzoi pjeshka, lulzoi thâna:
Ndrec Bardhokun ku e ka nâna?*¹²⁵

Edhe në brendi të këngëvevet kjo njësi është mjaft e shquar. Në pikëpamje të kohës është mjaft e vjetër, sepse fijet e lidhjeve shkojnë jo vetëm brenda Shqipërisë: ato shtrihen edhe mbi kolonitë që janë shkëputur me kohë nga trugu i kësaj njësie.

Literatura

Në këto rreshta duam të trajtojmë tashti një skicë historike të literaturës shqipe. Nuk është qëllimi ynë, dhe as që do të qe e mundur brenda caqeve të një artikulli, të referojmë mbi gjithë autorët, mbi jetën e mbi veprat e tyre.¹²⁶ Qëllimi i këtyre rreshtave është që të duken vijat e mëdha, të dëftohet rruga e zhvillimit mendor të Kombit nga vija që ka ndjekur literatura, gjithmonë duke pasur parasysh gjendjen historike e sociale të vendit. Ka rëndësi për ne që nëpërmjet autorëve të mund të kuptojmë shpirtin e kohës, por pa harruar këshillën e Goethe-s:

«Ç'quani ju shpirtin e kohës, kjo në fund është shpirti i zotërinjve vetë». Duke dalë prej këtij qëllimi do të heqim dorë a priori nga një plotësi lëndore e, duke lënë mënjanë pikat e dorës së dytë, do të theksojmë më tepër ato më rëndësiploetet. Do të këqyrim më shumë të nxjerrim në dritë, në pikat më kryesore, personat e dukjet që janë themelore për vijën e zhvillimit të literaturës.

Kemi, pas mendimit tim, një aksiomatikë të dyfishtë brenda literaturave të popujve ballkanikë:

Aksiomi i parë është një influencë e madhe e poezisë popullore mbi shkrimtarí. Kjo, siç konstatoam më lart, spjegohet me lidhjen e ngushtë që ka poezia popullore me jetën shpirtërore të këtyre popujve. Poezia popullore është ndër këta e gjallë e produktive, prandaj komponentja e këngës popullore është kudo e dukshme. Këngë djepi, përralla, gojëdhëna, gjëza, vargje fëmijësh me meloditë e tyre çuditërisht monotone janë i pari e i vetmi ushqim poetik i vjetëve fëmijorë të këtyre njerëzve. Nga kjo rrjedh fakti që më të shumtët poetë e shkrimtarë të popujve të Ballkanit e kanë ndër më shumë a më pak ndikimin e poezisë popullore. Ky ndikim shprehet në lëndë, në formën e përbrendshme, në ritëm, metrikë si dhe në veçantira. Nuk ekziston këtu një poezi me të vërtetë krijuese e cila të mos bazohet shpirtërisht te populli. Jo se s'ka poetë që të kenë ecur në rravat e artit të huaj, dhe, pa pasur asnjë lidhje organike, të kenë mbetur formë e zbrazët. Por përgjithësisht këtu poetët kanë dalë prej tokës së natyrshme të poezisë popullore.

Nga ky ndërlikim organik i poezisë popullore me poezinë e artit spjegohet jo vetëm roli dhënës, por dhe roli marrës i poezisë popullore. Duke ditur poeti të goditë tingullin popullor dhe të zhytet njëkohësisht në anonimitetin e përgjithësisë, këngët artistike janë bërë shpeshherë këngë thjesht popullore. Nga pikëpamja e poetikës është shpesh e pamundur të heqësh këtu caqe të mprehta ndërmjet të dy llojeve të poezisë.

Shkaku i këtij ndikimi të thellë të poezisë popullore mbi shkrimtarí qëndron sigurisht për një pjesë në gjendjen shoqërore, në nivelin kulturor të viseve të Ballkanit me jetën e tyre në katund ose në qytete që i ngjajnë katundit. Brenda në to rrojnë popuj, shtresat e ulëta të të cilëve nuk ishin prekur gjer dje prej kulturës së shkollës, kështu që ndodhen edhe fort afër poezisë së thjeshtë popullore. Në këtë sferë jete personaliteti njerëzor si dhe artistik i poetëve nuk ka mundur të zhdiri-

vilohet aq plotësisht si p.sh. në Perëndim. Kështu distanca midis poetit e popullit, midis literaturës e poezisë popullore nuk ka qenë kurrë e madhe në Ballkan. Poeti s'mund të shqitet nga rrethanat sociale, shkrimtaria nuk mund të çlirohet prej fuqisë së poezisë së popullit. Mirëpo arsyeja për këtë gjendje më vete nuk duhet kërkuar vetëm në shkallën e kulturës, por edhe në qenësinë e posaçme e në dispozicionin shpirtëror të popujve, në një afërsi selektive të natyrshme. Ka literatura te të cilat — pavarësisht nga shkalla kulturore e popullit përkatës — vija e zhvillimit u pat larguar që heret prej rrymës popullore, dhe literatura të cilat kanë marrë gjithmonë nga gurra e poezisë së popullit. Te grupi i parë dua të njeh literaturat e popujve sllavë dhe gjermanikë, veçanërisht gjermanikë të Veriut, si dhe disa perioda të caktuara të shkrimtarisë gjermane. Në këtë përpjesëtim të literaturave europiane, *përpjesëtim që e shohim edhe në muzikë*, literaturat e popujve ballkanikë hyjnë pa dyshim në grupin e literaturave që janë ndikuar thellësisht prej poezisë së popullit.

Aksiomi i dytë ka qenë gjer sot ngjyra politike e shkrimtarisë, me qenë se fatet e posaçme social-politike kanë ushtruar një ndikim të shënuar në të lindurit e literaturave. Meqë këtu largësia e poetit nga populli ka qenë përhera e vogël, është i rrallë tipi i poetit të izoluar e të zhytur në botën ideale të artit të thjeshtë. Shkrimtari zakonisht ka marrë gjithmonë pjesë aktive e me tërë fuqitë e veta në jetën e popullit dhe në përpjekjet e tij. Poetit si një prijësi shpirtëror i ka rënë këtu zakonisht edhe barra e apostullit nacional, atij këtu i është dashur shpeshherë të ndërrojë pendën me pushkë; ka edhe poetë që kanë ditur t'i përdorin mirë që të dyja armët. Po të mendojmë luftrat e shumta që këta popuj kanë bërë, për hir të lirisë nacionale, si kundër të huajve si dhe kundër njëri-tjetrit, ahëre kuptohet lehtë natyra politike e literaturës, shërbimi i saj për propagandën kombëtare. Nacion dhe politikë kanë qenë këtu gjer tani temë kryesore e krijimit letrar. Ky nuk është një ndryshim cilësor, por ndryshim kulturhistorik e tipologjik, ndryshimi themelor i tyre ndaj literaturave të Perëndimit. Por ndofta me kohë do të ndryshojë faqja kulturpolitike e popujve ballkanikë; literaturat e tyre mund të marrin njëherë rrugë të reja, duke pasur për qëllim më shumë krijimin e një arti të thjeshtë e të vërtetë.

Një ndarje e literaturës shqiptare pas pikëpamjesh sistematike ose kronologjike-historike do të ishte e metë e me të plasura, nuk do ta

nxirrte në dritë thelbin e vërtetë të zhvillimit të saj sepse sikurse gjendja historike e kulturore, sociale e politike, ashtu edhe *karakteri i popullit* me cilësitë e trashëguara ka pasur ndikim mbi llojin e prodhimit letrar të poetëve. Është sidomos *fisi*, produkti etnik i gjendjes e i ndarjes së imtë gjeografike, ai që ka dhënë bazën e përhershme për mbujtjen e personalitetit të shkrimtarëve. Prandaj studimi letrar duhet të fillojë te kontributi i fisit, sepse ky përbën një komponente me rëndësi të literaturës shqipe. Lidhja etnike dhe etike me fis, ndjenja e bashkëjetesës brenda një atdheu më të ngushtë na japin në literaturë edhe rrymën e regjionalizmit, i cili është një dukje e shpeshtë në literaturën e shqiptarëve si dhe të gjithë popujvet të Ballkanit. Në formimin e tij kontribuojnë elemente fisore dhe tradita e brendshme si dhe rryma centripetale të huaja. Këto kanë hyrë si nga toka si nga deti dhe duken në Shqipëri më intensive nga shkaku i vogëlsisë së vendit. — Nuk është pa rëndësi dhe komponentja e konfesionit se edhe kjo, duke u përzier me këta faktorë të tjerë, cakton së thelli rravën e formimit të shkrimtarisë.

Duke u nisur nga këto mendime më është mbushur mendja që prej vjetësh që një ndarje e drejtë e literaturës shqipe nuk duhet të dalë prej periodash historike, po prej *qarqesh kulturore dhe letrare*. Me këto unë kuptoj njësi të cilat janë lindur e rritur organikisht prej truallit të fisit, prej traditës kulturore të trashëguar e të asimiluar si dhe prej faktorit konfeshional. Cilësi kryesore e çdonjërit nga këto qarqe është ndjenja me plot ndërgjegje e njësisë dhe një traditë letrare kurdoherë e gjallë, e cila gjithë përfaqësuesit e tyre i lidh në një vargua të natyrshëm. Dukje sporadike janë përjashtuar prej tyre. Secili prej shkrimtarëve të këtyre qarqeve është në një farë mënyre trashëgimtari shpirtëror i parashkuesit, por të gjithë janë ruajtës e vazhdues të një drejtimi letrar të ideve.

Brenda literaturës shqipe unë shoh të jenë formuar katër qarqe kulturore e letrare. Janë këto: *Qarku katolik i Shqipërisë Veriore, Qarku italo-shqiptar, Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore*, dhe së fundi *Literatura kombëtare e shekullit XIX*.

Të tri të parat janë qarqe të veçuara kombëtare, pasqyra letrare ku ne shohim *fuqitë dalluese* të historisë shqiptare. Këto qarqe veprojnë krejt pavarësisht njëri nga tjetri, dhe sado pothuaj të një kohe, veprojnë çuditërisht pa njohur fare shoqi-shoqin. — Këto janë dhe qarqe *parakombëtare*, meqë mënfund derdhen të gjitha në lumin e literaturës nacionale të shekullit XIX. Secili prej tyre kontribuon me elementin e

vet në këtë lumë të përbashkët. Edhe në qarkun e përbashkët të literaturës nacionale bashkëveprojnë fuqitë e moçme regjionale të qarqeve të para; edhe poetët nacionalë nuk mund t'i mohojnë, përveç trajtave të përbashkëta shqiptare, trajtat e trashëguara të fisit.

Kështu ne shohim pra që pyetja jonë për një njësi shqiptare, në literaturën shqiptare na paraqitet e projektuar në kohë: Mësëpari na dalin në dukje trajtat e ndryshme, pastaj këto konvergojnë në njësinë letrare. Komponentja fisore-regjionale dhe komponentje fetare me gjithë jetën kulturore e sociale përkatëse na japin sëfundi rezultatën nacionale. Por trajtat e përbashkëta që na shfaqen te kjo nuk janë lindur nga asgjëja: Është shtresa e lashtë shqiptare, e mbetur kaq kohë latente, ajo që shpërthen mënfund në një jetë të re. Njësia letrare ka qenë e gjallë që në fillim, ajo rronte në personalitetin dhe në temperamentin e shkrimtarëve. Prej gjithë shkrimtarëve shqiptarë na del përpara fytyra e shqiptarit të përjetshëm.

Këtë rrugë zhvillimi të literaturës shqipe do ta trajtojmë në një pjesë të dytë.

SHËNIME

1. Khs. për sa shkruhet më sipër **Herbert Louis**, *Albanien* (1928) passim, si edhe hartën në fund të atij libri. — **Ami Boué**, *La Turquie d'Europe*, bot. gjerm. i vitit 1889, I, f. 39 thotë: «Shqipëria ndahet prej turqve me një shumicë sharapollesh të natyrshme dhe prej serbëve me kreshta të larta, kalimet e të cilave ndodhen nga ana shqiptare». Edhe **Patsch**, *Gjendja ekonomike e kulturore e Shqipërisë*, f. 13, thotë se Shqipëria është gjeografikisht e veçuar së jashtmi. Sh. edhe **J. Georg von Hahn**, *Albanesische Studien*, I, f. 214.
2. **Milan v. Šufflay**, *Serbët dhe shqiptarët*, përkthyer prej sllavishtes nga Zef Fekeçi e Karl Gurakuqi (1926), f. 36 v.
3. 3, 23; sh. **Hans Krahe**, *Die alten Balkanillyrischen geographischen Namen*, f.12.
4. **Pauly-Wissowa-Kroll**, *Realenc.*, I, f. 1037; **Krahe**, *op. cit.*, f. 15.
5. Khs. **Šufflay**, *op. cit.*, f. 35.
6. **G. Weigand**, *Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien*, «17.-18. Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache zu Leipzig», f. 179 v.
7. *Rituale Romanum*; sh. **Mario Roques**, *Recherches sur les anciens textes albanais*, f. 26.
8. Në parathënie të *Dictionarium latino-epiroticum*.
9. Sh. **Jokl**, «Indogermanisches Jahrbuch», XXI, VII, f. 87.
10. Parathënie e *Cuneus prophetarum*.

11. *op. cit.*, I, f. 15 v.
12. **Martin Urban**, *Die Siedlungen Südalbaniens*, (1938), f.135 e 136 dhe hartë.
13. sh. **Jokl**, «IJ», XXI, VII, f. 99.
14. Ndryshimi *r-l* edhe te emri dalmat i personit *Arbisona, Albisona*, Ragusan de populo, **Jirecek**, *Die Romanen in den Städten Dalmatiens hauptsächlich während des Mittelalters*, III, f. 4.
15. **Kuhns** «Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung», XXXV, f. 551.
16. *op. cit.*, f. 35.
17. **Krahe**, *op. cit.*, f. 12.
18. Φουρίκης, Πόθεν τὸ ἔθνικὸν Ἀρβανίτης, Ἀθηνᾶ, 43 (1931), f. 3-37, cit. pas **Jokl**, «IJ», XVII, VII, f. 187.
19. **P. Papahagi**, *Numiri etnice la Aromâni*. Acad. Rom. Memor., sect. ist. Ser. III. t. 3 (1925), f. 131-167; — **Jokl**, «IJ», XII, VII, f. 119.
20. Sh. **E. Eftimiu** në «Graiul românesc», 6 (1932), f. 115-117.
21. *op. cit.*, f. 84 v.
22. **Skok**, *Si i shkruajnë shkrimtarët bizantinë emrat sllave të personave e të vendeve?*, cit. pas **Jokl**, «IJ», XIII, VII, f. 170.
23. Sh. dhe më poshtë.
24. **G. Pekmezi**, *Grammatik der albanesischen Sprache*, f. 92.
25. *loc. cit.*
26. Procop. Aed. 4, 4 te **Krahe**, f. 80.
27. «Hylli i Dritës», VII (1931), Nr. 11, f. 639.

28. **Helmholts** *Weltgeschichte*, VIII, f. 435. Sh. **Jokl**, «IJ», XX, VII, f. 108.
29. *L'unité de la civilisation balcanique*, «La Géographie», 48 (1927), f. 190; — **Jokl**, «IJ», XIV, VII, f. 5.
30. *Saggio di antica onomastica Mediterranea*, «Archiv» 3 (1926), f. 17; **Jokl**, «IJ», XII, VII, f. 148.
31. «Hylli i Dritës», X (1934), f. 589-595; sh. **Jokl**, «IJ», XX, VII, f. 108.
32. **Pekmezi**, *op. cit.*, f. 223.
33. **Pekmezi**, *loc. cit.*
34. *Mrizi i Zanavet*³, f. 115 (Gjaksorvet).
35. *Gjeth e Lule*², f. 28 (Hot e Grudë).
36. *Die Balkanvölker*, (1917), f. 330.
37. Në Gjirokastër *shqipëlloj* «spjegoj, bëj të qartë».
38. «Indogermanische Forschungen», 35 (1914), f. 135-137.
- 39 **Man**, 23 (1923), f. 55-61, cit. pas **Jokl**, «IJ», X, VII, f. 14.
40. **M. Lambertz**, *Die Volks poesie der Albaner*, f. 29.
41. **Kretschmer**, *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache*, f. 221.
42. Πόθεν τὸ ἔθνικὸν Σκιπετάρ. Πρακτ. Ἀκαδ. Ἀθην., 4 (1929), f. 102-108; **Jokl**, «IJ», XV, VII, f. 125.
43. **Hahn**, *op. cit.*, I, f. 116.
44. **Šufflay**, *loc. cit.*
45. Kurveleshi i Sipërm p.sh. e ka zakon ta pjekë mishin në hell, Kurveleshi i Poshtëm ta ziejë jahni.

46. **G. Meyer**, *Nuova Antologia* (1885), f. 588; **Jokl**, *Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft*, 2. Teil, 3. Bd., f. 125.

47. *op. cit.*, f. 83 v., f. 95.

48. Ndofta emri i sotëm i katundit *Plesàt* në Kurvelesh lidhet me fisin *Plesej* të përmendur më sipër.

49. *Topographie und Stammesorganisation in Nordalbanien*. «Festschrift für Karl Uhlig», 1932.

50. Σάρρης, Τὰ τοπωνύμια τῆς Ἀττικῆς, Αθηνᾶ 40, 155.

51. Kufijtë e fiseve shqiptare shënohen më shumë me vija uji.

52. Janë trajtuar me sufiksin sllav *-ovë*. Këtë në shqipet nuk e shoh të jetë më produktiv, por është në dialektin e grekofonëve të Dropullit në jug të Gjirokastrës si sufiks femëror i mocionit: *Léova* «e shoqja e Leos», *Náshova* «e shoqja e Nashos» etj. Shumë elemente sllave në gjuhën dhe një kompleksion i bardhë në pamjen somatike të kësaj popullsie sot greke na bëjnë të pranojmë gjurmë intensive sllave. Pasi këto rreshta ishin shkruar, shoh se një mendim të afërm shpreh dhe **Urban** 166 v.: «Një studim i imtë antropogjeografik i këtyre viseve do të vërtetojë se gjer ku kemi të bëjmë në këta grekë me sllavë të greqizuar dhe a mos duhet që disa dukje të veçanta në lëmë të banesave të konsiderohen të origjinës sllave».

53. **Urban**, *op. cit.*, f. 103 vv.

54. Sh. më lart.

55. **Urban**, *op. cit.*, f. 79 v.

56. **Hahn**, *op. cit.*, I, f. 161.

57. **D. Sergejevski**, *Glasn. Zem. Muz. u Bosni i Herc.*, 41/2 (1929), f. 95-101, prej një këqyrje të tre relievesh nga Livno dhe Glamoc ka gjetur se Diana ka trajta autoktone, kështu që mund të jetë një perëndeshë vegjetacioni (cit. pas **Jokl**, «IJ», XV, VII, f. 116). — Për etimologjinë e fjalës *zàna* sh. **Jokl**, *Studien zur albanischen Etymologie und Wortbildung*, f. 98 : *zà* ose lat *Diana* me mbë-

shtetje etimologjike popullore me fjalën *zâ*.

58. *Vijte* për *vij* e përdor Bregu i detit prej katundesh të Vlorës gjer në Çamëri: çam. *kamte* «kam», trajtë të cilën H. Pedersen, *Albanesische Texte mit Glossar* 4, e gjen në këngë çame dhe e mban kështu për një *licentia poetica*. Mirëpo përdoret dhe në të folur të përditshëm, është pra një fenomen i bisilabizmit (Wackernagel), i zgjatimit të fjalëve njerrokëshe me një të dytë si p.sh. *u-unë*, *ti-tinë*, *ajo-ajonë* etj.

59. *loc. cit.*

60. Hahn, *op. cit.*, f. 73, 169; Franz Baron Nopcsa, *Albanien. Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens*, f. 51 vv. (Shqipëri e Veriut); Urban, *passim* (Shqipëri e Jugut).

61. Tacitus, *Germania* 16.

62. Sh. më lart.

63. Josef Weninger, *Rassenkundliche Untersuchungen an Albanern. Ein Beitrag zum Problem der dinarischen Rasse*, Wien 1934.

64. *op. cit.*, I, f. 380.

65. *Moeurs et coutumes des tribus Albanaises*, «Le Globe».

66. Si familja ashtu edhe heroizmi dhe një dëshirë e flaktë për liri janë shtysa të forta në karakterin dhe në qëndrimin shpirtëror të shqiptarëve si dhe të stërgjyshërve të tyre ilirë.

67. Kështu edhe Hahn, *op. cit.*, I, f. 214.

68. A. Meillet, *La langue albanaise*, «Revue hebdomadaire», 7 gusht 1905, f. 6-7.

69. Dhe prej kësaj edhe kënga popullore greke aromune.

70. Jirecek, *Illyrisch-albanische Forschungen*, I; S. R. Steinmetz, «Z. Ges. f. Erdk. Berl. Erghft». 2, 1927; Jokl, «IJ», XIII, VII, f. 68.

71. «Byzantinische Zeitschrift», 8, 557.
72. *Die Volksdichtung der Balkanländer in ihren gemeinsamen Elementen*, «Zeitschrift des Vereins für Volkskunde», XII (1902), f. 145-55, 272-91, 403-15. Sh. edhe **K. Sandfeld**, *Linguistique balkanique, problèmes et résultats*, f. 5 v.
73. *Neugriechische und albanesische Märchen*.
74. *Balkanmärchen*.
75. *Neugriechische Märchen*.
76. *Das Märchen*³, (1925), f. 151.
77. Në Veri: **Nopcsa**, *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Herzegovina*, XII, f. 265 v. — Edhe në Kurvelesh e në rrethet e Korçës.
78. **Hackmann**, *Die Polyphemsage in der Volksüberlieferung*, Helsingfors 1904.
79. «Hylli i Dritës», prill 1939.
80. *loc. cit.* X v.
81. *Albanesische Texte mit Glossar*, f. 35 vv.
82. *Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde*, f. 44.
83. *Odissé*, X, f. 135 vv; **Pauly-Wissowa-Kroll**, *op. cit.*, 17, 2, 1966.
- 84 **F. von der Leyen**, *op. cit.*, f. 105.
85. **Giuseppe Schirò**, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, f. 411 vv.
86. **Pauly-Wissowa-Kroll**, *loc. cit.*
87. **Auguste Dozon**, *Manuel de la langue chkiye ou albanaise*, IX: *La fille promise au soleil* (tosk); **Schirò**, *op. cit.*, f. 357 vv.: *E bija e Diellit* (italoshq.); **Hahn**, *loc. cit.* Nr. 2: *Aschenputtel* (E Përhitura) (Kukudhi, Zagori afër

Janinës).

88. M. Murko, *La poésie populaire épique en Yougoslavie au début du XX^e siècle*, f. 14.

89. *Essais und Studien*, I, f. 79 v.; Dieterich, *op. cit.*, f. 146.

90. Përmbi trajtat e jetës paraturke në epikën popullore të kolonive shqiptare të Italisë sh. Ernest Koliqi, *Epica popolare albanese*, 1937, f. 44.

91. Jirecek, *Illyrische-albanische Forschungen*, I, f. 85.

92. Murko, *op. cit.*, f. 14.

93. «Indogermanische Forschungen», IV, f. 412-48.

94. *Albanische Märchen*, f. 68 v.

95. *op. cit.*, f. 152.

96. *Canti popolari greci*, Lanciano 1920, f. 103.

97. Sh. dhe Koliqi, *op. cit.*, f. 48 vv.

98. *Rapsodia* te Filip Fishta, «Anthologi Shqipe», f. 92 v.

99. Mbi κοπνικόν sh. Jokl, «Slavia», XIII 2-3, 316 v.

100. «Rev. Int. d. Et. Balc.», Ière année, Tome II (1935), f. 229 (567).

101. Përmbi çiftin armen Bagrat Chalatzianz, «Zeitschrift des Vereins für Volkskunde», XII (1902), f. 143.

102. «Rev. Int. d. Et. Balk.», *ibid.*

103. *Kënga* te «Visaret e Kombit», I, prej K. Gurakuqit e F. Fishtës, f. 19.

104. Një zhvillim të kundërt shohim në Labëri, ku të tri pjesët na paraqiten të shkruara në dy pjesë: M. Gjon Ligu: M. Gjonligu. — Në Labëri këto emra tri

pjesësh rrjedhin prej një kohe kur këto fise ishin ende të krishtera.

105. **Murko**, *op. cit.*, f. 10.

106. **Koliqi**, *op. cit.*, f. 49, fjalën *kreshnik*, në lidhje edhe me gjurmët perëndimore (kryqëzata) në këto këngë epike, mendon ta nxjerrë prej sllav. *kerst* «kryq» + sufiks sllav *-nik*. Sufiksi është parë pa dyshim mirë, fjala rrënjë pas mendimit tim është *kreshtë*, **Maehne, Borste, Buerste, G. Meyer**, *Etym. Wb. d. alb. Spr.*, 205. tosk. *kreshë* id. **Kristoforidhi**. *Fj. 117*. sh. dhe **Jokl**, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, 166 vv. Kuptimi themelor i fjalës është «me flokë të gjata, me jelë, me perçë», pastaj «fisnik, trim bujar, kreshnik». Këtu kemi të bëjmë me zakonin e trashëguar nga kohët e moçme indogjermane që burri i lirë, bujari mbante flokë të gjata ose një perçë. Në Jug të Shqipërisë mbanin flokë të gjata gjer tani afër komitët. «Edhe fjala *çupë* “flokë të gjata” hyn në këtë grup, sepse flokët e gjata ishin shenja e burrave të lirë edhe ndër gjermanët e moçëm». **Nopcsa**, *Festschrift für K. Uhlig* f. B.

107. Edhe poeti italo-shqiptar **Gabriele Dara** në parathënien e veprës së tij *Kënka e sprasme e Balës* i quan këngët popullore të moçme italo-shqiptare *I Canti della vecchiaia*. — Përmbi këngët e moçme sh. **B. Palaj** e **D. Kurti** në «Visaret e Kombit», II, IX.

108. Sh. **Dieterich**, *op. cit.*, f. 288.

109. **Dieterich**, *loc. cit.*

110. *loc. cit.*

111. **Dieterich**, *op. cit.*, f. 285 v.

112. «Për vetulla përdoret simbolikisht *avgella* dhe për qepalla *krabët e dallëndyshe*». **Ami Boué**, *op. cit.*, I, f. 397.

113. edhe me *filxhan*.

114. edhe me *qersh*.

115. edhe me *mollë, portokalle e ftonj*.

116. **Dieterich**, *loc. cit.*
117. **Chalatianz**, *op. cit.*, f. 268.
118. **Maximilian Lambertz**, *Die Volkspoesie der Albaner*, f. 6.
119. **Dieterich**, *op. cit.*, f. 411.
120. *Musik des Orients*, 1929, f. 56.
121. **Šufflay**, *loc. cit.*
122. *op. cit.*, f. 95-109.
123. *Albanesische Texte mit Glossar*, 4; dy verset gjysmë mund të merren si një i plotë.
124. «*Rev. Int. d. Et. Balc.*», Ière Année, Tome II, f. 233.
125. **Prennushi**, *Kângë popullore gegnishte*, f. 41.
126. Këtij qëllimi i shërben **Gaetano Petrotta**, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1932.

I.

Të dy lëvizjet mendore të mëdha të Europës perëndimore, në shekullin XVI humanizmi dhe renaissanca, në lëmën kishtarë-religjioze reformacioni dhe kundërreformacioni, në shekullin XIX romantizmi, e si dukje përcjellëse të këtij në fushën sociale e politike pasojat e Kryengritjes frënge, midis tyre lindja e nacionalizmit: këto lëvizje të të dy shekujve të mëdhenj ushtruan ndikimin e tyre të thellë në Europë lindore e juglindore dhe kontribuan këtu në mënyrë të fortë për lartësimin e shpirtit. Humanizmi e renaissanca, të dala prej Italisë, u zhvilluan si në të gjithë Europën ashtu edhe nëpër oborret princorë të Europës së Lindjes. Në Juglindje ato patën një lulëzim të veçantë jo vetëm në oborrin e shkëlqyer të mbretit Matias Corvinus në Buda: humanizmi italian u shtri edhe në bregdetin lindor të Adriatikut: pjella e thjeshtë e tij është «renaissanca dalmatine», dhe kjo lulëzoi me epin *Osman* të Ivan Gunduliçit. Përsa i përket lëvizjes kishtarë-religjioze, reformacioni u shfaq kudo si një revolucion, sidomos në Europë veriore e të mesme. Lufta e tij ishte drejtuar kundër fesë katolike, prandaj në Europë lindore kjo lëvizje u zhvillua në ato vise ku popujt ishin të këtij besimi, pra më fort në Poloni e në Vendet baltike. Në Europë juglindore doktrina e Luterit u përhap në Hungari e në Slloveni, por Gadishullin e Ballkanit pothuajse nuk e preku fare. Kjo kuptohet lehtë po të kemi parasysh të gjitha rrethanat: Ky vend në pikëpamje gjeografike ndodhej larg nga djepi i lëvizjes së re fetare, nga Gjermania. Përveç kësaj kombet që e banonin ishin anëtarë të kishës greke, një fe kundër së cilës nuk ishte drejtuar arma e doktrinës së re. Në pikëpamje kulturore e shoqërore në këto vise gjëllinin forma të jetës bizantine, të cilave erdhën e iu shtuan tani forma të reja turke-islame. Gjithë këta faktorë sëbashku formonin një truall shumë pak të përshtatshëm për një luftë fetare dhe për përhapjen e reformacionit. (Shkurt, Ballkani atëhere — si edhe tani — ishte tepër larg nga të qenit pjesë e «Europës» e kështu nuk mbërriti të mbështillet në lëvizjen e re religjioze. Mirëpo në qoftë se reformacioni nuk i shtriu dot krahët gjer në Gadishullin Ballkanik, ajo tjetra lëvizje fetare e kësaj kohe u bë indirekt me rëndësi për këtë

trevë. Kundërreformacioni me atë frymë universale dhe me atë organizim në metodë, të cilat që në kohë të lashta kanë cilësuar kishën romake, iu përvesh luftës kundër doktrinës së Luterit. Kjo luftë u luftua me shpatë dhe me pendë; kështu që, siç do të shohim më imtas poshtë, pati pasojë për literaturën e shumë viseve katolike të Europës, sidomos të viseve më të vogla. Ne ndodhemi në këtë lëmë përpara faktit të shënueshëm që kisha universale e Romës me latinishten si gjuhë liturgjike nuk pa ndonjë rrezik për vete të saj që fjala e Zotit të thuhej në këto vende në gjuhën kombëtare të secilit vend. Përkundrazi, duke luftuar me të njëjtat armë si po luftonte reformacioni, kisha romake e përkrahu këtë zhvillim: sepse në lulëzimin e gjuhëve nacionale ajo pa mjetin për t'i mbajtur kombet në gji të fesë katolike, për t'i forcuar në të si edhe për t'i kthyer rishtas në këtë besim. Shohim kështu pra sesi ngjarjet kishtarë-religjioze lënë gjurmën e tyre dhe në literaturë. Një radhë e tërë literaturash, si literaturat baltike, literatura çeke, kroate e të tjera, lulëzon rishtas siç do të shohim më poshtë ose lindet për herë të parë me humanizmin italian, me reformacionin dhe me kundërreformacionin. Sa për Gadishullin e Ballkanit, kundërreformacioni, siç u tha më sipër, në këtë pjesë të Europës, siç paraqiteshin rrethanat, s'kish pse të ishte i drejtuar kundër kishës së Luterit. Mirëpo në këto vise ishte shfaqur një armik edhe më i madh, islamizmi. Kjo fe, e mbështetur te armët e një perandorie të fortë, kanoste jo vetëm katolicizmin atje ku ky ekzistonte, si në Bosnjë e në Shqipëri, por edhe kishën greke-ortodokse. Detyra e re që pra këtu ruajtja jo e një kishë, po e krishtërimin mbarë. Edhe këtu lufta u vazhdua me armët mendore. Po ta shikojmë pra çështjen në lidhje me këto fakte, ahëre kuptojmë pse monumenti më i vjetri që njohim në gjuhë shqipe, libri i lutjeve të Gjon Buzukut, është i vitit 1555, pra i kohës së humanizmit dhe kundërreformacionit. Më 1618 kemi Pjetër Budin, më 1635 Frangun e Bardhë, më 1685 Pjetër Bogdanin. Më anë tjetër bie në sy fakti që disa popuj ortodoksë të Gadishullit: serbët, bullgarët e grekët vetëm me shekullin XIX nisin të zhvillojnë një literaturë të shkruar në gjuhën e tyre nacionale. Te ky shekull le të kalojmë tani.

Sot e dhjetë vjet kam shënuar shkurtas dhe që atëhere përsërita disa herë¹ që romantizmi, duke dalë nga Europa perëndimore, u përhap dalëngadalë edhe në Europën e Lindjes e të Juglindjes dhe se këto vise i arriti pjesërisht pas një ose më shumë se një brezi: kur ky në Perëndim

kish kohë që ishte zhdukur dhe kishin dalë këtu të tjera rryma letrare: realizmi, natyralizmi e simbolizmi. Përsa i takon posaçërisht literaturës shqiptare, tërhoqa vëmendjen, besoj për herë të parë, te karakteri romantik i vjershës së Naim Frashërit dhe këtë anë të veprës së tij e ndoqa shkurtimisht edhe në tiparet e saj të veçanta. Tani, nga rëndësia që pati romantizmi edhe për Europën lindore e juglindore, një vështrim i përgjithshëm i zhvillimit që mori ky në këto pjesë të Europës më duket se paraqet interes për ne. Kështu pra këtë çështje, që në shkrimet e çekura më sipër nuk pata mundësi ta trajtoj veçse si për kalim dhe për një trevë gjeografikisht të mbledhur, desha këtu ta këqyr më për së afri dhe në një lëmë më të gjerë.

Romantizmi, edhe ky, sikurse humanizmi dhe renaissanca, pjella e thjeshtë e botës së kulturës perëndimore, para se të themelohej si shkollë në Gjermani nga fillimi i shekullit XIX, edhe para se të dilte emri «romantik», që në gjysmën e dytë të shekullit XVIII ishte përgatitur si frymë e kohës dhe si atmosferë shpirtërore. Në Angli peshkopi Thomas Percy botoi më 1765 këngët dhe baladat popullore skoceze e angleze. Më 1770 doli në dritë Ossiani i Macpherson-it. Kjo vepër, e cila të gjithë besuan se ishte ashtu siç e kish shpallur autori, d.m.th. një poezi e lashtë popullore, u bë një revelacion. Në stilin e baladave të moçme skoceze, ajo madhëronte botën e zhdukur të heronjve keltë të Mesjetës. Me këtë mënyrë dhe me përshkrimet e natyrës së Nordit kjo vepër ndezi shpirtrat e kontinentit, midis të tjerëve edhe Goethe-n e ri, edhe nxiti kudo ta imitojnë. Me të njëjtën frymë si Ossiani janë shkruar Mendimet e natës të Edward Young-ut, të cilat midis të tjerave lanë gjurmët e tyre te poezia vetmitare e Friedrich Hölderlin-it në Gjermani.

— Në Francë Rousseau-i përballë njeriut të qytetëruar kishte nxjerrë tipin e njeriut të natyrës. Me këtë ai themeloi kultin modern të natyrës dhe u bë kështu, siç u bë në lëmën sociale një përgatitës i Kryengritjes frënge, edhe në literaturë prijësi i një kohe të re. Chateaubriand-i solli në literaturën frënge atë mall për vende të mërguara dhe atë ndjenjë religjioze të cilat u bënë më vonë për romantizmin elemente kryesore. Në veprat e këtij shkrimtari na del përpara shtati i atij heroi i cili, duke jetuar në armiqësi me mjedisin e tij, mbetet përgjithmonë rob i pesimizmit në jetë, i mal du siècle-it. Ky hero rron i vetmuar, prandaj dhe romantizmi është poezia e vetmisë. Kështu ky autor me shkrimet e tij si dhe me jetën e tij vetë që jetoi u bë modeli i të gjithë brezit të poetëve

romantikë të Francës. — Në Gjermani *Sturm und Drang*-u deshi një përtëritje të jetës dhe të literaturës. Më 1778-79 Herder-i botoi veprën e tij *Këngë popullore*, që e ribotoi më vonë me titullin *Zërat e popujve në këngën popullore*. Kjo çeli një epokë të re në literaturë, se tani kënga popullore hyri të bëjë pjesë në të dhe zuri vendin e vet, aq të rëndësishëm sa edhe poezia e artit. Për herë të parë ishin mbledhur këtu këngë popullore frënge, angleze, skoceze, gelike, nordike, skalde, daneze, gronlandeze, lapone, gjermane, lituane, letone, estone, italiane, spanjolle, morlake, greke etj., shkurt pra këngë europiane si dhe jashtë Europës, si këngë peruane. Ndikimin e Herder-it sidomos te kombet e vogla të Europës lindore e juglindore do ta ndeshim më poshtë. Këtu do të shënojmë se bash kënga dhe përralla popullore dhe mbledhja e tyre u bënë një nga detyrat e romantikëve. Vetë Goethe-ja i ri e thithi me entuziazëm këtë botë të re që iu çel prej Herder-it. Prej këtej ai themeloi në moshë më të shkuar termin e «literaturës botërore». Kur u shfaq romantizmi, Goethe-ja qëndrimin e tij të frohtë ndaj tij e përmblodhi në fjalët e njohura «klasike quaj unë të shëndoshën, romantike të sëmurën». Mirëpo po t'i hedhim një sy veprës së Goethe-s, do të shohim se lidhjet që shpjen prej atij te rryma e re janë shumë më të forta sesa deshi të pranonte poeti i madh vetë. Sidomos dy vepra nga të Goethe-s në trajtimin e së përgjithshmes njerëzore përshtohen nga fryma romantike. Njëra nga këto është një vepër e djalërisë, tjetra është vepra që e shoqëroi poetin gjatë gjithë jetës dhe u bë kryevepra e tij: *Wertheri* frymëzoi dy breza në Europë, brezin sentimental të kohës së Kryengritjes frënge dhe brezin romantik të shekullit XIX. *Fausti* u prit me entuziazëm prej brezit të ri, dhe me të drejtë: sepse figurën e heroit vetë, e cila në pakënaqësi demonike e kalon vetmas këtë jetë, poetët romantikë patën të drejtë ta quajnë të tyren. Romantike është te kjo vepër gjithçka poeti thuri në të nga bota nordike dhe nga mitologjia nordike. Kështu ne shohim sesi të dy figurat goethiane na shfaqen nëpër literaturat europiane të kohës romantike: Wertherin e ndeshim te *Iacopo Ortis* i Ugo Foscolo-s, Faustin te *Manfredi* i Lord Byron-it. Edhe fusha e re e literaturës botërore, që çeli Goethe-ja pas gjurmëve të Herder-it, u lëvrua prej romantikëve.

Jo më kot romantizmi hovin e tij të parë e mori në Gjermani dhe u themelua këtu për herë të parë si shkollë. Kjo puqet me natyrën e këtij kombi dhe me të kaluarën e tij historike. Në këtë vend me lëvizjen e re

të romantizmit fillon përgjithësisht edhe një epokë e re artistike e mendore: kështu këtu përkrah literaturës romantike ndeshim edhe një muzikë romantike të rëndësishme dhe një filozofi romantike. Nuk është vendi këtu që të shtjellojmë sesi lindi romantizmi në Gjermani dhe sesi u përhap në viset e tjera të Europës perëndimore. Le të shënojmë vetëm se qarku i Jenës me vëllezërit Schlegel dhe me Tieck-un u themelua më 1796. Ai përfshin dhe filozofët Schelling e Schleiermacher, piktorin Wackenroder dhe romantikun më të thjeshtë Novalis. Qarku më i vonë i Heidelberg-ut u formua rreth Brentano-s dhe Arnim-it, të cilët botuan këngët popullore të moçme gjermane. Te ky qark bëjnë pjesë Eichendorff dhe Uhland si dhe vëllezërit Grimm, etërit e studimit të përrallës. Përsa u takon viseve perëndimore fqinje të Gjermanisë, dispozicioni për romantizmin, sikundër pamë më sipër, ishte i gjallë kudo. Kështu që përhapja e literaturës gjermane dhe njohja e kësaj në ato vise që më tepër një shtytje për zhvillimin e rrymës së re.

Çi karakterizon më tepër romantikët e Perëndimit? Ndjenja e të qenit lajmësit e një literature të re. Karakteristik është prandaj për këta kontrasti ndaj poezisë klasike, në të cilin ndeshen: në Gjermani përkundrejt Schiller-it (sidomos te vëllezërit Schlegel), në Francë kundrejt klasicizmit të shekullit XVII e XVIII. Shakespearë-i dhe poetët spanjollë (Cervantes, Lope de Vega, Calderon) patën përkundrazi një ringjallje. Në pikëpamje pozitive si element i ri duhet shënuar malli i largësisë. Largësia, qoftë largësi në pikëpamje të vendit, qoftë në pikëpamje të kohës, kjo largësi, e cila në të gjitha kohët ka ushtruar magjinë e saj mbi njeriun dhe e ka shtyrë këtë të gjurmojë vise të largëta si dhe epoka të largëta të historisë, është ajo që karakterizon më fort romantikët. Vetëm largësia më e tejme në vende si dhe në mote mund të shuante mallin e njerëzve të tillë, të cilëve nuk u mjaftonte kjo botë. Nga kjo spjegohet largimi i romantizmit në kohë të mesme. Kjo është një epokë të cilën në viset e Europës perëndimore e ndjenin si kohën e madhërisë nacionale, sidomos në Gjermani, por edhe në Angli, në Francë e në Itali. Ishullin e largët e imagjinuar, të cilin Heine e quajti një herë Bimini, Eduard Mörike Orplid, dhe i cili në gojëdhënat e popujve të Nordit rronte me emrin Thule, këtë ishull të përrallshëm mund ta këqyrim si simbolin e mallit romantik. Ky mall projektohet pra në largësi dhe në një largësi të dyfishtë: gjeografikisht priret nga Orienti, në pikëpamje të kohës nga Mesjeta. Shpeshherë këto u bashkuan të dyja më një: lavdërimi i

ngjarjeve të kaluara ndër vende të largëta. Kjo përbën një kontrast tjetër midis klasicizmit dhe romantizmit, e ky qëndron në këtë fakt se përfaqësuesit e klasicizmit kishin qenë anuar më fort nga bota antike. Ky kontrast përmban në vetvete edhe një tjetër, një kontrast artistik-religjioz: Kulti i poetëve klasikë për botën antike shfaqet edhe në nderimin e paganizmit antik. Përkundrazi është një gjë e natyrshme që romantikët me dashurinë e Mesjetës lidhën edhe adhurimin e krishtërimin që mbërriti në adhurim të katolicizmit dhe të simboleve të tij. Kjo ndjenjë nuk është një entuziazëm vetëm artistik siç qe entuziazmi për botën pagane. Dashuria që patën romantikët për krishtërimin që prej Chateaubriand-it qe një ndjenjë e vërtetë, një qëndrim shpirtëror. Jo rrallë kjo dashuri arriti gjer në ekstazën mistike. Një shkallë e tillë e zjarrit fetar dha si te Novalis pemët më fisnike të poezisë. — Këto dhe të tjera nuk formojnë gjithçkanë e lidhjeve që bashkojnë këtë brez poetësh ndërmjet tyre. T'i këqyrim historikisht, këta janë të gjithë pjella e Rousseau-it dhe e Kryengritjes frënge. Të gjithë panë dhe rrojtën agimin dhe perëndimin më të vonë të një epoke epike-heroike të historisë. Kjo epokë u mishërua te Napoleoni. Të shikuar nga kjo pikëpamje, të gjithë këta poetë janë Napoleonidë, epigonë letrarë të kësaj figure historike të madhe. Mund të themi se ata vazhduan në poezi epokën e re që pat aguar përmbi Europë.

Sadoqë poetët romantikë na paraqiten kështu si pjella e së njëjtës frymë të kohës, megjithëkëtë ngjatë elementeve të përbashkëta që i lidhin me njëri-tjetrin, na dalin përpara te ata edhe tipare nacionale. Po t'i hedhim një sy literaturës frënge në vazhdim të saj që nga fillimet e tëhu, ajo që e karakterizon këtë më duket nota sociale, lufta për idenë e lirisë dhe për të drejtat e njeriut. Përkundrazi veçoria e literaturës gjermane më duket se qëndron në këtë, që ajo thellohet në jetën e përbrendshme të individit dhe se ka për objekt dramën e njeriut përkundrejt mjedisit. Kjo notë subjektive duket se i përket shpirtit nordik përgjithësisht, sepse e ndeshim edhe në literaturat skandinave. Veçse te këto konstatohet një ndryshim poetik: Këtu te përshkrimi i jetës së individit dhe i luftës së tij më duket se në trajtimin poetik të lëndës na del përpara forma epike. Ndërsa gjetiu autori zgjedh edhe qet në pah një periodë të njeriut, atë që atij i duket më e rëndësishmja, dhe këtë periodë trajton, shkrimtarit nordik i pëlqen të këndojë jetën e njeriut si të tillë që nga fillimi, duke e ndjekur nëpër etapat e ndryshme të saj,

gati si një dramë me shkallë kohësore të ndryshme. Kështu që këtu mund ta rrojmë lindjen vetë të njeriut, pastaj jetën e tij dhe së fundi mbarimin. Këtë prirje e ndeshim në veprat kallëzuese të Selma Lagerlöf-it, Sigrid Undset-it e të Knut Hamsun-it e të tjerëve, por edhe në dramë si të *Peer Gynti* i Ibsenit. Kjo pikë, me gjithë trajtat e përbashkëta që kanë literaturat nordike me literaturën gjermane, më duket se është një ndryshim midis tyre në trajtimin e lëndës poetike, ndryshim që mbase gjer tani ka rënë pak në sy. Veçse, siç u tha, kthimin në unë-n, subjektivizmin reflektiv e kanë të përbashkët të gjitha këto. Po ta shikojmë atëhere së këtejmi, nuk ndodh më kot që vepra poetike më e madhe e gjermanëve, *Fausti* i Goethe-s, është tragjedia e individit. Kjo nuk do të thotë se idetë sociale në Gjermani, poezia e unë-s në Francë nuk kanë gjetur kurrkund këngëtarin e tyre; veçse një vështrim historik i të dy literaturave do të vërtetojë përpjesëtimin që vendosëm më sipër. Përveç asaj ky ndryshim nuk duhet marrë si një ndryshim kualitativ, por më fort si një ndryshim tipologjik. Le ta shikojmë tani nga kjo anë poezinë romantike në Francë e në Gjermani: na del përpara edhe këtu kjo tendencë mendore nacionale: te romantikët frëngj, me gjithë individualizmin dhe me gjithë distancën nga zhurma e botës, të cilat e shquajnë romantizmin përgjithësisht si lëvizje europiane, na dalin qartas përpara përpjekjet për idetë sociale e politike. Misionit të poetit frëng, që përveçse si poet të veprojë si përmirësues kombëtar, i mbeti besnik edhe brezi i romantikeve. Përkundrazi «dulja e rimtë» e Novalis-it, simboli i mallit romantik, dhe «nata magjiplotë me hënë» e Tieck-ut janë karakteristike për natyrën dhe drejtimin e romantizmit gjerman. Largimi në viset e përrallës e të këngës popullore, të cilat nuk vërehen në romantikët e Francës, janë aq karakteristike për romantikët gjermanë sa është karakteristike për romantikët frëngj lufta për idetë sociale e nacionale. — Po ta shtrijmë krahasimin më tutje dhe të sillemi edhe nga romantizmi anglez, do të shohim se ky — me gjithë mëvetësinë që e shquan — bashkon në vete që të dyja tiparet polare, të cilat i njohëm më sipër si karakteristike për poezinë gjermane e për poezinë frënge: Ëndërrimin e qetë e larg nga bota e duan «poetët e liqenit», Coleridge, Wordsworth dhe shokët e tyre, të quajtur kështu nga liqenet e Westmorelandit, buzë të cilave u pëlqente të banojnë. Përveç kësaj kënga popullore këtu në Angli, siç pamë lëvrohet që në kohën pararomantike. Mirëpo në kundërshtim me këto, të dy përfaqësuesit më të

shkëlqyer të romantizmit anglez, Lord Byron dhe Shelley, hyjnë në luftë me një kohë të tërë dhe me një mjedis të tërë — Keats vdiq shumë i ri e kështu nuk mundi të zhvillojë plotësisht personalitetin e tij. Por nuk është vetëm ky kundërshtim ndaj rrethanave të asaj kohe që shquan romantizmin anglez nga romantizmi i viseve të tjera. Karakteri kozmopolit, i cili nga rrethanat historike u bë një cilësi e veçantë e këtij kombi, na shfaqet edhe te poetët e tij e në veprat e tyre: largimi romantik në vise të largëta dhe në epoka të largëta të historisë është për Byron-in dhe Shelley-n aq karakteristik sa dhe qëndrimi i tyre i gjatë në Jug, vdekja e të dyve në dhe të huaj, vdekja e Byron-it për lirinë e një polemi të huaj. Me këtë mënyrë ky poet u bë idoli dhe modeli i një brezi të tërë ndër poetë të kontinentit — poet europian si mbase asnjë tjetër nga bashkëkohësit e tij. Ndikimi i tij u përhap edhe në atë vend ku ai kaloi vitet e fundit të jetës: në Itali. Përsa i përket këtij vendi, këtij në korin e romantizmit të Europës perëndimore nuk iu ndie një zë shumë i pavarur: siç u tha më sipër, *Iacopo Ortis* i Ugo Foscolo-s është *Wertheri* italian; *Të fejuarit* e Manzoni-t sjell në Itali romanin historik, të cilin në literaturë e themeloi Walter Scott-i. Sepse poetët italianë të kësaj kohe, qofshin klasikë, qofshin romantikë, nuk u ndezën aq fort për atë përtëritjen letrare ose mendore që vlonte asohere ndër shpirtat e Europës. Ata pendën e vunë më shumë në shërbim të një ideje tjetër, të lirimit të kombit të tyre. Këtë të njëjtën ide nacionale romantizmi e zhvilloi posaçërisht, siç do shohim më poshtë, në Europë lindore e juglindore.

Në viset e tjera të mëdha të Europës si dhe në ato vise që i përkasin Perëndimit, ose janë afër këtij o afër Gjermanisë, rryma e re letrare u zhvillua pothuajse njëkohësisht si në Perëndim. Ajo ruajti në thelb edhe ato trajta e tipare — sadoqë i zhvilloi simbas karakterit të vet nacional — të cilat i konstatoam më sipër si tipare karakteristike të poezisë romantike. Në këto dua të përfshij sidomos Spanjën, Viset skandinave dhe Rusinë. Në Spanjë romantizmi hyri nga Franca dhe nga Anglia. Drejtimi katolik i romantizmit gjeti këtu te ky vendi klasik i katolicizmit një tokë pëlllore ashtu si gjetën idetë politike të ardhura nga Franca. Edhe në Portugali shohim ndikimin e romantizmit anglez me Byron-in në krye. Në Veri lëvizja e re shtegtoi prej Gjermanie, qe një ndikim i poezisë dhe i filozofisë gjermane. Në Rusi qe sidomos poezia e Byron-it ajo që ndezi shkëndijën te Pushkini i ri. Fryma romantike nga Pushkini

kaloi te Lermontovi, nga Lermontovi te Gogoli. Me këtë shkrimtar literatura ruse nis të ndjekë rrugën e vet, të cilën e pat çelur Pushkini: ajo hyn te ai shteg i realizmit social, të cilit i mbetet besnike këtej e pari dhe në të cilin qëndron origjinaliteti i saj. Duhet shënuar se romantizmi në këtë vend zhvilloi dhe një muzikë të rëndësishme.

II.

Këto janë, të këqyrura në përgjithësi, natyra dhe zhvillimi i romantizmit në literaturat e ndryshme të Europës perëndimore e veriore dhe në Rusi. Ndryshe qëndron puna në viset e tjera të Europës lindore e juglindore. Siç u tha në hyrje të këtij artikulli, u desh së pari mjaft kohë gjersa lëvizja e re letrare mbërriti në këto anë. Përveç kësaj edhe në zhvillimin e kësaj lëvizjeje mund të vërehet një ndryshim.

Ç'humbi romantizmi nga karakteri i tij origjinal në kalimin që bëri për në këto pjesë të Europës? Cilat anë përkundrazi i zhvilloi në mënyrë të veçantë? Cilat anë të reja i zhvilloi përgjithësisht nga e para fare? Në këto çështje desha të hyj këtu pak më imtas. Edhe meqenëse këto janë karakteristike për gjithë këtë truall, le t'i këqyrim këtu në përgjithësinë e në lidhjen e tyre gjeografike.

E para gjë që bie në sy është se kjo rrymë e re letrare në këto vise sjell me vete përgjithësisht një agim të literaturës. Vendet që pamë gjer këtu qenë vende me një traditë letrare të fortë dhe mjaft të gjatë: vende pra, në të cilat romantizmi shënon vetëm një epokë letrare; kjo epokë ia zë vendin një epoke më të parë dhe nga ana e saj ia lë vendin një epoke më të re. Në kundërshtim me këto në shumë vise të Europës lindore e juglindore, po të përjashtojmë shkrimet liturgjike, në këtë kohë nuk ekzistonte edhe një literaturë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Visaret e poezisë popullore kishin mbetur djerr. Këtu vjen romantizmi, dhe merita e tij e dyfishtë që që ngriti nga pluhuri poezinë popullore të gjysmë Europës dhe çeli në këto anë një lulëzim të ri të literaturës mbarë, jo vetëm të një literature të re. Rëndësia e tij për këtë pjesë të Europës qëndron më fort te nxitja që dha për një përlindje letrare sesa në natyrën e një epoke të thjeshtë të shkrimtarisë.

Ndryshimet që gjejmë midis këtij romantizmi të Europës lindore dhe romantizmit perëndimor lidhen ngushtë me trajtën mendore të këtyre kombeve të Lindjes dhe të Juglindjes së Europës si edhe me nivelin e kulturës së tyre. Mungesa e shpirtit spekulativ, e cila i karakterizon këto kombe të mbetura prapa në shumë pikëpamje, pati për rrjedhim që problemet e jetës edhe të shpirtit nuk u bënë këtu aq

shqetësuese si gjetiu në Europë. Kështu kuptohet pse këtu mungon the-
meli filozofik i poezisë, i cili është një veçori e romantizmit perëndimor;
pse mungon kulti i individit në kontrastin e tij me mjedisin; mungon
pastaj largimi i poetit nga realiteti, fluturimi i tij pegasik në kohë të
largëta e në vise të largëta; lumturia në ndjenjë; malli i larguar nga kjo
botë, i trupëzuar te lulja e rimitë; jeta në ëndërr, e simbolizuar me natën
magjike të ndritur me hënë; ajo ndjenja intime e natyrës që e bën arti-
stin ta ndiejë veten një më natyrën; kulti i gruas, e cila në Perëndim
bash në kohën e romantizmit ka luajtur një rol kryesor (Karoline
Schlegel, Mme. de Staël, George Sand); ndjenja religjioze dhe idealizmi
mistik; ironia romantike. Siç shihet, kanë humbur këtu bash shumë nga
ato elemente të cilat e cilësojnë romantizmin si të tillë, duke e dalluar
nga të tjera lëvizje letrare. Përpara këtij fakti mund të pyesim: a mund
të flitet më këtu për romantizëm?⁹ Sidoqoftë do t'i japim të drejtë A.
Narciss-it, i cili romantizmin e Europës lindore e kupton si romantizëm
realist².

Po ç'humbi këtu romantizmi në përmbajtje të brendshme poetike, e
fitoi në efektin e tij në pikëpamje sociale-politike. Ideja nacionale, e cila
atje ku, si në Itali, një popull rronte në robëri, arriti në një zhvillim të
veçantë, në Europë lindore e juglindore u bë një nga cilësitë kryesore të
çdo poezie romantike. Kjo rrjedh nga rrethanat historike të këtij trualli.
Këtu rronin popuj, pjesa më e madhe e të cilëve kishin vuajtur shekuj
me radhë nën zgjedhën e huaj. Për këta lëvizja nuk qe vetëm një pran-
verë letrare, ajo u bë pranvera e lirisë dhe e zgjimit të ndërgegjes së vet-
vetes. Qëllimi veçanërisht i kombeve të Ballkanit qe shkëputja nga
bloku osman, individualizimi nacional: krijimi i një shteti kombëtar, i
një literature të vet dhe i një gjuhe letrare. Nga kjo kuptohet mirëfilli
pse te këto nacione me një shkallë kulture përgjithësisht të ulët poetit e
shkrimtarit i ra nevojisht misioni i pionierit të lirisë, i edukuesit politik
dhe i apostullit, shpeshherë edhe roli i politikanit. Nuk është çudi që në
rrethana të këtilla interesat artistike-estetike nuk e zënë te poeti vendin
e parë, sepse këtë e pushton veprimtaria e përjashtme. Veçse naciona-
lizmi, i cili politikisht e ka gurrën e tij te Kryengritja frënge, letrarisht te
romantizmi, zhvilloi këtu edhe anën e tij të prapë, shovinizmin. Siç
ndodh shpeshherë me kombet e vogla, nderimi i vlerave të polemik të
vet pati për pasojë që këto vlera shumë herë u çmuan më lart se
ç'duhej. Kjo qe ana negative e këtij zhvillimi; ajo dha shkas më vonë për

kërkesa dhe pushtime territoriale dhe helmoi kështu në mënyrë të shumëfishtë marrëdhëniet midis kombeve. Por pozitive që e gjithë puna që lidhej me tërësinë nacionale: pikësëpari punimi i gjuhës amtare, studimi i poezisë popullore dhe i folklorit përgjithësisht. Me këtë prirje nga kombi romantizmi i Europës lindore i afrohet romantizmit gjerman: në ndryshim me viset romane, në të cilat studimi i poezisë popullore i mbeti barrë një kohe më të vonë, një kohe shkencore. Shkaku i kësaj lidhjeje qëndron te fakti se sidomos në viset sllave e baltike romantizmi për arsye gjeografike hyri kryesisht nga Gjermania. Fryma e Herder-it, i cili mund të themi se që ai që *e zbuloi* poezinë e popujve të Europës lindore, hyri te këta popuj vetë dhe i nxiti këta të thellohen në poezinë popullore, sidomos në këngë dhe në përralla.

Përsa i takon gjuhës, kjo që një lëmë në të cilën poetit në këtë pjesë të Europës i ra një detyrë shumë më e rëndë sesa në pjesë të tjera. Shkaku qëndron te përndarja e gjuhëve si edhe te shkalla e zhvillimit të tyre. Në pikëpamje gjuhësore Europa lindore dhe juglindore është pikësëpari më e përçarë sesa Perëndimi. Këtu në Perëndim disa troje gjuhësore të mëdha ngjatë njëri-tjetrit, atje në Lindje një numër i madh nacionesh më të mëdha e më të vogla, dhe çdo komb me gjuhën e tij të vetën. Këto gjuhë ndodheshin atëhere dhe ndodhen shumica edhe sot në stadin e dialekteve, në përshtatje me gjendjen kulturore-sociale të këtyre popujve, të cilët për një pjesë të madhe nuk përbëjnë edhe një nacion. Detyra që që ndërmjet këtyre dialekteve njëri të ngrihej e të bëhej gjuha e shkrimit ose që nga disa dialekte të mbruhej një gjuhë letrare; kjo gjë i përgjigjej dëshirës paralele e të natyrshme për një unitarizim në pikëpamje nacionale-politike. Një tjetër vështirësi qëndronte këtu te fakti se këto gjuhë përgjithësisht nuk ishin ende të formuara si gjuhë shteti dhe si gjuhë kulture, dhe pjesërisht nuk janë as edhe sot. Të pasura në visarin e kulturës materiale, shumica qenë edhe janë dhe tani të varfra në shprehjet e jetës së një kulture të rafinuar. Kur lindi nacionalizmi në shekullin e kaluar dhe kur u kuptua se ndër elementet që përbëjnë një nacion në rend të parë vjen gjuha, iu përveshën me zell lëvrimin të gjuhës amtare. U pa nevoja të kryhej punë pionieri: të çelej pylli i dendur, cungjet e gjalla të gdhendeshin e të bëheshin lëndë e dërrasa dhe këto të lëmoheshin. Është një gjë karakteristike se në këtë punë morën pjesë jo vetëm poetët, shkrimtarët dhe gazetarët, por gjithë shtesa e intelektualëve u bë pjesëtare te kjo çështje nacionale dhe

bashkëpunoi me të. Po të këqyret fund e krye visari i madh i fjalëve që u krijuan rishtas në gjuhët e Europës lindore e juglindore prej lëndës së parë të gjuhës së vet, atëhere mund të kuptohet përparimi i madh që është bërë në këtë drejtim. Ajo që në Europë perëndimore është përfundimi i një zhvillimi të natyrshëm dhe të ngadalshëm që zgjati shekuj me radhë, këtu u desh të kryhet në disa breza. Kjo punë po vijon edhe sot e gjithë dita, sidomos ndër kombe e ndër shtete të vogla. Në këtë drejtim të lëvrimit të gjuhës romantizmi i Europës lindore, siç shihet, e kapërceu romantizmin e Perëndimit, sipas nevojës që u paraqit këtu. — Po të pyesim se ç'anë tjetër zhvilloi këtu romantizmi, duhet të shënojmë edhe një lëmë tjetër që ka të bëjë me kujdesin e treguar për çdo elementar kombëtar: lavdërimi i së shkuarës së kombit në poezi, mbujtja poetike e periodave të ndryshme historike të vendit sidomos nga koha e mesme. Kjo pikë është, siç shohim, një tipar të cilin romantizmi i Europës lindore e ka të përbashkët me romantizmin e përgjithshëm europian. — T'i përmbledhim të gjitha këto, do të pranojmë se literatura që u ngjall në Europën e Lindjes e të Juglindjes nga romantizmi, zhvilloi më fort anën nacionale-politike. Kjo tendencë përfshiu jo vetëm vepra thjesht letrare po të gjitha shkrimet, posaçërisht librat shkollorë, librat popullore e kalendaret dhe jo mënfund edhe shtypin e shkrimet shkencore.

Tani le t'i hedhim një vështrim të shkurtër zhvillimit që mori poezia romantike në viset e ndryshme të kësaj pjese të Europës, duke çekur edhe ndikimin që patën më parë humanizmi, reformacioni dhe kundër-reformacioni në literaturat e këtyre viseve.

Në **Finlandë** si atin e literaturës mund të këqyrim reformatorin fetar Mihael Agricola, i cili nën ndikimin e reformacionit botoi më 1548 Dhiatën e Re. Gabriel Porthan (1739-1804) u frymëzua te *Ossiani* i Macpherson-it. Romantizmi, i cili hyri prej Suedie, çeli këtu një lulëzim të ri të literaturës si dhe të mendimit nacional. Nën ndikimin e Herder-it dhe të shkollës romantike u mblodhën këngët popullore finlandeze. Duke u mbështetur te këto këngë të lashta epike e lirike Elias Loennrot shkroi epin nacional të finëvet, *Kalevalën* (1835). Ç'u tha më sipër përreth rëndësisë që pati poezia popullore për poezinë romantike të Europës lindore, e shohim të realizuar qartas te kjo vepër. Këtu një gjeni poetik mbloshi këngët e popullit dhe i shkriu në një tërësi të pandarë. Përveç literaturës së thjeshtë romantizmi zgjoi në Finlandë edhe

shkencën. Ai i dha hov të ri posaçërisht linguistikës dhe folklorit, sidomos studimit të përrallës.

Si në Finlandë ashtu edhe në Estoni literatura ia detyron lulëzimin e saj shekullit XVI; këtu kemi *Katekizmin katolik* të peshkopit Johannes Kievel (1577). Herder-i nxiti pastorin Hupel të mbledhë këngë popullore, të cilat ai i botoi në veprën e tij «Zërat e popujve në këngën popullore». Romantiku F. R. Kreutzwald (1803-82) i caktoi vetes si qëllim që të kryejë në literaturën estone atë që Elias Loennrot-i pat bërë me *Kalevalën* në Finlandë. Këtu në vitet 1857-61 doli në dritë *Kalevipoege*, epi nacional i estonëve. Edhe kjo është si *Kalevala* një vepër romantike në kuptimin e Europës lindore, duke qenë edhe kjo e ngrehur përmbi poezinë popullore. Zhvillimi i mëpastajmë i literaturës estone vazhdoi në këtë vijë të traditës. Romantike sikundër Kreutzwaldi është vjershëtorja Lydia Janssen, me pseudonim Koidula (1843-86). Në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Estoni, ashtu si në viset fqinje, filloi të mbledhurit e visareve të poezisë popullore. Te kjo vepër vazhdohet edhe sot me punë të pareshtur.

Ndër popujt baltikë dy kombet vëllezër, Letonët dhe Lituanët, flasin nga një gjuhë indoeuropiane të cilat ndër të gjitha gjuhët indoeuropiane që janë sot të gjalla kanë ruajtur në strukturën e tyre më mirë se çdo tjetër karakterin e një gjuhe indoeuropiane.

Si dhe të tjera literatura të Europës veriore, edhe literatura letone ia detyron lindjen e saj reformacionit. Më 1530 u përkthye në letonisht *Ati ynë*, më 1586 *Katekizmi i vogël* i Luter-it. Një tjetër valë të literaturës e solli kundërreformacioni. Shohim pra se literatura letone, siç u çek më sipër, ia detyron agimin e saj luftës së kishave ndërmjet tyre. Në kohë pararomantike Herder-i mblodhi këngë popullore letone, të cilat bashkë me *dainos*-et lituane na paraqesin botën e veçantë të një kombi të lashtë. Romantizmi zgjoi edhe këtu ndërgjegjen nacionale dhe lëvrimin e folklorit. Gjithashtu letonët iu përveshën studimit të gjuhës amtare dhe mbrujtjes së gjuhës letrare, një punë kjo që vazhdon edhe sot e gjithë ditën. Literatura nacionale në Letoni zhvillohet mjaft vonë, ashtu siç mund të pritët nga një vend i Europës lindore, aty nga mesi i shekullit XIX: Patrioti e shkrimtari Atis Kronvalds (1837-75) e pasuroi gjuhën letrare. Tendenca romantike kanë Rainis (1865-1929), Janis Akuraters (1878-1937), Adolf Erss (lindur më 1884) dhe Fricis Barda³.

Sikurse letonët ashtu edhe lituanët ia detyrojnë fillimin e literaturës

së tyre reformacionit, i cili hyri në fillimin e shekullit XVI. Shkrimtari më i vjetër i tyre është Martinus Mažvidas, i cili vdiq më 1562. Ndërkaq ndikimi politik që ushqejej nga Polonia nuk pushoi të gjëlliste këtu. Kështu shohim se edhe këtu, si në gjithë truallin e Europës verilindore, të dy kishat rivale njëra me tjetrën vepruan në formimin e literaturës dhe të gjuhës letrare. Lessing-u që i pari që më 1759 tërhoqi vëmendjen mbi bukurinë e *dainos*-ve, siç quhen këngët popullore lituane. Atë e ndoqi Herder-i, i cili botoi disa sosh në mbledhjen e tij të këngëve popullore, këtë e ndoqi Goethe. Sidomos që nga koha romantike e këtej një numër i madh dijetarësh vendës e të huaj vijuan mbledhjen e këtyre këngëve. Studimi i gjuhës dhe i folklorit zgjoi edhe ndërgjegjen kombëtare. Me një energji dhe me një zjarr për të admiruar lituanët, sikurse dhe letonët, iu shpërvolën punës për të mbrujtur një gjuhë letrare, një qëllim të cilit për një pjesë të madhe ia kanë mbërritur. Kështu vërtetohet edhe këtu vërejtja që u bë përgjithësisht për Lindje e Juglindje të Europës: që poetët dhe shkrimtarët janë njëkohësisht patriotë edhe dijetarë, botues fletorësh dhe të përkohshmesh, shkri-mesh shkencore dhe antologjish. Ndër këta duhen përmendur Kuršaitis, Prickus (1806-84), Rudolf Jacoby, Sauerwein dhe Anton Baranovski.

Në **Poloni** romantizmi hyri në një kohë me viset e Europës perëndimore, d.m.th. që në vitin 1820. Kjo rrjedh ngase ky vend, për shkak të besimit të tij katolik dhe lidhjeve me Perëndim që s'u ndërprejnë kurrë, ka qenë gati pararoja e fundit e Perëndimit në Europë lindore. Këto lidhje rrjedhin nga koha e mesme dhe kanë vazhduar në kohën e re. Ndërsa renaissanca italiane la gjurmë të dukshme në arkitekturën e këtij vendi, humanizmi italian dhe kundërreformacioni sollën një lulëzim të ri në literaturë. Zhvillimi i romantizmit në këtë trevë zë një vend të ndërmjetëm midis romantizmit të Europës perëndimore dhe romantizmit të Europës lindore, siç i karakterizuaam më sipër: romantizmit polak i mungon më një anë mbështetja e fortë te poezia popullore, të cilën e ndeshim kudo gjetkë në Europë lindore e juglindore. Ai më anë tjetër i afrohet romantizmit të Perëndimit nga modelet që imiton, sidomos Byron-in, si edhe nga karakteri i poezisë, e cila në përshtatje me shpirtin polak është e drejtuar mjaft nga Perëndimi. Veçse ajo që kësaj poezie romantike i vë vulën e Europës lindore, por njëkohësisht e shquan edhe nga literaturat e tjera të Lindjes së Europës, është nota e

fortë patriotike. Kjo e ka rrënjën te fatet politike të këtij vendi. Rreth vitit 1800 nisi shkulla e inteligjencës polake sidomos për në Francë. Dhe me të vërtetë literatura romantike e polakëve është për pjesën e saj më të madhe literaturë emigrantësh; një dukje kjo, të cilën në shekullin XIX e hasim edhe ndër kombe të Europës juglindore, si ndër bullgarë e ndër shqiptarë. Adam Mickiewicz (1798-1855), Juliusz Slowacki (1809-49) dhe Zygmunt Krasiński (1812-59) janë të tre yjet e romantizmit polak. Idealizmin e Schiller-it e gjejmë në veprat e të parit ndër ta, pesimizmi i Byron-it i magjepsi të tre: heroi i ndjekur nga *maladie du siècle* i romantizmit perëndimor na del përpara te të gjithë këta. Në veprat rrëfenjëse të tyre shfaqet ndikimi i romanit historik të Walter Scott-it. Romantikë të Europës lindore janë në këtë, që janë poetë edhe patriotë sëbashku; poezinë e vënë në shërbim të nacionit të tyre. Lëndën e veprave të veta këta e nxjerrin nga e kaluara historike e vendit. Në jetë marrin pjesë aktive në përpjekjet e atëhershme të polakëve për liri. Mickiewicz-i si romantik i Europës lindore është edhe luftar, ai merr pjesë në luftën e Krimesë dhe vdes në vend të huaj ashtu si Slowacki. Përveçse në literaturë romantizmi polak ka dhënë vepra të larta edhe në muzikë: me Chopin-in, i cili e ngriti muzikën polake në shkallë europiane.

Dega e familjes sllave që u shty më në Perëndim sesa të tjerat, **Çekët** dhe **Slllovakët**, në epet e tyre kalorëse të Mesjetës u mbështetën në modelet e afërta gjermane dhe në modelet frënge. Me Jan Hus-in (1369-1415) populli çek zhvilloi një jetë të vetën edhe në literaturë dhe atëhere u formua gjuha letrare çeke. Një çelje të re të literaturës e sollën humanizmi italian dhe reformati: kjo është ajo që quhet perioda e artë e literaturës çeke. Si në popuj të tjerë të vegjël romantizmi në shekullin XIX zhvilloi edhe këtu më fort anën nacionale sesa anën letrare. Një radhë dijetarësh të përmendur i caktuan vetes detyrën që të theksojnë karakterin sllav të nacionit dhe të fitojnë shpirtat për çështjen kombëtare dhe pansllave. Studimet sllavistike si dhe pansllavizmi përgjithësisht e kanë pasur djepin e parë në Pragë. Josef Dobrovský u bë me veprën e tij *Institutiones linguae slavicae dialecti veteris* (1822) themeluesi i sllavistikës. Puna e tij në lëmë të gjuhësisë u vijua nga Josef Jungmann e nga slllovakët P. J. Safarik dhe Stur, në fushë të historisë prej slllovakut František Palacký. Drejtimin që pat themeluar në shkencë Dobrovský e zhvilloi në lëmë të poezisë me frymë

romantike sllovaku Ján Kollár. Mácha kalli në literaturën çeke frymën e Byron-it e të Walter Scott-it. Përveç kësaj, në mbështetje të romantizmit gjerman, romantikët filluan të mbledhin këngët popullore. Kulti i poezisë popullore në përshtatje me frymën e kohës shkoi aq larg, sa Václav Hanka në vitin 1819, ashtu siç pat bërë para tij Macpherson-i, një mbledhje këngësh që pat përpiluar ai vetë guxoi e e botoi si poezi të lashtë popullore, e cila në literaturë njihet me emrin «dorëshkrimi i Zelená Hora». Duhet shënuar se çekët krijuan ashtu si rusët dhe polakët edhe një muzikë romantike. Dvořák dhe Smetana derdhën në muzikë perëndimore meloditë sllave të vendit të tyre. Përgjithësisht duhet thënë se shkenca romantike dhe poezia romantike e shekullit të kaluar përgatitën shpirtat e çekëve dhe sllovakëve për pavarësinë politike që fituan në shekullin tonë.

Me Hungarinë shkëlqim truallin e Europës juglindore. Ky popull u mbrujt historikisht në një nacion duke u mbështetur te kombet fqinj, por njëkohësisht edhe në kontrast me ta. Në këtë truall Perëndimi dhe Lindja janë pjekur qëmoti dhe kanë luftuar njëri-tjetrin. Me hyrjen e hershme të katolicizmit ky çip më verior i Europës juglindore u bë njëkohësisht e përgjithmonë pjesë e Perëndimit dhe e afirmoi këtë rol historik të tij edhe në luftrat e gjata me turq. Si për viset fqinje dhe më shumë se në këto vise mori rëndësi këtu humanizmi italian. Ai kontriboi aq shumë për zhvillimin e literaturës magjare sa dhe luftrat fetare që përshkuan vendin në ato kohë, reformacioni gjerman, kalvinizmi dhe kundërreformacioni romak. Shekulli XIX solli si në viset e tjera të Europës lindore e juglindore zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, reformën e gjuhës dhe një literaturë të re. Kryengritja frënge, Revolucioni i korrikut me turbullimet e vitit 1848 në Europë ngritën në këmbë edhe këtë komb liridashës. Posaçërisht mundimeve të Kossuth-it u detyrohet kushtetuta e 1867-ës, e cila u dha magjarëve njëfarë mëvetësie brenda suazës së Monarkisë. Në lëmë të gjuhës, rëndësinë e së cilës për gjithë këtë truall të Europës e theksuam më lart, shkrimtari dhe përkthyesi Ferenc Kaszinczy qysh nga mbarimi i shekullit XVIII pat sjellë një përtëritje dhe një pasurim dhe i pat çelur kështu rrugën poezisë romantike që u duk pas pak kohe. Romantizmi, i cili në Hungari për arsye gjeografike filloi heret, dha këtu ashtu si në Poloni pemë të mira. Që ai u vu në shërbim të çështjes kombëtare dhe që mbërriti në këtë fushë gjer në ekstazë, nuk është më nevoja, pas sa u tha

më sipër, të tirret më gjatë. Sándor Kisfaludy (1772-1844) këndon mesjetën e kombit, kurse i vëllai Károly (1788-1830) i jepet dramës me lëndë kombëtare. Këtë të njëjtën fushë e lëvron József Katona (1790-1830) me dramën e tij *Bánk Bán*. Koha përrallore e pushtimit të vendit nga magjarët dhe e dëbimit të banorëve bullgarë më të parë të truallit përbën objektin e epit *Ikja e Zalanit* të Mihály Vörösmarty (1800-55). Te ky poet na shfaqet më një anë ndikimi perëndimor i Victor Hugo-it, më anë tjetër ai si romantik priret nga Orienti: kështu bota e magjarëve paganë, e cila përndryshe nuk njihet dhe aq mirë, mbruhet te ky poet me motive të mitologjisë gjermanike dhe perse; edhe dualizmi etik i persëvet na del në shesh në veprën e tij në mënyrë që principi i mirë përfaqësohet nga Haduni, i keqi nga Armany (Ahriman). Romantikë qenë edhe poeti epik János Arany (1817-82) si dhe Sándor Petöf-i (1823-49), i cili ra i ri në luftë, më i madhi poet i Hungarisë dhe i pari që merr pjesë në literaturën europiane. Të dy këta poetë mbështeten te poezia popullore, Arany edhe në pikëpamje të metrikës. József Eötvös (1813-71) themeloi kallëzimin romantik, duke u mbështetur te Chateaubriand-i dhe, si të gjithë autorët e romanit në Europën e kësaj kohe, te Walter Scott-i.

Ndër viset e Europës juglindore **Rumania** zë nga ky shkak një vend të veçantë, sepse është dega e trugut të gjuhëve romane e cila u shtri më shumë në Lindje se të tjerat. Po ky popull përveçse gjuhës ka pakgjë nga romaniteti në vete të tij. Përkundrazi këtu lënda etnike pararomake u mbrujt me elementin më të vonë shqiptar dhe me elementin sllav dhe nga kjo përzierje leu nacioni rumun. Në pikëpamje fetare e kulturore vendi bën pjesë qëmoti në sferën bizantine. Kështu ndodhi që reformati dhe kundërreformati nuk patën sepse t'i hapnin luftë njëri-tjetrit këtu, por ata që mbërritën gjer në këtë vend qenë humanizmi dhe renaissanca e Italisë. Përpara lulëzimit të literaturës që ndodhi këtu në shekullin XIX si kudo në Europë lindore e juglindore, Rumania bëri që në shekullin XVII e XVIII një farë reforme të gjuhës. Puna ishte që të pakësohej disi ndikimi i thellë i sllavishtes, e sidomos të zëvendësohej shkrimi sllav me shkrimin latin. Kjo u bë më 1860. Influenca e frymës frënge, e cila pat hyrë edhe më parë, në shekullin XIX zotëroi mbi gjithë të tjerat dhe kontribuoi shumë në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe në zhvillimin e jetës letrare. Ndjenja nacionale nën ndikimin e romantizmit u zhvillua kryesisht në drejtim të latinitetit. Rumunët fillu-

an ta ndiejnë veten një komb latin. Që kjo ide përmban një thelb të vërtetë, këtë e dëshmon vetë karakteri roman i rumanishtes. Dihet edhe se kjo ide posaçërisht në lëmë të gjuhës u teprua disi, po kjo kuptohet mirëfilli nga qëndrimi që mbajnë rumunët ndaj kësaj çështjeje, e cila ndër ta ka marrë një rëndësi kryesisht nacionale. Ky kthim drejt kombit solli me vete lëvrimin e poezisë popullore. Poezia popullore rumune shquhet për frymëzimin e saj të butë lirik dhe për mallin e qetë të saj, për *dor-in*, dhe në këtë dallohet nga poezia e polemeve fqinje, sidomos nga poezia bullgare. Shpirti dhe fatet historike të popullit rumun duket se na pasqyrohen si këtu si dhe në faktin tjetër që jeta baritore zë një vend kaq të gjerë te kjo poezi. Folkloristë dhe poetë si Vasile Alecsandri iu përveshën punës në shekullin e kaluar dhe qitën në dritë visaret e poezisë popullore. Më 1865 Titu Maiorescu themeloi shoqërinë «Junimea» (Djalëria) dhe i çeli kështu shtegun literaturës së re. Nga ky qark doli Mihail Eminescu (1850-89), poeti më i madh i rumunëve dhe i vetmi lirik i Gadishullit ballkanik që ka hyrë të marrë pjesë në literaturën europiane. Te ky përfaqësues i vonë i romantizmit gjejmë motive të poezisë popullore dhe të përrallës rumune. Ai me frymën që ishte e tij i lartësoi ato në sferën e natyrës së përgjithshme njerëzore. Sëbashku me këtë shohim se gjuha rumune mbërriti të ketë në vjershat e tij një muzikalitet që s'e pat arritur gjermë atëhere. Në romantikët rumunë duhet përmendur edhe Grigore Alecsandrescu (1812-85), i cili eci pas gjurmëve të Lamartine-it.

Ndër **Bullgarë** idetë politike-sociale të ardhura nga Europa perëndimore në gjysmën e parë të shekullit XIX zunë në fillim rrënjë më të forta sesa idetë thjesht letrare. Të dyja këto rryma morën të njëjtën rrugë si në Shqipëri, në përshtatje me rrethanat analoge në të cilat ndodheshin këto dy vende. Kështu shoqëritë e para politike-letrare si dhe të parat fletore dhe të përkohshme u themeluan për të dy kombet jashtë vendit, posaçërisht në Rumani. E para punë për këtë vend që kishte mbetur prapa në shumë pikëpamje qe që të ngrihej nga kultura, të hapeshin shkolla, të shkruheshin libra shkollore, të mëvetësohej kombi në pikëpamje politike dhe kishtarë, të krijohej një literaturë nacionale. Lirimi nga sundimi i kishës greke u arrit me krijimin e Ekzarkatit bullgar më 1860. Lirimi politik nga sundimi turk erdhi me themelimin e Principatës bullgare që u vendos më 1878 në Kongres të Berlinit. Në lëmë të gjuhës duhej zëvendësimi i gjuhës paleosllave me

një gjuhë letrare nacionale si dhe zgjidhja e çështjes së ortografisë. Në këtë fushë pat punuar më përpara murgu Paisi, i cili me veprën e tij *Historia e kombit bullgar, e murgjve dhe e shenjtoreve të tij*, botuar më 1762, pat ndezur ndër bullgarë mendimin sllav. Në lëmë të literaturës rryma romantike zhvilloi në fillim edhe te bullgarët prirjen nacionale dhe lëvrimin e këngës popullore, punë që lidhej me të parën. Pemën e parë kjo lëvizje e dha me baladën *Stojan dhe Rada*, botuar më 1845 në Odesë, e cila u shkrua në frymë të këngës popullore dhe shënon fillimin e poezisë së re artistike të Bullgarisë. Te poezia popullore mbështeten edhe vjershat e Petko Slavejkov-it (1827-95). Këngëtari i lirisë Christo Botev (1848-76) vritet në luftë në moshë të re. Lëndë nacionale trajton novelisti Ljuben Karavelov (1837-79) si dhe shkrimtari rrëfenjës më kryesor i bullgarëve, Ivan Vazov (1850-1921). Besa ndaj truallit është karakteristike për literaturën bullgare. Ajo është një thellim, por njëkohësisht edhe një ngushtim i frymës letrare.

Grekët ndryshojnë nga kombet e tjera të Gadishullit ballkanik në këtë, që përlindja e tyre nacionale e kulturore në fillim të shekullit të kaluar u lidh direkt me helenët e vjetër. Me këtë ata bazohen në një traditë, dhe duhet të themi se kjo traditë ka qenë dobia dhe dëmi i tyre. Kur ranë grekët në luftë me turq, ata luftuan si të krishterë dhe si helenë, dhe për helenë i mori bota kulturore e Perëndimit kur u erdhi në ndihmë. Kështu ata fituan luftën e lirisë, në të cilën elementi shqip-tar i Greqisë duhet thënë se ka luajtur rolin kryesor. Kështu dalin në shesh dobitë politike që pati ky komb nga karakteri i tij helen. Ndryshe qëndron tani puna me anën kulturore të çështjes. Këtu trashëgimi i antikës u bë disi një pengesë, e kjo posaçërisht në çështjen e gjuhës. Si u themelua shteti grek më 1830, grekët iu vunë punës për t'i falur këtij shteti edhe një gjuhë. Kjo gjuhë qe: ishte gjuha popullore greke e cila është vazhuesja e natyrshme e Koinesë, gjuhës së përbashkët greke të kohës helenistike. Mirëpo kjo gjuhë u la mënjanë, sidomos prej qarqeve të kulturës. Këta si në lëmë historike ashtu dhe në të gjuhës donin të lidheshin te tradita helene, donin atikishten antike ta bënin gjuhë letrare moderne. Kështu kemi në Greqi që prej më se një shekulli një dygjuhësi, një diglosi. Lufta midis anëtarëve të së dy gjuhëve vazhdon që nga Korais (1748-1803), i cili qe për traditën atike, për Katheréusën, dhe që nga Jean Psichari, i cili u shpall më 1882 për gjuhën popullore, sadoqë në kohët e fundit vihet re një farë kompromi-

si ndërmjet të dy tendencave. Dihet se gjuha është instrumenti i poetit, prandaj shohim sesi kjo luftë gjuhe pati ndikimet e saj edhe në literaturë. Shkrimtarët që shkruajnë në gjuhë popullore kuptohen nga të gjithë. Veprat e shkruara në Katharéuusa janë përkundrazi privilegji i pakëve, midis tyre dhe shtresave të gjera të këndonjësve u krijua nevojisht një farë distance. Poetët nga koha e luftës së lirisë u entuziazmuan për burrat e kombit dhe për trimëritë e tyre. Edhe në Greqi na del tipi i këngëtarit dhe luftarit, të cilin e ndeshëm shpeshherë në Europë lindore, midis të tjerëve Konstantin Rigas prej Thesalie, të cilin e pushkatuan turqit më 1797. Këngët popullore greke, të cilat frymëzuan edhe Goethe-n, e shtynë Johannis Vilaráis-in (1771-1823) t'i imitojë. Si përfaqësues i thjeshtë i romantizmit grek duhet këqyrur Aristotelis Valaoritis (1824-79), i cili u ndez për poezinë që ka jeta e kleftëve, e hajdutëve të maleve grekë, shqiptarë e vllahë që luftuan për liri të Greqisë. Si te Vilaráis-i ashtu shohim dhe te ky poet ndikimin e poezisë popullore, por te ky ndeshim përveç kësaj edhe në gjurmët e Byron-it. Te poemë *Kyra Phrosyni* Valaoritis trajton një dramë që luhet në oborrin e Ali Pashës në Janinë. Jonasi Dionysios Solomos (1798-1857) shkruan rapsodinë *Lambros* në stil të Byron-it, të cilit i kushtoi edhe një ode. Romanin historik e themeloi Aleksandër Rangavis (1810-92). Po ta mbledhim shkurtas, do të shohim se romantizmi, siç u tha dhe më sipër, zhvilloi këtu si dhe në gjithë Europën lindore më fort anën nacionale sesa anën thjesht letrare. Për Greqi duhet shtuar në mënyrë të posaçme edhe shtjellimi i problemit të gjuhës, që mbetet i pazgjidhur gjer në ditë të sotme.

Te **Sllavët e Jugut** humanizmi dhe renaissanca të ardhura prej Italisë u bënë me rëndësi për arsye gjeografike, dhe «renaissanca dalmatine» u përmend në fillim të këtij artikulli. Reformacioni gjerman hyri në Slloveni dhe zgjoi këtu një literaturë të re. Po kundërreformacioni i Romës pushtoi në lëmën letrare krejt viset e bregdetit lindor të Adriatikut, me qëllim që të luftonte pjesërisht reformacionin, pjesërisht islamizmin që po u matej këtyre anëve. Romantizmi, i cili ndër sllavët e Jugut erdhi nga Gjermania, po edhe nëpërmes të literaturave sllave, të literaturës ruse më fort të literaturës polake e çeke, u lidh ngushtë te këta me poezinë popullore. Ai zgjoi këtu edhe një lëvizje politike të shënueshme.

Ndër **Serbë** Dositej Obradović (1744-1811) pat nisur edukimin e

kombit të tij që në kohë që rrymat romantike nuk kishin hyrë edhe në këtë vend. Në lëmë gjuhësore ai mbajti anën e gjuhës popullore. Sepse gjer atëhere si gjuhë shkrimi përdorej sllavishtja kishtare dhe kësaj i kishin dalë krah kleri dhe shtresat e kulturuar. Merita e plotësimit të dy detyrave, të punës kombëtare si dhe të gjuhës, i bie Vuk Karadžić-it (1787-1864). Ky u bë mburjtësi i gjuhës letrare serbokroate, zbuluesi i poezisë popullore serbe dhe me këto edukatori i vërtetë i kombit të tij. Si u shpërngul në Vjenë si emigrant politik, Vuku në këtë qytet, ku lëvizja romantike ishte atëhere në lulëzim e sipër, ndeshi në sllavistin sloven J. Kopitar si dhe në Jacob Grimm-in. I pari e drejtoi nga studimi i gjuhës, i dyti e shpuri te poezia popullore dhe te përralla. Me shtytjen e këtyre burrave Vuku iu përvesh gramatikës dhe fjalorit të gjuhës së tij amtare, të cilat, si punoi vite me radhë, i kreu. Themelor mbeti dhe rregullimi që i dha ortografisë, të cilën e caktoi një herë e mirë. Me këto vepra ky burrë gjenial bëri që gjuha popullore, që gjer atëhere përbezej si «gjuhë e lopçarëve», fitoi për gjithmonë përmbi sllavishten kishtare, dhe kështu ai i çeli shtegun literaturës. Kjo qe vepra nacionale e Vukut. Po ajo që e ngriti këtë në shkallën e literaturës europiane qenë këngët popullore serbe që mblodhi. Këto gjysmë shekulli më parë patën zgjuar admirimin e Herder-it, dhe Goethe-ja kur qe i ri përktheu në gjermanisht një sosh, që quhet *Vajtimi i gruas bujare të Hasan Agës*. Po tani, (1825,1826) zonjusha Talvj përktheu këngët e Vukut. Ky përkthim zgjoi interesimin e gjallë të Goethe-s, i cili në atë kohë ishte ndezur për këngën popullore përgjithësisht, dhe ky interesim e nxiti Vukun të mbledhë të tjera. Midis këngëve popullore të mbledhura prej tij u ndodhën edhe disa këngë shqiptare, të cilat i botoi Norbert Jokl⁴. — Eshtë një gjë për të vënë re se një dijetar, Vuku, qe ai që çeli ndër serbë lëvizjen romantike dhe përgjithësisht literaturën nacionale. Te poezia popullore që ai mblodhi u mbështet Sima Milutinović prej Bosnje në epin e tij heroik *Srbijanka*. Të njëjtin ndikim e shohim te princi malazes Petar II Petrović Njegoš (1813-51), poeti i njohur i epit *Kurora e malit*. Me Branko Radičević (1824-53), një imitues i Byron-it, dhe me poetin lirik Zmaj Jovan Jovanović (1833-1904) romantizmi zgjati në Serbi më shumë sesa në Perëndim, një gjë që e pamë në gjithë Europën e Juglindjes. Mesjetën serbe dhe luftën me turq i këndon Djura Jakšić. Një tjetër imitues i poezisë popullore është J. Nović. Përpijekjet politike të romantikëve serbë gjetën shprehjen e

tyre me shoqërinë «Omladina» (Djalëria), në vitet 1866-72.

Vepra më të plota dha romantizmi ndër Kroatë, te të cilët për arsye gjeografike hyri edhe më përpara se në Serbi. «Ilirizmi» i themeluar prej Ljudevit Gaj (1809-72) dhe prej kontit Janko Drašković deshi, sikundër dhe «Omladina» e serbëve dhe më parë se kjo, bashkimin kulturor e mundësisht edhe politik të të gjithë sllavëve të Jugut, duke përfshirë edhe bullgarët. Te poetët romantikë kroatë influenca e poezisë popullore që zbuloi Vuku u bashkua në mënyrë harmonike me ndikimet e romantizmit gjerman si dhe të romantizmit të polakëve dhe të çekëve. Stankó Vraz (1810-51), poeti kroat prej origjine sllovene, ndizet për poezinë popullore edhe mbledh këngë nga vendi i tij, Sllovenia. Ai si të gjithë romantikët entuziazmohet për Orient. Një episod nga konflikti i gjatë i popujve të krishterë me pushtuesit osmanë trajton poeti epik Ivan Mažuranić (1814-90) me veprën *Vdekja e Smail Agë Çengçit*. Të njëjtën temë, siç pamë, e pat punuar dy shekuj më përpara humanisti Ivan Gundulić, ndër bashkëkohësit e Mažuranić-it i këndoi këto luftra Petar Njegoš-i si dhe françeskani boshnjak Grga Martić (1822-1905), lidhjet e të cilit me Gjergj Fishtën i kam përmendur gjetiu. Ndër shqiptarët këtë periodë luftrash e këndojnë Girolamo de Rada dhe Naim Frashëri dhe sëfundi me fuqi epike Fishta. Kulmin e tij romantizmi kroat e arriti me poetin lirik Petar Preradovic (1818-72), tek i cili bota e kulturës perëndimore bashkohet me misticizmin nacional të sllavëve. Përveç literaturës rryma romantike pushtoi këtu edhe fusha të tjera të jetës kulturore. Lëvizjen politike të «Ilirizmit» e përmendëm. Gaj reformoi (1830-35) shkrimin latin të kroatëve, dhe me këtë kreu këtu një punë që i përngjan punës që bëri Vuku ndër serbë. Edhe në lëmë të shkencës lëvizja romantike dha në këtë vend pemë të qëndruara. Si historian shquhet Ivan Kukuliević. Më 1867 u themelua në Zagreb Akademia jugosllave e Shkencave.

Lëvizja romantike e Sllovenëveve shkon në shumë pika sëbashku me romantizmin e kroatëve, me të cilin e lidh i njëjti besim dhe i njëjti shkrim latin. Veçse më anë tjetër afërsia gjeografike me Itali dhe Austri dhe jeta politike e gjatë që pati Sllovenia nën këtë shtetin e fundit patën për pasojë që literatura sllovene është drejtuar shumë më fort nga Perëndimi sesa gjithë literaturat e tjera të Juglindjes së Europës. Këtë gjë e shohim që te romantiku i parë i sllovenëve, te France Presëren (1800-49), liriku më i madh i sllavëve të Jugut. Konflikti midis idealit

dhe realitetit, midis ëndrës dhe jetës gjen te ky poet një shprehje të vërtetë artistike. Dashuria për truallin e vet cilëson veprën e France Levstic-it (1831-87), i cili si poet romantik u mor edhe me politikë. Rrëfenjësi Josip Jurčič (1844-81) në veprat e tij u mbështet, si shumë të tjerë që përmendëm më lart, te Walter Scott-i. Gjurmët e Byron-it i gjejmë gjer te liriku modern Oton Zupančič (lindur më 1878). Si përfaqësues i nacionalizmit romantik duhet përmendur Jovan Vesel-Koseski. Romantizmi slloven përveç kësaj ka kryer punë të madhe edhe në lëmë të dijes. Le të përmendim Jernej (Bartolomé) Kopitar (1780-1844), i cili u bë një nga themeluesit e studimeve sllavistike. Ndikimin pëllor të tij te Vuk Karadžič-i e theksuam më sipër.

Kaq sa për romantizmin në viset e Europës së Lindjes e të Juglindjes. Nga sa u tha do të shihet, besojmë, se kjo rrymë për arsye gjeografike e kulturhistorike arriti më vonë në ato vise sesa në vendet e Perëndimit. Përveç kësaj në veprat që u shkruan nën këtë ndikim vërehet pak origjinaliteti, ato më të shumtën janë imitime modelesh të Europës perëndimore. Përgjithësisht shihet se literaturat sidomos të kombeve të vogla të Europës së Lindjes e të Juglindjes kanë më shumë një karakter receptiv, ato janë mbujtur në një farë mënyre me përkthimet që u bënë nga literaturat e Perëndimit. Pamë përveç këtyre se te kombet e Lindjes na shfaqet më fort funksioni nacional dhe etik i literaturës, te kombet e Perëndimit më fort ana artistike e saj. Tani ky funksion u krye tek ata mbasi kombet e Europës lindore e juglindore e arritën pavarësinë politike të tyre në një pjesë të madhe që në shekullin e kaluar. Kështu për literaturat e këtyre viseve dalin detyra të reja, rruga çelet për qëllime më të larta, të prira më fort nga arti i vërtetë. Le t'i hedhim tani një sy rrugës që mori romantizmi në literaturën shqiptare.

III.

Përmbi themelet etnografike-kulturhistorike, që vijnë në konsideratë për gjenezën e kësaj literature, d.m.th. përmbi popullin dhe poezinë e tij, kam folur gjetiu⁵ dhe si të tilla këqyra atëhere këto: gjeografia dhe karakteri i vendit; emri i popullit; fuqitë centrifugale në historinë dhe karakterin e popullit shqiptar; rryma centripetale të huaja; Shqipëria midis Perëndimit dhe Lindjes; fiset; karakteri konservativ i zonave malësore të anëve; njësia e kombit dhe shpirti i kombit; poezia popullore. Mbi këto çështje nuk dua të shtoj gjë këtu, po marr lejen ta shpie këndonjësin te kapitujt në fjalë. Një pikë tjetër që prej atëhere e tëhu më duket të jetë kryesore në lidhje me këto, është nevoja e një themelimi historik të literaturës. Përpara historisë së literaturës shqiptare duhet shkruar historia e Shqipërisë. Kjo duhet të jetë histori e vendit dhe e polemës dhe njëkohësisht një histori e jashtme dhe e brendshme. Me fjalë të tjera një histori e pushtuesve të huaj të vendit dhe një histori e shqiptarëve në qëndrimin që mbajtën me shoqi-shoqin përballë të huajve.

Pozita gjeografike në këtë pikë të Adriatikut e ka vulosur për gjithmonë fatin historik të këtij kombi, që bashkë me grekët është më i lash-ti i Gadishullit ballkanik. Shqiptarët janë stërnipët e atyre fiseve ilire, shumëfish të përziera me fise trake, të cilat nëpër ag të kohëve prehistorike zbritën prej viseve të Veriut të Europës dhe ngulën në këto troje. Po të krahasojmë truallin e banimit të ilirëve në kohët historike, të cilët mbanin krejt viset e Lindjes së Adriatikut gjer thellë në Hellas, me tokën ku shqiptarët flasin sot gjuhën e tyre, do të shohim se kjo tokë është një vend reduksioni: rezultati i erozionit e i thërmimit të ngadalshëm të zonave të anës. Ky proces është shkaktuar kryesisht nga ndikimet dhe nga pushtimet e popujve të huaj.

Greciteti e ka përshkuar Shqipërinë para së gjithave në lëmë të kulturës. Grekë dhe shqiptarë ndodhen që në kohët prehistorike në afërsi kontakti gjeografik të paprerë njëri me tjetrin dhe e kanë ndikuar njëri-tjetrin pareshtur, në të gjitha epokat e historisë. Në pikëpamje të kulturës pjesa dhënëse kanë qenë më fort grekët, në pikëpamje raciale më

fort shqiptarët. Ndikimi grek erdhi si nga toka si nga deti, nga kolonitë që themeluan sidomos helenët doras në brigjet e Adriatikut. Këto koloni u shtynë pak në terë, po megjithëkëtë ndikimi grek në oborret e princave ilirë si dhe në banesat e ilirëve të tokës brenda qe i madh, dhe këtë e shohim edhe te gjetjet arkeologjike. Në kohë të pastajme greçiteti u bë në Shqipëri edhe sundues politik: Siç dihet, ky vend gjatë gjithë kohës së Mesjetës qe me pak ndërprerje një provincë bizantine. Bizanti, te i cili bashkoheshin bota greke me botën orientale, ka lënë gjurmë të thella në Shqipëri si në tërë Ballkanin në të gjitha fushat e kulturës materiale dhe mendore. Rruga nëpër të cilën hynë elementet e kulturës mendore të Bizantit, si zakonet dhe besimet popullore, shkoj kryesisht nëpër kishën greke-bizantine. Hyrja e kësaj në Shqipëri i vishet përgjithësisht kohës bizantine të lashtë. Mirëpo për sa i takon anës gjuhësore të kësaj çështjeje, elementet greke në terminologjinë kishtarë të gjuhës shqipe na tregojnë nganjëherë një trajtë aq të moçme, sa më duket se ekziston mundësia që këto elemente kanë filluar të hyjnë që në kohën antike të vonë, në shekujt e parë të Krishtërit.

Romakët, mbasi u thye kundërshtimi i ilirëve, pushtuan të gjitha viset në lindje të Adriatikut dhe u dhanë fund për gjithmonë formimeve shtetërore nacionale. Dihet se sundimi i tyre zgjati disa shekuj me radhë, gjer në mbarim të kohës antike. Ai solli me vete një romanizim të fortë, sidomos në qytetet e bregdetit. Veçse në viset malësore të tokës brenda elementi anas (autokton) ruajti individualitetin e tij dhe gjuhën e tij dhe këto i kapërcyen të gjitha stuhitë e kohëve. Ky element edhe në qytetet e greqizuara edhe të romanizuara të bregut të detit nuk do të ketë munguar ndonjëherë kryekëput. Nga polemi jo i romanizuar i Ballkanit perëndimor u zhvillua kombi shqiptar, nga i romanizuari i Ballkanit qendror dhe lindor kombi rumun. Ç'sundime romane erdhën në Shqipëri mbas mbarimit të Perandorisë romake qe ose intermitent si sundimi i normanëve dhe i Anjou-ve ose, si Venediku, u kufizua duke ndjekur qëllime tregtare, anës bregut të detit. Më intensive dhe më e qëndruar qe një tjetër influencë e ardhur nga Italia dhe nga Dalmacia: feja katolike. Siç ka treguar Šufflay, në një monografi të shquar⁶, Shqipëria është vendi ku kisha romake dhe kisha greke kanë kryer luftën e gjatë midis tyre. Siç dihet, në këtë luftë asnjëra nga të dy palët nuk mbeti fituese, meqë kisha ortodokse zotëron vërtet një pjesë më të madhe të vendit se kisha katolike, po nuk mundi ta fshijë krejt këtë.

Sundimi i gotëve në Shqipëri, sadoqë pas Hahn-it zgjati 130 vjet, duhet të shikohet megjithëkëtë si një dukje kalimtare e provizore. Gjurmë të qëndruara la përkundrazi ngulja e sllavëve në Gadishull të Ballkanit. Ardhacakët e rinj u futën si një kunj ndërmjet rumunëve dhe shqiptarëve, dhe kjo pati për pasojë që kjo njësi u këput një herë e mirë. Sllavët, të cilët pas Sališčev-it zunë fushat dhe viset bregore, qenë një popullsi bujqish luftarë; prandaj sjellja e tyre ndaj popullsisë greke e romane të Gadishullit në fushën kulturore e religjioze qe nevojishtë më tepër marrëse. Lëmi ku ata luajtën një rol dhënës qe përkundrazi bujqësia si dhe anë të tjera të kulturës materiale, në Rumani — por më vonë — edhe lëma kulturore e religjioze. Në Shqipëri popullsia anase pas zakonisht të lashtë u tërhoq në malësira, për të rënë prapë, pas një kohe prej disa shekujsh, me fuqi të përtëritura në lugina, të cilat i shtinë prapë në dorë. Simbioza shqiptaro-sllave, e cila zgjati gjithë Mesjetën, mbërriti në mbarim të kësaj periode në këtë përfundim: shumë sllavë u shqiptarizuan në Shqipëri, shumë shqiptarë u sllavizuan, sidomos në viset periferike të Veriut. Ky procesi i fundit në veriperëndim të Shqipërisë ka vazhduar edhe në kohën e re.

Vazhden më të thellë në Gadishull ballkanik e ka lënë sundimi i osmanëve, sundim që zgjati pesë shekuj me radhë. Ndërsa sllavët erdhën e u ngulën si kolonistë, dhe romakët bashkuan sundimin politik me kolonizimin, sunduesit e rinj edhe nga shkaku i numrit të tyre të vogël, si shtresë zotërinjsh që ishin, synonin kryesisht pushtimin politik e administrativ të vendeve; ata me pak përjashtime nuk bënë politikë kolonizimi. Në këtë osmanët janë vijuesit e politikës bizantine. Ky sistem solli me vete që sundimi i pushtuesve të rinj u përqendrua kryesisht në qytete. Këtyre u ndihmoi të ruajnë dukjen e tyre mesjetare, u dha përveç kësaj atë pamje të veçantë gjysmëorientale e cila ka mbetur që atëhere karakteristike për qytetin e Gadishullit ballkanik. Sundimi osman dhe trajtat orientale të jetës prej qyteteve u përhapën vetëm dalëngadalë në katunde dhe nuk u bënë këtu aq intensive sa në qytete; kështu spjegohet pse Mirdita dhe Himara në Shqipëri, Maina në Morë mundën e ruajtën në kohën turke një farë pavarësie. Përgjithësisht do të themi se sundimi osman i ndikoi popujt e Gadishullit ballkanik në të gjitha trajtat e jetës: duke filluar nga arkitektura dhe nga mënyra e banimit, nga veshja, nga mbajtja e shtëpisë dhe kuzhina, gjer te jeta sociale dhe te jeta ushtarake, në doke e zakone, sidomos të lindjes, të martesës

dhe të vdekjes, në kozmetikë, në jetën intime të gruas dhe në supersticione; si edhe në lëmën e artit popullor, të muzikës dhe të mënyrës së të kënduarit, përgjithësisht në mbarë mënyrën e jetesës, gjer te mënyra e të menduarit dhe te kuptimi i botës. Siç po shohim, ky ndikim ka prekur të gjitha anët e jetës materiale dhe shpirtërore.

Sundimi i osmanëvet mori rëndësi edhe për arsye se këta qenë bartësit e një besimi të ri. Ky vërtet nuk u imponua asgjëkund nga shteti me pahir dhe sistematikisht, por megjithëkëtë përhapja e tij u lehtësua nga rrethanat. Fakti që të qenit anëtar i besimit të ri sillte dobira personale dhe çelte dyert e nëpunësive të shtetit, solli me vete që shumë anëtarë të popujve të krishterë të Ballkanit u kthyen vullnetarisht në fenë islame. Këta burra të kthyer muslimanë morën pjesë në jetën e shtetit dhe jo rrallë u ngjitën në shkallët më të larta të ushtrisë dhe të administratës civile. Në Ballkanin perëndimor dinarik besimi i ri përfshiu të gjitha viset që nga Bosnja e gjer në Shqipëri. Këto janë edhe vendet që i dhanë Perandorisë ushtarë dhe gjeneralë të zotë si dhe burra shteti të fuqishëm. Pas një përmbledhjeje që ka bërë H. Gelsler, në periodën e shkëlqimit të Perandorisë osmane në vitet 1453-1623 nga 48 vezirë të mëdhenj vetëm 5 qenë turq të thjeshtë, njëri qe çerkez nga Kaukazi, 10 ishin origjine të panjohur, të 33 të tjerët ishin renegatë, e nga këta 6 qenë grekë, nga 11 qenë shqiptarë dhe sllavë të Jugut, një qe italian, një armen dhe një gjeorgjian.⁷

Ç'qëndrim mbajtën kombet e Ballkanit ndaj osmanëvet?⁸ Përgjithësisht është pranuar mendimi se popujt që i mbetën besnikë fesë kristiane kanë rojtur në kontrast të përhershëm me sunduesin e ri, kurse përkundrazi kombet që ndërruan fenë e u bënë muhamedanë mbajtën anën e pushtuesit dhe u bënë mbështetësit e tij në Gadishull. Ky mendim, po ta vështrojmë më së afërmi është i vërtetë vetëm më një farë pike. Kombet kristiane të Ballkanit pas konfliktit që patën në ballë gjetën një farë pajtimi me pushtuesin. Sidomos kisha greke u favorizua që në të parë dhe diji ta ruajë këtë pozitë të privilegjuar gjithë kohën sa zgjati pushteti osman. Përsa u takon popujve të islamizuar të Ballkanit perëndimor, është e vërtetë, siç u tha dhe më sipër, që këta morën pjesë më të gjallë në jetën e shtetit sesa vëllezërit e tyre të krishterë. Mirëpo nga një vështrim më i imtë del se kjo vepër u dha dorë më fort individëve ose dhe grupeve. Popujt nuk patën ndonjë dobi soje. Shqipëria që në pjesën më të madhe qe muhamedane dhe bijtë e së cilës arritën ven-

det më të larta të qeverimit, ka qenë përhera një nga provincat më të paqeta të Perandorisë, mbi të cilën grushti i pushtuesit ka qenë posaçërisht i rëndë. Nga kjo shohim se islamizimi nuk u solli ndonjë dobi të vërtetë as kombeve që kthyen fenë as Perandorisë vetë: të parëve, sepse nga të qenit anëtarë të fesë perandorake nuk qitën ndonjë dobi nacionale; Perandorisë, sepse me gjithë besimin e përbashkët nuk i bëri dot për vete ato kombe. Përsa i takon posaçërisht Shqipërisë, nga shkaqet që u prekën më lart dhe nga karakteri i banorëve pozita e saj ndaj Perandorisë ka qenë krejt e veçantë. Ndodhemi këtu përpara fenomenit të çuditshëm që kryengritjet e bijve të saj shkaktonin te Porta gjithmonë deluzion dhe zemërim, bash sepse këto kryengritje vinin nga një polem me shumicë muhamedane, prej të cilit pritej besnikëri ndaj shtetit. Shqiptarët vetë nga ana e tyre nuk i ndalonte feja perandorake që kishin që të çonin herë pas here flamurin e kryengritjes. Në këtë mënyrë fryma e ngritjes krye që e ndezi Gjergj Kastriotin në fillim të kohës turke vazhdoi në këtë vend me fuqi të pathyer për gjithë kohën e sundimit osman: «Por luftëtarët e vërtetë të lirive qenë, siç pamë, shqiptarët, te të cilët këto edhe pas shtrimit të tyre nuk u shuan as edhe nën shtypjen më të rëndë»⁹.

Në shekullin XIX idetë e lirisë, që me Revolucionin frëng dhe me luftrat e Napoleonit u zgjuan në gjithë Europë, mbërritën edhe në Shqipëri, në këtë çip të mënjanë të Europës juglindore. Edhe këtu doli një brez i ri poetësh edhe shkrimtarësh të cilët, pas disa shekujsh apatie nacionale dhe pas shkrimeve liturgjike të mëpara, nën shtytjen e lëvizjes romantike çelën një literaturë nacionale. Këtij brezi, ashtu siç ndodhi në gjithë Europën e Juglindjes dhe në kuptimin që përmendëm më lart, i ra përsipër një detyrë e shumëfishtë: të dalin përpara si poetë dhe si patriotë, të shpallin idenë e lirisë nacionale dhe të bëhen me shkrimet e tyre edukatorët e kombit. Qëllimi që ky: të përtërihet gjithësia e nationit, duke filluar që nga alfabeti e gjer te mbujtja e një gjuhe letrare dhe te formimi i një literature të vet, në lëmë politike krijimi i një shteti. Kjo vepëri njëkohësisht letrare dhe kombëtare përqendrohet në shekullin XIX te dy burra: Girolamo de Rada në Itali (1814-1903), Naim Frashëri në vendin mëmë (1846-1900).

V. Gualtieri-t¹⁰ i takon merita se që i pari që njohu karakterin romantik të poezisë së De Radës dhe se e vërtetoi këtë me argumente të imta. Në lidhje me këtë unë vetë në librin e mësimimit «Elemente të

gjuhësisë e të literaturës shqipe» 37 v. me shkurtësinë që e lypte natyra e këtij libri kam folur mbi disa tipare romantike të këtij poeti. Këto tipare tani dua t'i shikoj më për së afri, duke plotësuar kështu thëniet e Gualtieri-t dhe të miat vetë.

Shqiptarët që u shkulën për në Itali që nga koha kur u pushtua Shqipëria nga osmanët, tek të cilët shtegtuan pak më vonë shumë të tjerë të ikur nga Greqia, sidomos nga Morea, sollën me vete një visar të pasur poezie popullore, e cila mundi të kapërcejë shekujt. Kjo poezi është një dokument interesant i jetës mesjetare të Shqipërisë, më saktë i jetës paraturke-bizantine dhe i jetës turke të parë; është poezia popullore shqiptare më e vjetër që mund të datohet. Këto këngë janë edhe sot të gjalla te këta kolonistë. Sëbashku me jetën në katund, në ara e livadhe, me veshjet e grave, me skenat idilike ndanë kroit këto këngë përbëjnë atë magji të posaçme së cilës asnjëri nga ata që kanë vizituar këto ngulime nuk ka mundur t'i shpëtojë. De Rada rrojti dhe u rrit në këtë mjedis, koloriti etnik i të cilit në shekullin e kaluar ruhej shumë më mirë sesa në kohën e sotme të makinës. Ai që në të ri mblodhi këngët popullore të moçme dhe i botoi më 1866 bashkë me Niccolò Jenò de' Coronei. Titulli që ka kjo mbledhje cilëson mirë mendimin që pat formuar poeti përmbi gjenezën e këtyre këngëve: ai është *Rapsodie d'un poema albanese*. Sipas këtij titulli de Rada, siç thotë ai vetë¹¹, mendonte se këto këngë na paraqesin gjymtyrë të mbetura të një epi popullor nga koha e Skënderbeut, i cili si i tillë u pat bjerrë. Sidoqoftë de Rada e jetoj si artist këtë poezi. Poezitë e tij ngjajnë sikur të ishin një vazhdim i kësaj poezie popullore, një plotësim, një mbushje e plasave që ky epos (siç e besonte ai për këto këngë) paraqiste pas mendimit të tij. Po t'i krahasojmë të dy poezitë njëri me tjetrën, na bie në sy gjasia e tyre formale: në të dyja shohim të njëjtin ritëm, janë të njëjtat vargje tetë-, shtatë-, gjashtë- dhe pesërrokëshe, të dy poezitë i përshkon e njëjta frymë epike-lirike; në të dyja kallëzimi epik kalon nganjëherë në dialog dramatik, një dukje kjo që është karakteristike për poezinë popullore shqiptare. Edhe figurat e krahasimet që përdor poeti janë sajuar në frymë të poezisë popullore.

Romantike janë te de Rada si mbështetja te poezia popullore ashtu dhe dy tipare të tjera: thellimi në të kaluarën e kombit dhe lavdërimi i Mesjetës. Sikundër që poezia popullore italo-shqiptare ka për objekt kohën paraturke dhe kohën e parë turke, pra kohën rreth Skënderbeut,

kështu poeti e ngjall dhe e mbush këtë kohë me figura historike dhe të shpikura, me burra edhe gra nga dyert e para të kësaj kohe heroike të Shqipërisë. Këtu histori e poezi bashkohen në një tërësi harmonike, të para me sytë e një romantiku, i cili, një stërnip të ikurish, shihte te kjo epokë historike kohën e lumturisë së kombit. Veprat e de Radës kanë ruajtur në frymë thjesht romantike koloritin etnografik. Ato janë pasqyra besnike dhe e lartësuar në sferën e poezisë e jetës shqiptare me zakonet e saj: skenat ndanë kroit në katund, gratë që mbledhin kallëzat në ara duke kënduar, burri që vete në luftë dhe gruaja që i qëndis brezin atij dhe tund djalin në djep.

Dihet roli i rëndësishëm që ka luajtur gruaja në jetën e romantikëve dhe në poezinë e tyre. Edhe në këtë de Rada është pjella e thjeshtë e romantizmit. Ai është i pari këngëtar i shpirtit të gruas në literaturë shqiptare. Figurat e tij femërore, që nga bujaresha Serafina Topia gjer te vasha fshatare e thjeshtë, te e bija e Kologresë në veprën e risisë *Milosaat*, janë vizatuar mbase më mirë në veprat e tij sesa figurat e burrave. Kjo i përshtatet përgjithësisht karakterit të poezisë së tij, e cila edhe në veprat epike e dramatike është kryesisht poezi lirike.

Me këtë mbërrimje te një tipar tjetër romantik i këtij poeti, te subjektiviteti i tij. Siç thekson Gualtieri, veprat e de Radës kanë karakter autobiografik. Figurat e burrave në poezitë e tij janë projekte poetike të unë-s së poetit; figurat femërore janë në themel gratë që poeti pat dashur në djalëri, të lartësuar në atmosferën poetike. Ndodhitë që përshkruhen e kanë rrënjën e fundit te ato që pat jetuar shpirtërisht poeti. Kjo natyrisht ndodh pak a shumë me çdo poet; veçse ç'është këtu trajtë romantike është subjektiviteti edhe në paraqitje, pamundësia e poetit të ngrihet në sferën objektive. Si janë vizatuar këto figura? Ashtu siç qe autori i tyre vetë dhe siç nuk mund të pritët ndryshe nga një romantik; asnjë paraqitje realiste njerëzish me mish e eshtra. Përkundrazi, heronj krejt romantikë, të cilët, burra a gra qofshin, e shkojnë jetën si ëndërrimtarë. Ata rrojnë në kontrast me botën e ashpër dhe thyhen te ky kontrast. Në këtë poeti i mbeti besnik vetvetes. Edhe në vizatimin e këtyre figurave de Rada na del një pjellë e vërtetë e shkollës romantike. Karakteret janë cilësuar errët e me pak vija. Poeti është larg nga të paraqiturit heronjtë me konture të caktuara mirë.

Pesimizmin që sollën romantikët në literaturë e ndeshim edhe në poezitë e de Radës. Kalimi i shpejtë i lumturisë, renoncimi i hidhët janë

nota kryesore që i përshkon të gjitha. Fatet që pati poeti vetë në jetë ia shtuan këtë dispozicion të shpirtit të tij dhe i dhanë bazën reale. Besimi i fatit, i cili nuk e lë njeriun të gëzojë lumturinë mbi tokë. Veprimi i fuqive më të larta në ngjarjet e kësaj bote dhe në jetën e individit. Si romantik i thjeshtë që ishte poeti që natyrë thellësisht religjioze. Si djalë i një prifti ortodoks-unit ai u edukua me frymë fetare. Kjo ndjenjë shpërthen në veprat e tij. Ai u jep këtyre atë seriozitet etik i cili është shenja e artistit të vërtetë. Një ndjenjë tjetër që e ngjallën rishtas romantikët që prej Rousseau-it është ndjenja e natyrës. Kjo shprehet te de Rada kudo, veçse, sikundër dhe ndjenja religjioze, me atë diskrecion që është një veçori e këtij poeti. Si djalë fshatari ky që në moshë të njomë rronte në natyrë: arat e fushat e katundit të tij, vreshtat edhe malet me borë, valët e detit Jonik të afërm ai i derdhi me thjeshtësi tërheqëse në poezi të tij.

Dihet se entuziazmi për kohë të largëta dhe për vise të largëta i shquan romantikët nga të tjerët; ndër vende është dashuria për Spanjë e sidomos për Orient. Te de Rada janë gjetur gjer tani çfarëdo gjurmësh të botës antike, dhe kjo i përshtatet kulturës klasike që pat fituar: midis të tjerave është pëllumbi i Afërditës, të cilin e patën kënduar Anakreonti dhe më vonë Properci. Mirëpo këtu dua të përmend që edhe Orienti ka lënë vragën e tij në veprën e këtij romantiku. Pikësëpari përshkrimi i lufrave të shqiptarëve me osmanë i ngarkoi shkrimtarit barrën të sjellë mbi skenën poetike luftarë turq dhe gra turke si dhe përgjithësisht kondita të jetës orientale. Po te de Rada kam ndeshur edhe në ndikime letrare e këto janë disa gjurmë të poezisë hinde. Motivin e këqyrjes së një pikturë, e cila paraqet Anmaria Kominiaten nga ana e së motrës Delia dhe të bijës së vogël të kësaj Adine te novela poetike *Nata e Kërshëndellave (La Notte di Natale)* e veprës *l'Albania dal 1460 al 1485* e gjejmë te drama e njohur *Sakuntala* e Kalidasës; këtu mbreti Dushanta vë re një pikturë e cila paraqet Sakuntalën me dy shoqe të saj. Një tjetër remineshencë hinde e de Radës në emër si dhe në motiv është princesha muhamedane Vantisana, e cila te libri i pestë i epit *Scanderbekku i pafaan* e gjen prapë të dashurin e saj. Modelin e gjejmë te drama *Mrhakatika* e vjershëtorit Dandin, një bashkëkohësi të Kalidasës (shekulli VI pas Krishtit). Në këtë dramë duhet t'i pritët kryet brahmanit Çarudata dhe për këtë shkak e shoqja Savantasena do ajo vetë të digjet e gjallë mbi turrën e druve; po trimë-

resha liron së pari të shoqin dhe ky shpëton atë me fëmijën nga flakët. Siç shihet emri i heroinës : Savantasena – Vantisana ka pësuar vetëm një ndërrim të vogël, dhe motivin e djegies së një gruaje përmbi turrë të druve de Rada e ka sjellë te Evoda, e cila pëson këtë vdekje te epi *Uno specchio d'umano transito*¹². Një tjetër emër gruaje prej hindi është Davadasa e cila në këngën e gjashtë e të tetën të *Serafina Topisë* luan një rol të afërt me rolin e Vantisanes te *Skanderbekku i pafaan*. Edhe një tjetër emër, Urana, tingëllon si emër hindas.

Poezia e de Radës edhe në pikëpamje formale bën pjesë në romantizëm. Në këtë mënyrë sajimi i përjashtëm i lëndës është i tillë që në vend të një ndërtese të mbaruar e të plotë na shtrohen përpara disa pamje të veçuara njëra pranë tjetrës, të cilat poeti i krijoi në hovin e parë. Kështu filli i veprimt poetik ka dalë me shumë plasa; përpjekjet që bëri disa herë autori për t'i arnuar këto pamje njëra me tjetrën duket qartas se janë bërë nën shtrëngimin e kombinacionit logjik. Edhe në këtë pikë këto vjersha u përngjajnë këngëve popullore që mblodhi de Rada. Sikundër secila nga këto qëndron më vete dhe nuk është vazhdimi i tjetrës, kështu edhe këngët e veprave të poetit, të radhitura njëra ngjatë tjetrës, tjetër nuk janë veçse *Rapsodie d'un poema albanese*.

Këto janë në përgjithësi tiparet romantike në veprën e de Radës. Po ky qe edhe patriot dhe si mis i një kombi të vogël e të robëruar e ndjeu veten të zgjedhur të punojë edhe në këtë fushë me tërë fuqitë e tij. Poeti si për poezinë popullore u ndez edhe për gjuhë, për dialektet shqiptare të Italisë të shkëputura qëmoti nga trunghi mëmë. Më 1895 u mblodh Kongresi i parë gjuhësor i italo-shqiptarëve në Corigliano Calabro, më 1897 i dyti në Lungro, të dy në Kalabri; këto qenë të dy njëkohësisht kongrese nacionale-politike dhe de Rada mund të konsiderohet iniciatori i të dyjave. Më 1870 i biri i tij Giuseppe botoi një gramatikë shqipe, në të cilën bashkëpunoi poeti. Përveç kësaj de Rada ka punuar edhe si publicist. Ai me *L'Albanese d'Italia* (1848) është botuesi i së parës fletore shqiptare. Në vitet 1883-87 botoi fletoren letrare-politike *Fiamuri i Arbërit* dhe kjo u bë një flamur i vërtetë i ideve kombëtare. Ajo e bëri çështjen shqiptare të njohur në viset më të ndryshme të Europës dhe fitoi miq për të. Merita e poetit duhet çmuar aq më lart kur të mendojmë që vepëria e tij letrare dhe nacional-politike fillon që nga mesi i shekullit XIX: në një kohë kur në Shqipëri dhe shumica edhe në kolonitë shqiptare në Sofje, Bukuresht, Stamboll dhe Egjipt të

tjerët ishin ende në gjumë. G. de Rada që burrë i pjekur kur filluan të ndihen të rinjtë e këtyre kolonive; dhe burrë plak, kur ky brez u rritën e u bënë burra. Këtyre u dëftoi rrugën që prej së largu: gjersa në mëngjesin e 28 frorit 1903 vdekja e shpëtoi poetin plak nga varfëria më e zezë.

Kolonitë shqiptare të Italisë, kontributi i të cilave në literaturën shqiptare është i rëndësishëm, i kanë dhënë kësaj edhe romantikë të tjerë: Giuseppe Seremben në Kalabri, Gabriele Darën dhe Giuseppe Schirò-në në Siqeli.

G. Serembe (1843-91) që një njeri që merrej vetëm me vete të tij dhe me vuajtjet e tij, pra një romantik në kuptimin europian të Perëndimit. I përcjellë nga një shqetësim dhe një melankoli e pareshtur, poeti shtegtonte nëpër ngulimet (kolonitë) shqiptare të Kalabrisë e të Siqelisë. Në rreth të miqve e kish për zakon të këndonte vjershat e tij të sajuara spontanisht. Ai ishte aq larg nga realiteti, sa shpeshherë nuk kujdesej t'i shkruante këto. Kësaj pune i përvisheshin shumë herë miqtë e tij, dhe këta shpëtuan kështu vjershat për brezat e përtardhme. Veçse shumë sosh mbetën pa shkruar fare. Kështu disa vepra kanë humbur për ne, dhe na ka mbetur vetëm një ble i vogël vjershash. Kuptohet vetvetiu që një shpirt i tillë zë në literaturën shqiptare një vend fare të ndryshëm nga bashkëkohësi i tij de Rada. Poezisë popullore nuk ia shohim gjurmën. Pastaj te ky poet i larguar nga bota reale nuk kish vend për një vepër të nacionale si te de Rada. Serembe që i kthyer tepër në vetvete; malli romantik i së largëtës e pushtoi fund e krye. I shtyrë prej tij ai bëri një udhëtim në Brazil, po edhe këtu nuk e gjeti qetësinë. Mendja e tij e tronditur ra në skizofreni dhe Serembe mbaroi në Brazil në moshë akoma të re në terrin e marrëzisë.

Si kolonitë e Kalabrisë, edhe të Siqelisë kanë të shënojnë një kontribut të mirë në literaturën shqiptare, kurse ngulimet e Abrucit e të Molises dhe ato të Apulisë, të cilat tani janë rudhur në një katund të vetëm, nuk kanë nxjerrë ndonjë poet për të shënuar. Seminari italo-shqiptar i Palermos, i themeluar nga peshkopi Giorgio Guzzetta më 1734, u bë një qendër kulture nacionale ashtu si kolegji S. Adriano në Kalabri, i cili selinë e tij e pati mëfund në Shën Mitër (San Demetrio Corone) afër Kozencës. Nuk është vendi këtu të përmendim rreshtin e gjatë të atyre burrave që qenë nxënës të seminarit të Palermos. Le të shënojmë Niccolo Chetta-n, i cili shkroi një histori të kolonive të Siqelisë. Dhimitër Camarda botoi më 1864 *Gramatologjinë e shqipes*,

me të cilën u bë një nga themeluesit e albanistikës. Nxënës i këtij seminari qe edhe një poet romantik: Gabriele Dara.

Gabriele Dara (1826-85) është autori i poemit *Kënka e sprasme e Balës*. Heroi kryesor i kësaj është Bala, një trim i lashtë në kohët e luftave të Skënderbeut me turq. Pas vdekjes së këtij shkulet me të tjerët bashkë për në Itali. Mirëpo këtu në atdhe të ri trimi plak i vrazhdë mbetet i huaj. I paqetë bredh nëpër malet e Sigelisë dhe mendja i vete me mall te atdheu i vjetër dhe te miqtë e vjetër që la andej detit. Me ëndje i rrëfen vashës së re veprat, «të bëmat» që kryen atje të parët, dhe këto rrëfime përbëjnë përmbajtjen e këngëve të ndryshme të poemit. Po ta krahasojmë këtë me veprat e de Radës, na del parasysh gjasia e tyre e brendshme. Ajo që i bashkon këto të dyja janë këngët epike të moçme të italo-shqiptarëve, ndikimi i së cilave është i fortë në të dy këta poetë. Sikundërse te de Rada — dhe më shumë se te ky — ashtu edhe te Dara nuk mund të dallohet se ç'është pronë e poezisë popullore dhe ç'është prona e poetit, gjer ku vete huajtja nga ajo e para dhe stilizimi i saj dhe gjer ku mbërrin krijimi i poetit vetë. Si te de Rada ashtu dhe te Dara metrika është e mbështetur te këngët e moçme italo-shqiptare. Siç pamë tek ai, ashtu dhe te ky lidhja që kanë këngët e poemit midis tyre është lidhje e lirë dhe e zgjidhur, edhe kjo, siç e dimë, në përshatje të plotë me frymën e poezisë popullore. Sepse këngët e kësaj nuk përbëjnë, siç besonte de Rada, një cikël (qerthull) të thurur, po secila nga këto këngë qëndron më vete. Një lidhje ndërmjet tyre ka vetëm në këtë kuptim, që të gjitha këto këngë popullore të vjetra këndojnë të njëjtën kohë, gjejmë në to të njëjtat figura më shumë a më pak historike, dhe më shumë, sepse këto këngë i përshkon e njëjta frymë poetike. E njëjta lidhje e brendshme i bashkon midis tyre këngët e veprave të de Radës njëren me tjetrën, dhe po kjo gjë ngjet me këngët e poemit të Darës. Veçse te Dara bie dhe një gjë tjetër në sy: këtu shpirti i baladave historike të moçme të shqiptarëve të Italisë është bashkuar me një tjetër frymë poetike: bota skoceze e *Ossianit*, më duket se na paraqitet, siç pa i pari G. Schirò, te kjo vepër. Mos është vallë afërsia e qëndrimit mendor të keltëve dhe të shqiptarëve ajo që lehtëson hyrjen e kësaj poezie te poezia e Darës? Kjo çështje duhet të mbetet e hapët. Sidoqoftë, figurat e Darës më duket se lëvizin në atë të njëjtën atmosferë heroike që krijoi vepra e Macpherson-it në Europë. Poezia popullore dhe *Ossiani* i vunë vulën romantike *Kënkës së sprasme të Balës*.

Romantiku i fundit dhe dora-dorës i fundit poet i shqiptarëve të Italisë është Giuseppe Schirò (1865-1927). Romantizmi i tij fillon me përpjekjen që bëri për të shpërthyer caqet e ngushta të dialektit të tij dhe të përdorë një farë koinéje, e cila mori edhe elemente nga gjuha e Shqipërisë. Schiròi mblodhi që në të ri këngë popullore e përralla, të cilat pjesërisht i botoi folkloristi siqelian Giuseppe Pitrè. Kulmin e punës në këtë drejtim e arriti me veprën monumentale *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, me të cilën ai u ngrehu këtyre kolonive një përmendore të pavidrë. Pema e këtyre studimeve të poezisë popullore që vepra e tij e parë *Rapsodie Albanesi*. Poeti u shtir sikur këngët e kësaj vepre t'i kish ndier nga goja e popullit. Dhe me të vërtetë ai në këto këngë e paskësh goditur aq mirë tonin e këngëve popullore italo-shqiptare, sa shumë ranë brenda në këtë trik të patëkeq të Macpherson-it shqiptar. Këtu mund të studiohet te një rasë konkrete gjeneza e çdo poezie popullore; mund të shihet sesi zhduken caqet ndërmjet këngës popullore dhe poezisë së artit, sesi kënga popullore sëfundi i detyrohet një poeti, emri i të cilit më të shumtën humbet e shuhet. — Idili romantik *Mili e Haidhia* është pendant i *Milosaat* të de Radës, në këtë mënyrë që Schiròi deshi të shprehë për Siqeli atë situacion poetik që pat sajuar de Rada për kolonitë shqiptare të Kalabrisë. Kemi edhe remineshenca të Darës, si p.sh. plakun Dodo që të kujton Balën. Megjithëkëtë ky poem i Schiròit me përshkrimin e gjallë të jetës së katundit shqiptar në Siqeli, me paraqitjen e një idili dashuror në mes të kësaj jete, me skenat e kroit, me mallin që shpreh për atdheun e lashtë të stërgjyshërvet, është bashkë me *Milosaat* dhe *Kënkën e sprasme të Balës* një nga pemët më të bukura të romantizmit shqiptar. Vepra e fundit e poetit dhe vepra e jetës së tij është poemi *Te dheu i huaj*, botuar pas vdekjes. Ky mund të thuhet se është në një farë mënyre epi nacional i shqiptarëve të Italisë. Poemi fillon në frymë thjesht romantike me përshkrimin e shkulljes nga atdheu, me zbritjen dhe me nguljen në dhe të huaj dhe me jetën që zhvillohet në rrymën e brezave në atdhe të ri. Gojëdhënën e kalasë së Shkodrës, pas së cilës u muros e gjallë një grua, poeti e shpie në kohët e lashta ilire; edhe episodet nga historia e pastajme e Shqipërisë kanë gjetur këtu këngëtarin e tyre.

Ky është në përgjithësi romantizmi shqiptar që lindi në Itali. Ato tipare romantike që gjejmë më sipër te de Rada, i ndeshim ku më shumë, ku më pak, edhe te të tjerët. Me përjashtim të Serembes të

gjithë këta rrinë në hije të poezisë popullore; të gjithë madhërojnë poetikisht kohën e parë të vendit nga i cili u shpërngulën stërgjyshët e tyre. Si romantikë të thjeshtë që janë, ata janë të gjithë poetë subjektivë, në mënyrë që figurat e krijuara prej sish janë në themel pasqyra e unë-s së tyre. Këto figura vetë përgjithësisht nuk i përshtaten dot botës, po, të ndjekura nga fati kombëtar ose nga ndonjë fat tjetër, ose të shtyra nga demoni i tyre vetë, ato vdiren në jetë: pesimizmi i përshkon të gjitha këto vepra. Edhe vetë jeta në këto koloni plot me tradita të përmallshme, të themeluara në një mjedis të huaj e larg nga vendi i të parëve, i shtyn këta poetë edhe më fort në rrugën e pesimizmit romantik. Ndjenja e natyrës së Italisë jugore, përshkrimi i jetës së katundit shqiptar që ndodhet në këtë vend u jep këtyre veprave tërheqjen e veçantë të tyre.

Tani në fund le t'i hedhim një sy romantizmit në Shqipëri, të cilin e përfaqëson kryesisht Naim Frashëri.

Ky poet është bashkëkohës i italo-shqiptarëve që përmendëm më sipër; ai shkruan të njëjtën gjuhë me ata dhe që në letërkëmbim me de Radën. Megjithatë është krejt një jetë tjetër ajo në të cilën ai jeton dhe na shpie edhe ne. Poezia italo-shqiptare është lëndë ballkanike e derdhur në formë romane, autorët e saj janë të drejtuar në themel nga Perëndimi. Në kundërshtim me këta Naimi është poet ballkanik i thjeshtë dhe si i këtillë është një natyrë gjysmë-orientale.

Ndryshimi që shkon ndërmjet atyre poetëve dhe këtij i ka bazat në rrethana gjeografike dhe historike. Në pikëpamje gjeografike pozita e ndërmjeme e Shqipërisë midis Perëndimit dhe Lindjes jo vetëm ka caktuar rrugën e historisë dhe ka ndikuar në ndarjen e feve: ajo i ka dhënë drejtimin edhe literaturës. Bota romake-katolike dhe bota bizantine kryqëzohen këtu edhe në fushën letrare, herë duke ngadhnyer njëra mbi tjetrën, herë duke jetuar të dyja njëkohësisht dhe paralel njëra me tjetrën; por më shumë duke u shkrirë në një njësi bashkë me lëndën anase të vendit. Në pikëpamje historike sundimi osman gati nuk i preku asfare shqiptarët që u shkullën për në Itali, dhe këtë e shohim edhe në poezinë e tyre popullore dhe artistike: sepse elementin oriental e gjejmë te këto vetëm si lëndë, po jo si frymë. Kurse në Shqipëri vetë ky sundim, siç u tha më sipër, ka lënë gjurmë të thella. Naimi doli nga ky mjedis. Sundimi i gjatë turk bëri që ndikime perëndimore dhe lindore janë bashkuar te ky poet. Përveç kësaj ky sundim i vuri këtij vulën e

një romantiku të Europës juglindore në kuptimin e përmendur më sipër.

Kur themi se Naim Frashëri është pjella e vonë e romantizmit na del pyetja: me ç'anë mbërriti tek ai kjo poezi? Në shekullin e kaluar në Greqi si dhe në Turqi e në të gjithë Levanten sundonte fryma frënge. Qytetërimi frëng, gjuha e literatura frënge ishin shumë më të forta në këto vise sesa ndikimi gjerman, italian, ose anglez (ndryshe nga vendet sllave, në të cilat influenca e kulturës gjermane ka qenë e paprerë që në kohë më të para). Fryma frënge në këto vise që përfaqësuese e kulturës europiane. Ndikimi i saj u shtua edhe nga fakti se kjo frymë që ajo që u solli këtyre popujve idetë e Kryengritjes frënge edhe idenë e lirisë përgjithësisht si dhe nacionalizmin modern. Naimi kaloi moshën e burrërisë në Stamboll, ku edhe vdiq. Ai ishte njohës i mirë i gjuhës dhe i literaturës frënge, dhe Voltaire-in e Rousseau-in i lavdëron te *Istori e Skënderbeut* si lajmësit e ideve të reja. Në këto rrethana ka të gjarë pra që poeti shqiptar rrymën e re letrare ta ketë njohur nëpërmes të romantizmit frëng.¹³ Një indic për këtë mendim e gjejmë te fakti se poezia popullore nuk luan asnjë rol te ky shkrimtar. Kurse siç pamë më lart, romantizmi ndër vendet lindore të Europës e sidomos në viset sllave, kryesisht ndën nxitjen e Herder-it dhe të romantizmit gjerman, e nisi fillin e tij te poezia popullore; te romantizmi turk edhe grek nuk i gjejmë më aq të forta gjurmët e kësaj poezie. E njëjta gjë ngjet me romantizmin shqiptar të Naimit. Shkaku duhet kërkuar në këtë, se si romantizmi turk e grek si romantizmi i Naimit janë pjella e Francës. Se, siç pamë më sipër, në këtë vend si dhe në viset e tjera latine lëvrimi i poezisë popullore nuk i detyrohet romantizmit, por një kohe më të pastajme; ndryshe nga vendet gjermanike, ku interesi për poezinë popullore zgjohet përpara lindjes së romantizmit, dhe ndryshe nga vendet sllave, në të cilat poezia popullore dhe poezia romantike shkrihen me njëra-tjetrën si në pikëpamje të kohës ashtu dhe të përmbajtjes. Në këtë pikë Naimi ndryshon krejt nga poetët italo-shqiptarë si dhe nga Fishta, se edhe te ky është i fortë ndikimi i poezisë popullore. Gjurmët e poezisë popullore që ndeshim te Naimi janë fare të imta: ndonjë mënyrë të thëni popullore, imitimi i stilit të përrallave në një vend të *Qerbelasë* (kënga VIII, f.87); te *Istori e Skënderbeut* (kënga XIX, f.279) na dalin një herë orët, ato figura vashash të mitologjisë popullore të cilat te Fishta lozin një rol aq të rëndësishëm. Në një tjetër vend të këtij poemi

(kënga VII, f.110) na shfaqet figura përrallore e së bukurës së dheut, dhe duhet shënuar se na shfaqet në atë rol epik si prijëse e heroit, i cili rol te Fishta i përket zanës, në poezinë popullore të sllavëve jugorë vilës. — Shihet përgjithësisht se poezia popullore nuk pati ndonjë pjesë në zgjimin nacional të Shqipërisë në shekullin XIX, siç ndodhi p.sh. me kroatë e me serbë. *Bleta Shqipëtare* e Thimi Mitkos duket se nuk ushtrroi ndonjë influencë të bashkëkohësit. Në Shqipëri në kohë të Naimit nuk kishte lindur edhe interesi për poezinë popullore.

Si duhet rreshtuar poeti në pikëpamje letrare? Naimi hyn në romantizmin e Europës juglindore. Ai si i tillë para së gjithash është një patriot në atë kuptim që përcaktuam më lart për këtë truall të Europës. Naimin njeri dhe poet do ta çmojmë si duhet vetëm atëhere kur krijimin letrar të tij ta vështrojmë nga kjo perspektivë. Poeti e ndjeu veten të dërguar që me anë të fjalës së tij të zgjojë kombin nga gjumi i gjatë i shekujve. Rëndësia e tij qëndron kryesisht këtu, që ai në kohë të sundimit të huaj ndezi pishtarin e lirisë, që e hodhi këtë në literaturë dhe e mbajti ndezur në dorë. Ai përmbushi detyrën që i pat caktuar vetes me cenë të palodhur për krijim dhe me abnegacion asketik. Në të kryer të saj ai derdhi të gjitha fuqitë e tij mendore e fizike dhe në këtë punë shkriu veten në kuptimin e vërtetë të fjalës. Qiriri që ai këndon në një nga vjershat e tij, i cili digjet vetë për t'u ndritur të tjerëve, është një simbol i poetit vetë dhe i veprës së tij: edhe Naimi që një dritësjellës, edhe ai ndezi një dritë që, si thotë vetë, t'i jepte vendit të tij të vogël «pakëz dritë».

Naimi është para së gjithash edukator. Poeti qëndron pas patriotit. Idealet artistike ia sakrifikoi kryesisht përpjekjes nacionale-politike. Do të pranojmë se me përjashtim të disa pak vjershave vlera letrare e poezi-së së tij është e pakët. Sepse veprat e tij më fort se qëllimit estetik i shërbenin një qëllimi etik. Këtij qëllimi, që të bashkojë kombin e tij, ta lartësojë këtë në pikëpamje morale e kulturore, poeti ia mbërriti. Kështu Naimi i përket si literaturës ashtu dhe lëvizjes nacionale të shekullit XIX.

Për ta parë këtë në pikat e ndryshme, le t'i hedhim një sy gjendjes në të cilën ndodhej vendi nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, kohë në të cilën Naimi zhvilloi vepërinë e tij si shkrimtar. Popujt e Ballkanit kishin ngrehur shtetet e tyre, një qëllim ky të cilit Shqipëria ia mbërriti vetëm në shekullin tonë. Në Perandorinë osmane kishin dalë burra të

cilët përballë kaq përparimeve teknike e kulturore të Perëndimit ndien nevojën e reformave, në qoftë se duhej të qëndronte ndërtesa e mbetur krejt mbrapa dhe në shumicë e kalbur e shtetit. Reformat e Tanzimatit përfshinë edhe shkollat, që gjer atëhere kishin mbetur vetëm në duart e klerit muhamedan: kështu më 1853 u emërua nga shteti një komision për përpilimin e librave të shkollës fillore¹⁴.

Kjo lëvizje reformash e dalë nga qendra nuk mbet pa lëshuar rrënjë te shqiptarët e shumë të që i shërbenin Turqisë. Atë që po fillonin tani osmanët e që popujt e Ballkanit po e bënin qëmoti, donin edhe shqiptarët ta kryenin për vendin e tyre. Shqipëria në pikëpamje mendore kishte filluar një farë përparimi. Dijetarë të Perëndimit kishin njohur karakterin e pavarur të gjuhës së tyre, ishin shprehur për vjetërsinë e popullit dhe e kishin lidhur këtë me kombet antike të trungut të Gadishullit ballkanik. Këto ide filluan e hynë në vend dhe ndihmuan që të ngjizet ndërgjegja kombëtare. Shqiptarët e ndien veten nacion, e njohën veten komb anas (autokton) në Gadishull dhe po shpallej me krenari se «s'jemi grekë as bullgarë». Filluan të mburren me gjuhën shqipe, e cila nuk qe as romane, as greke, as sllave, së cilës filluan t'i theksojnë me madhështi karakterin e saj të posaçëm. Këtë gjuhë filluan pas një kohe kaq të gjatë ta shkruajnë përsëri. Më 1844 Naum Veqilharxhi botoi të parën abetare shqipe. Kësaj ndjenje të veçorisë shqiptare erdhi e iu shtua ndjenja e bashkësisë shqiptare. Kolonitë e përhapura nëpër Itali, Greqi, Bullgari, Rumani, Turqi e Egjipt, disa më të lashta, disa më të reja, u bënë qendra të vepërisë nacionale, dhe kishin lidhje të forta ndërmjet tyre, në atë kohë shumë më tepër sesa sot. Fletoret dhe të përkohshmet, kalendarët dhe librat që u botonin në këto qendra, shtegtonin në gjithë të tjerat dhe mbërrinin mënëfund edhe vetë në Shqipëri. Shoqëri patriotike ishin themeluar kudo. Ato synonin më një anë edukimin politik të kombit, më anë tjetër krijimin e një alfabeti dhe mburjtjen e një gjuhe të shkrimit dhe të literaturës. Zëri i de Radës arriti gjer te kolonitë shqiptare të Egjiptit; shqiptarët e Greqisë Kullurioti e Kupitori njiheshin edhe ndër shqiptarë që rronin jashtë këtij vendi; vepëria e kolonive të Bukureshtit e të Stambollit pati jehonë të fortë edhe gjetiu. — Ky qe mjedisi në të cilin hyri Naim Frashëri. I ndryshëm nga i vëllai, Abdyl, i cili u tregua organizator politik dhe mblodhi më 1878 Ligën e parë Shqiptare në Prizren, dhe nga tjetri, Samiu, i cili me një jetë të qetë dijetari kreu punë të pavidrë në

lëmë të turkologjisë, ky iu përvesh kësaj pune: të edukojë shpirtërat me anë të gjuhës shqipe që gjer atëhere pak qe shkruar. Kështu përveç vjershave dhe dy epeve: *Qerbelaja* dhe *Istori e Skënderbeut* kemi prej tij edhe një radhë librash të mësimit, të cilat ishin caktuar për djem dhe për popull: copa këndimi, shkrime me përmbajtje gjeografike dhe përgjithësisht instruktive, përralla shtazësh e përralla të tjera në vers e në prozë; shkrime që edhe sot s'e kanë bjerrë vlerën. Puna që kreu poeti në këtë fushë qëndron më lart se puna që bënë bashkëkohësit e tij.

Siç ka treguar Norbert Jokl-i me një artikull të posaçëm,¹⁵ Naimi ka krijuar edhe në lëmë të gjuhës. Gjuha shqipe i detyron atij një radhë fjalësh kryesisht nga sfera e kulturës, të cilat kanë mbetur të gjalla në këtë gjuhë. Sikundër përpilimi i librave të mësimit dhe i vjershave atdhetare, ashtu edhe kjo anë e punës së tij hyn në vepërinë e një poeti romantik të Europës juglindore. Duket qartas se Naimi qe i frymëzuar nga dëshira të pastrojë e të pasurojë gjuhën shqipe, e cila atëhere — më shumë se sot — qe shumë anësh e paformuar, dhe ta lartësojë këtë në rendin e një gjuhe të kulturës. Është për të shënuar se vepëria e tij në këtë lëmë shkon paralel me punën e vëllait të tij Samiut. Po ndërsa ky bashkëpunoi në reformën gjuhësore të turqishtes (Brockelmann 352 v.), Naimi u vu në shërbim të gjuhës amtare. Le të shënohet me këtë rast se gjuha shqipe në formimin e saj si gjuhë letrare për arsye historike nuk pat sesi të ndeshte në ato vështirësi të një diglosie, siç i pamë që ndeshën greqishtja dhe serbokroatishtja në shekullin e kaluar, dhe vështirësia e vetme që paraqitet edhe sot e gjithë ditën është çështja e të dy dialekteve.

Largimi në histori pamë më sipër se qe një tipar karakteristik i gjithë poetëve romantikë, edhe i romantikëve të Europës juglindore dhe të Shqipërisë. Kjo prirje na shfaqet edhe te Naimi, por përsëri me nergun (qëllimin) e caktuar të edukimit etik. Historia sidomos e kombit të vet i dha poetit lëndën për t'i shtyrë të gjallët në vepra nacionale. Kështu spjegohet që Naimi e mbrujti në një epos figurën e Skënderbeut, heroit kombëtar të Shqipërisë. Ky epos nuk u bë dot epepe kombëtare, këtë shqiptarëvet ua fali më vonë Gjergj Fishta. Shkaku që ky epos si i tillë dështoi qëndron sëpari natyrisht te fakti që Naimit i mungoi talenti i poetit epik. Kësaj iu shtua poezia perse; se nën ndikimin e kësaj vepra u zgjat tepër. Le të shënohet përveç kësaj se figura e Skënderbeut nuk ka

mundur të qëndrojë e gjallë gjatë kohës turke, si p.sh. Kraljević Marko ndër serbë.

Naimi si të gjithë romantikët është një natyrë religjioze. Dashuria mistike e tij për islamizmin i përngjan entuziazmit që kishin romantikët e Perëndimit për katolicizmin. Siç dihet, poeti që anëtar i sektit islam të bektashive. Kjo doktrinë, e cila bashkon në vete të saj mistikën helenistike me mistikën e lashtë orientale e islame, ishte e bërë për ta mbushur plot shpirtin e poetit. Urdhërimet e saj ky i mbledhi në një traktat të veçantë, të *Fletorja e Bektashive*¹⁶. Ky shkrim që caktuar për anëtarët e shumtë të kësaj feje në Shqipëri; edhe ky hynte në kornizën e vepërisë së Naimit që t'i fitonte edhe këta anëtarë për çështjen kombëtare. Po katekizmin fetar të tij poeti e shtroi në një vepër më të madhe, të *Qerbelaja*. Kjo këndon luftrat që bënë arabët ndërmjet tyre pas vdekjes së Profetit, të cilët ishin ndarë në anëtarët e Aliut, Alidët, dhe në anëtarë të Mauvias. Poemi e ka marrë titullin nga lufta e Qerbelasë më 680 pas Krishtit. Këtu poeti shqiptar, siç shihet, si muhamedan që ishte trajtoi një subjekt oriental-islamik. Desha prandaj këtu në fund të them dy fjalë rreth Orientit në botëkuptimin dhe në poezinë e Naimit.

Pozita e Shqipërisë në kufi të Perëndimit me Lindje, e cila na shfaqet faktor vendimtar edhe në histori të vendit, me Naimin, siç u tha më sipër, na pasqyrohet edhe në literaturën shqiptare. Te ky shkrimtar botëkuptimi i Europës perëndimore lidhet me botëkuptimin oriental dhe që të dyja këto botë shkrihen e treten me njëra-tjetrën, po pa shtypur natyrën e tij shqiptare.

Përsa u takon ndikimeve perëndimore, literaturën romantike frënge e përmendëm më lart. Duhet shënuar këtu se poeti ynë që si Kristoforidhi nxënës i gjimnazit grek të Zosimesë në Janinë, të cilin në shekullin e kaluar e ndiqnin shumë nxënës të Shqipërisë jugore. Këtu u bë njohës i mirë i gjuhëve klasike, sidomos i greqishtes. Në këtë gjuhë Naimi shkroi edhe dy vjersha të gjata, 'O "Ερωξ dhe 'Ο Πόθος, të cilën e ka shqipëruar Kristo Floqi me titullin *Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*. Gjurmët e poezisë klasike na shfaqen qartë te Naimi. Si njohës i mirë i Homerit që ishte ai përktheu këngën e parë të *Iliadës*. Homerin na kujtojnë si përkthimi i luftrave e i dyluftimeve dhe mënyra sesi vdesin luftarët si dhe drejtimi i shpeshtë që i bën në vetë të dytë heroit që kuven-don, krahasimet epike, pastaj ndonjë epitete si «nata këmbë-qeta» që të kujton epitete homerike. Situacioni poetik në këngën XXI të *Istorisë së*

Skënderbeut (f. 310), ku heroi që heq për vdekje i drejton fjalët e fundit të birit të tij të ri, duket se është i frymëzuar gjer në imtësira te skena e njohur ndërmjet Ajaksit dhe të birit në dramën e njohur të Sofokliut, por të kujton njëkohësisht edhe skenën midis Hektorit, Andromakës dhe birit të tyre. Frymën e Virgjilit, për të cilin poeti pati një dashuri të veçantë, e gjejmë te idili *Bagëti e Bujqësija*. Këtu Naimi këndon tokën pëllore shqiptare, bagëtitë e shumta të vendit, natyrën jugore të atdheut të tij, kullotat e blerta në pranverën shqiptare. Duhet njohur se këtë poezi e përshkon një frymë e vet e pavarur dhe se ka dalë nga malli i të mërguarit, prandaj u bë vepra më e mirë, poetikisht më e plotë e Naimit. Ndër ndikime të tjera të literaturave të Perëndimit duhet përmendur sëfundi Dante. Kënga XIX e *Istorisë së Skënderbeut*, në të cilën përshkruhet sesi heroi nën udhëheqjen e një engjëlli vete në botën tjetër, sheh tmerret e skëterrës, vëren virtytet dhe veset është një pasqyrë e qartë e *Komedisë Hyjnore*.

Që romantikët e të gjithë anëve u ndezën për Orient si për vendin e mallit, kjo gjë dihet dhe u përmend më sipër, dhe për literaturën shqiptare u pa te de Rada. Mirëpo ndërsa Orienti për këta shkrimtarë është vetëm një anë në zhvillimin e botës artistike të tyre, për Naimin është toka prej nga thith fuqitë e tij poetike. Ai nuk është Europiani që shkel këtë botë si një i huaj dhe për të cilin kjo ka magjinë e vendit ekzotik. Ai është fis me këtë botë; ai rron në të, është i saj. Feja islame e më afërsisht bektashizmi, në të cilin ai bën pjesë, lëvrimi herak i persishtes të cilën e mësoi që djalë, vitet e gjata të shkuara në Turqi: këto të gjitha e bënë Naimin një nxënës të poezisë perse, karakteri kontemplativ i së cilës duket se e ka tërhequr.

Shumë anë të Naimit na kujtojnë poezinë perse, përgjithësisht si dhe në hollësi. Në epet e tij në pikëpamje formale, duhet shënuar, siç u tha edhe më sipër, gjatësia e tyre. Në vend që të zgjidheshin ngjarjet poetikisht më kryesore dhe të nxirreshin këto plastikisht në pah, poeti simbas modelit të epikës perse përpiqet të arrijë plotësi të kallëzimit, të mos këputë kurrë fillin e këtij. Kjo natyrisht është një dëm në pikëpamje estetike, sepse epika në këtë mënyrë rrezikon të bëhet një kronikë në rimë. — Siç thërret Homeri muzën, Firdusi në *Shahnamenë* e tij thërret engjëllin: të njëjtën punë bën Naimi në epet e tij; përveç kësaj, edhe ai që shpie Skënderbeun në ferr është, siç pamë, një engjëll, dhe në këngën III të kësaj vepre edhe heroi vetë krahasohet me një engjëll.

— Edhe më i madh duhet të jetë ndikimi pers në lirikën e tij. Që *Fyelli* e ka gurrën te vjersha me të njëjtin titull e mistikut Djelaladdin Rumi e kam shënuar shkurtimisht.¹⁷ Duhet t'ua lëmë njohësve të gjuhës e të literaturës perse që të gjejnë analogji të tjera në këtë lëmë. Le të shënohet në çdo rasë se Naimi qe kaq i regjur në gjuhë e në literaturë të persëve, sa shkroi në këtë gjuhë edhe një poem, i cili mban titullin karakteristik *Tebajjulât* (Ëndërrime)¹⁸.

Ky ndikim letrar fiton më rëndësi kur shohim se bota islame-orientale ka lënë gjurmë të thella edhe në botëkuptimin e poetit e në qëndrimin e tij mendor, në formë të brendshme e në brendi të poezisë së tij. Fatalizmi oriental, ideja që çdo gjë është e caktuar nga fati, i përshkon gjithë veprat e Naimit. Fati Skënderbeut i është shkruar në ballë dhe fati në këngën XXIII të *Qerbelasë* është i caktuar në yje. Më kot mundohet njeriu t'ia ndalë rrotës së fatit vrapin e saj ose t'ia ndryshojë. Qëllimi i jetës është i kotë, lumturia në këtë botë ikën e e merr era, njeriu më në fund do të bëhet «balt'e pluhur». Mendimi i vdekjes na del shpeshherë te Naimi, ai duhet ta ketë munduar mjaft këtë natyrë refleksive. Pesimizmin, helmin e botës, të cilin e pat predikuar në Perëndimin modern romantizmi dhe, më parë, sadoqë në formë tjetër, Mesjeta kishtarë, në Orient e pat shprehur poezia që në kohë më të lashta dhe e pat lidhur këtu me mendimin religjioz. Pyetjes së trembur të njeriut: a ekziston mbështetja e një ngushëllimi? religjioni ia ka dhënë përgjigjen qëmoti: trupi është vdekëtar, po shpirti i pavdekur. Po t'i shikojmë nga kjo anë veprat e Naimit, shohim se besimi në pavdekësi të shpirtit shprehet me plot gojën në to. Përveç kësaj ky nën ndikimin e mistikës islame dhe si bektashi qe anëtar i panteizmit dhe i panenteizmit: i besimit që Zoti është gjithkund, edhe te kokrriza më e imtë e pluhurit, dhe që të gjitha sendet, edhe më i vogli, janë te Zoti. Me këtë edhe shpirti i njeriut është një emanacion i frymës hyjnore dhe është, i shikuar edhe nga kjo anë, i pavdekur. Po si manifestohet pavdekësia e shpirtit? Me pitagorasit, me fetë e Hindit, me gnostikët dhe me Kabbalën çifute bektashitë besojnë në shtegtimin e shpirtit (metempsikozë)¹⁹. Pas kësaj doktrine shpirti pas vdekjes së trupit që e ka mbajtur kthehet rishtas në tokë, duke marrë një tjetër formë trupore. Ky kthim mund të ndodhë më se një herë dhe kështu mund të bëhet një rreth i tërë jetësh, në trajtë çdo herë të ndryshme, gjë që, siç dihet, e quajmë «kthimi i përjetshëm». Te Naimi besimin në pavdekësi e shohim të bashkuar me mendime

mistike panteiste dhe bashkë me këto të lidhur te ideja e shtegtimit të shpirtit dhe e kthimit të përjetshëm. Këtë mendimin e fundit e gjejmë posaçërisht në vjershat e tij dhe te *Qerbelaja: E mbaroj punën e tija, Dhe vete te Perëndija, Shpirti me trupt u zbërthyen, Dhe prapë nga erth u kthyen, Njeri nga Zoti kish xbritur, Tjetri nga dheu ish ngjitur* (*Qerbelaja*, Kënga I, f. 164 vv.). Por në një vend të *Qerbelasë* poeti shfaq dyshimin e tij në vërtetësinë e këtij besimi që i përshtatet frymës orientale: *Njeriu me kaq shpresë, Qysh të bjerë e të vdesë? Vallë si bëhetë fundi? Kemi tjetër vend gjëkundi? A këtu kthehemi prapë? Përgjigje kush mund të m'apë?* — Te ky vend shpirti realist i kombit të tij duket se theu një herë doktrinën e huaj.

Po ajo ku ndikimi i poezisë islame na del më qartë, është më në fund dualizmi etik e fetar i iranasvet. Më njërën anë është principi i së mirës, më tjetrën principi i së keqes, më njërën drita, më tjetrën terri. Në shkrimet e Naimit kjo luftë midis së dy fuqive, të cilën e ndeshëm më sipër edhe te poeti magjar Vörösmarty, na shfaqet në të gjitha poezitë, në të voglat si dhe në të mëdhatë. Principi i keq përfaqësohet te *Qerbelaja* me Mauvvian dhe me të birin Jezidin, i miri me Alinë dhe me të bijtë, Hasanin dhe Husejnin; këta të fundit janë njëkohësisht heronj dhe shenjtorë, janë të dërguar të Zotit. Këta përfaqësues të së mirës krahasohen me dritën, kundërshtarët e tyre me errësirën. Te *Istori e Skënderbeut* të tërheq vëmendjen fakti se përfaqësuesit e së keqes janë sulltanët turq, Muradi II e Mehmedi II, përfaqësuesi i së mirës i krisheri Skënderbej. Këtë mënyrë trajtimi duhet t'ia çmojmë aq më shumë poetit, kurqë ky vetë ishte muhamedan. Kjo ndodh në frymë të karakterit të popullit shqiptar, te i cili ndjenja etnike ka qenë gjithmonë më e fortë se ndjenja religjioze²⁰. Naimi i shikuar dhe nga kjo anë na tregohet pjella e thjeshtë e kombit të tij. Ai është frymë nga fryma jonë dhe gjak nga gjaku ynë.

SHËNIME

1. *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, (1936), f. 47 v.; «Hrvatska Enciklopedija», I s.v. *Albanija Knjizevnost*; «Südost-Forschungen», VI (1941), f. 645.
2. *Literatura botërore moderne*, 1890-1931, II, f. 326.
3. **Elsa Sterste**, në : *Lettonia* (1939), f. 87-101.
4. *Vuks albanische Liedersammlung*, Zbornik Belic (1921), f. 33-86.
5. *Për gjenezën e literaturës shqipe*.
6. *Gjendja kishtare e Shqipërisë në kohën paraturke*, «Illyrisch-albanische Forschungen», I, (1916), f. 188-281.
7. **Carl Brockelmann**, *Historia e kombeve islamike*, (1939), f. 284.
8. Të tjera pikëpamje të **N. Jorga**, *Histoire des états balcaniques jusq'à 1924* (1925), kap.II: *Les chrétiens d'Orient sous la domination turque*.
9. **Brockelmann**, *op. cit.*, f. 286.
10. **Girolamo de Rada**, *poeta albanese*, Palermo 1930.
11. *Principii d'Estetica*, f. 41, sh. **Marchianò**, *L'Albania e l'opera di Girolamo de Rada* (1902), f. 197 vv., **G. Petrotta**, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, f. 211. Gabimin e këtij mendimi të de Radës e pa sëpari, siç gjej te **Marchianò**, f. 201, **R. de Grázia**, *Canti popolari albanesi tradizionali del Mezzogiorno d'Italia*, riordinati, tradotti ed illustrati, Noto 1889.
12. **Marchianò**, *op. cit.*, f. 145.

13. Këtë e vërteton edhe **Mali Kokojka**, i cili në biografinë e tij *Naim be Frashëri*, f. 24 e ribotimit të 1942-shit, flet për gjurmët e Lamartine-it në poezinë e Naimit.

14. **Brockelmann**, *op. cit.*, 350.

15. «Naim be Frashëri e pasunim i gjuhës shqipe» në : *Naim Frashërit! Vjershëtorit dhe edukatorit kombëtar*, Graz 1925, f. 84-97.

16. E ribotoi me përkthim gjermanisht dhe me koment **N. Jokl** në «Balkan-Archiv», II, (1926), f. 226-256.

17. *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, f.48, sh.1.

18. **M. Kokojka**, *op. cit.*, f. 8 v.

19. Jacobi te **Jokl**, «Balkan-archiv», II, f. 248.

20. «Ky fakt e cilëson mirë karakterin shqiptar; greku edhe vllahu lirinë politike ia sakrifikon besimit, shqiptarit i vjen aq rëndë të durojë zgjedhën, sa lirinë nga kjo zgjedhë e paguan me besimin e të parëve», **Hahn**, *op. cit.*, I, f. 35-72.

SHËNIM I BOTUESIT

Për gjenezën e literaturës shqipe është botuar të parën herë në «Hylli i Dritës», në disa numra në vijim, më 1938-1939.

Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare është shkruar më 1945 dhe sheh dritën e botimit për herë të parë.

PËRMBAJTJA

PËR GJENEZËN E LITERATURËS SHQIPE	5
THEMELET KULTURORE-HISTORIKE: POPULLI DHE POEZIA E TIJ	7
<i>Gjeografia dhe karakteri i vendit</i>	7
<i>Emri i popullit</i>	8
<i>Fuqi centrifugale në historinë dhe në karakterin e popullit shqiptar</i>	16
<i>Rryma centripetale të huaja</i>	18
<i>Shqipëria midis Perëndimit dhe Lindjes</i>	18
<i>Fiset</i>	20
<i>Karakteri konservativ i zonave malësore të anëve</i>	21
<i>Njësia e kombit dhe shpirti i kombit</i>	24
<i>Poezia popullore</i>	30
<i>Literatura</i>	52
SHËNIME	57
ROMANTIZMI NË EUROPE LINDORE E JUGLINDORE DHE NË LITERATURËN SHQIPTARE	67
I	69
II	78
III	93
SHËNIME	115
SHËNIM I BOTUESIT	117

«Ky qëndrim i ndërmjetëm midis Perëndimit e Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë... Duhet shënuar me këtë rast se Shqipëria ka qenë e orientuar më tepër nga Perëndimi sesa fqinjët e saj. Midis gjithë vendeve ballkanike, — edhe Rumania, me gjithë idiomën roman të saj, e papërrjashtuar — Dalmacia e Shqipëria, pastaj Ishujt Jonike janë vendet që kanë qenë të çelura direkt e më tepër ndaj influencës kulturore të Perëndimit.»

Dy tekste themelore të krijimtarisë së Eqrem Çabejt, të lëna gjatë e qëllimisht në harresë. Por ndërkohë dy gurë të çmuar të kurores së mendimit shqiptar:

Për gjenezën e literaturës shqipe, botuar në vitet 1938-39 në disa numra të revistës «Hylli i Dritës». Po të përjashtojmë përfshirjen në botimin e veprave të zgjedhura të Çabejt në Kosovë, ajo nuk u botua asnjëherë në Shqipërinë e pasluftës.

Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare, i shkruar në vitin 1945, një vazhdim i *Gjenezës*, por që s'arriti asnjëherë të shohë dritën e botimit.

Dy vepra që jo vetëm plotësojnë figurën poliedrike të dijetarit të shquar me disa nga aspektet më të vjera të punës së tij, por që, pavarësisht nga koha, si rallëherë ruajnë një aktualitet të habitshëm. Duke vënë në qendër të vëmendjes disa nga nyjet më të rëndësishme të botës shqiptare, ato i japin lexuesit fillin që të çon te përgjigjja e shumë pyetjeve dhe dilemave që shtrohen ende sot.